



CPT/Inf (2009) 3

**RAPORT**

**PËR ADMINISTRATËN E PËRKOHSHME TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË  
(UNMIK)**

**MBI VIZITËN E KOMISIONIT EVROPIAN PËR PARANDALIMIN E TORTURËS DHE  
TRAJTIMIN OSE DËNIMIN ÇNJERËZOR OSE DEGRADUES TË KRYER NË KOSOVË**

**(KPT)**

**NGA 21 DERI MË 29 MARS 2007**

---

This document has been translated by UNMIK.

**PËRMBAJTJA**

<b>KOPJA E LETRËS ME TË CILËN PËRCILLET RAPORTI I KPT-SË.....</b>	<b>4</b>
<b>I. HYRJE.....</b>	<b>5</b>
<b>A. Datat e kryerjes së vizitës dhe përbërja e delegacionit .....</b>	<b>5</b>
<b>B. Institucionet e vizituara .....</b>	<b>6</b>
<b>C. Këshillimet e mbajtura nga delegacioni dhe bashkëpunimi.....</b>	<b>6</b>
<b>D. Vërejtjet e menjëhershme sipas nenit 4, paragrafit 5, të marrëveshjes .....</b>	<b>7</b>
<b>II. FAKTET E GJETURA GJATË VIZITËS DHE VEPRIMET E PROPOZUARA .....</b>	<b>8</b>
<b>A. Ndalimi nga ana e policisë .....</b>	<b>8</b>
1. Vërejtjet paraprake .....	8
2. Keqtrajtimi .....	8
3. Mbrojtja.....	13
4. Kushtet e paraburgimit.....	18
5. Çështjet e tjera .....	19
<b>B. Institucionet ndëshkimore .....</b>	<b>20</b>
1. Vërejtjet paraprake .....	20
2. Keqtrajtimi .....	21
3. Kushtet materiale të paraburgimit.....	25
a. Burgu i Dubravës.....	25
b. Qendra korrektuese në Lipjan.....	26
c. Qendrat e paraburgimit të cilat janë vizituar .....	27
4. Regjimi .....	28
a. Burgu i Dubravës.....	28
b. Qendra Korrektuese në Lipjan.....	33
c. Qendrat e paraburgimit të cilat janë vizituar .....	34
5. Kujdesi shëndetësor .....	35
a. Personeli dhe objektet.....	35
b. Trajtimi dhe mundësia e shfrytëzimit të kujdesit shëndetësor.....	36
c. Ekzaminimi mjekësor dhe regjistrimi i lëndimeve.....	37

6.	Çështjet e tjera.....	39
a.	Disiplina.....	39
b.	Qelitë e sigurisë.....	41
c.	Kontakti me botën jashtë burgut.....	42
<b>C.</b>	<b>Institucionet e mirëqenies psikiatrike dhe sociale .....</b>	<b>42</b>
1.	Komentet paraprake .....	42
2.	Keqtrajtimi .....	43
3.	Kushtet e jetesës së pacientëve/banuesve .....	44
4.	Punonjësit.....	47
5.	Trajtimi.....	48
6.	Kontrolli i pacientëve/banuesve të shqetësuar dhe (apo) të dhunshëm.....	48
7.	Masat e mbrojtjes .....	49
a.	Procedurat e vendosjes dhe të lëshimit në institucionin psikiatrik .....	50
b.	Masat mbrojtëse gjatë vendosjes në institucion.....	52
<b>SHTOJCA I:</b>		
	<b>Lista e rekomandimeve, komentet dhe kërkesat për informata nga ana e KPT-së .....</b>	<b>54</b>
<b>SHTOJCA II:</b>		
	<b>Lista e autoriteteve, organizatave ndërkombëtare dhe OJQ-ve me të cilat është takuar delegacioni .....</b>	<b>66</b>
<b>SHTOJCA III:</b>		
	<b>Marrëveshja ndërmjet Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Këshillit të Evropës për përgatitjet teknike lidhur me Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor ose Degradues .....</b>	<b>68</b>

**Kopja e letrës me të cilën përcillet raporti i KPT-së**

Z. Joachim Rücker  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm  
të Kombeve të Bashkuara në Kosovë  
Selia e UNMIK-ut  
PRISHTINË – KOSOVË

Strasburg, 25 korrik 2007

I nderuari zotëri,

Në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, të marrëveshjes së nënshkruar më 23 gusht 2004 ndërmjet Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe të Këshillit të Evropës mbi përgatitjet teknike lidhur me Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues, po e bashkëngjis me këtë letër raportin e Komisionit Evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose degradues (KPT), të hartuar pas vizitës të zhvilluar në Kosovë prej 21 deri më 29 mars 2007. Raporti është miratuar nga KPT në takimin e tij të 63-të, të mbajtur prej 2 deri më 6 korrik 2007.

Rekomandimet, komentet dhe kërkesat e ndryshme për informata të formuluara nga KPT janë dhënë në Shtojcën I. Duke pas parasysh nenin 6 të marrëveshjes së sipërpërmendur në lidhje me, në veçanti, rekomandimet e KPT-të, Komisioni kërkon nga UNMIK-u që **brenda gjashtë muajve** të jap përgjigje duke ofruar shpjegime të plota lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e tyre. KPT beson që po ashtu do të jetë e mundur që, në përgjigjen e sipërpërmendur, UNMIK-u t'i ofrojë reagimet lidhur me komentet e formuluara në këtë raport të cilat janë përmbledhur në Shtojcën I si edhe përgjigjet lidhur me kërkesën e paraqitur për informata.

Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me raportin e KPT-së ose me procedurën e ardhshme, unë jam në disponimin tuaj të plotë.

Me nderime

Mauro Palma  
Kryetar i Komisionit Evropian  
për parandalimin e torturës dhe të trajtimit  
ose dënimit çnjerëzor ose degradues

## I. HYRJE

### A. Datat e kryerjes së vizitës dhe përbërja e delegacionit

1. Në pajtim me nenin 3 të marrëveshjes së nënshkruar më 23 gusht 2004 ndërmjet Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Këshillit të Evropës për përgatitjet teknike lidhur me Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues, (më tej përmendet si "Marrëveshja "; të paraqitur në Shtojcën III), një delegacion i KPT-së e ka kryer një vizitë në Kosovë prej datës 21 deri më 29 mars 2007<sup>1</sup>.

2. Vizitën e kanë kryer anëtarët në vijim të KPT-së:

- Mauro PALMA (kryetar i KPT-së, shef i delegacionit)
- Andres LEHTMETS (nënkryetari i dytë i KPT-së)
- Anna GAVRILOVA-ANCHEVA
- Roland MARQUET.

Ata janë mbështetur nga anëtarët në vijim të sekretarisë së KPT-së:

- Fabrice KELLENS, zëvendëse e sekretares ekzekutive e KPT-së
- Michael NEURAUTER, udhëheqës i sektorit

dhe janë ndihmuar nga:

- Eric DURAND, mjek, ish-udhëheqës i shërbimit mjekësor në burgun Fleury-Mérogis, në Francë (ekspert)
- Michael KELLETT, ish-kryeinspektor i detektivëve në Policinë e Lancashire, Mbretëri e Bashkuar (ekspert)
- Rezija ČOLAKOVIĆ (interprete)
- Blerim DERVISHI (interpret)
- Ermal DIDA (interpret)
- Leonora DOBROSHI (interprete)
- Danica KRALJEVIC (interprete)
- Glauk KRYEZIU (interpret)
- Andrijana MILETIC (interprete)
- Biljana OBRADOVIC-VULJNOVIC (interprete)
- Mark RODIQI (interpret).

---

<sup>1</sup> Marrëveshja është zbatuar pas përgatitjeve të bëra me NATO – n në korrik 2006, të cilat ja kanë mundësuar KPT-së po ashtu t'i vizitohet vendet në të cilat personat mund të jenë privuar nga liria nga ana e KFOR-it.

**B. Institucionet e vizituara**

3. Delegacioni i ka vizituar vendet e paraburgimit në vijim:

Institucionet policore

- Stacionin e policisë në Deçan
- Stacionin e policisë në Gjilan
- Stacionin e policisë në Istog
- Stacionin e policisë në Mitrovicën veriore
- Stacionin e policisë në Mitrovicën jugore
- Stacionin e policisë në Pejë
- Stacionin e policisë nr. 1 në Prishtinë
- Stacionin e policisë nr. 2 në Prishtinë
- Stacionin e policisë në Viti

Institucionet ndëshkimore

- Burgun e Dubravës
- Qendrën korrektuese në Lipjan
- Qendrën e paraburgimit në Gjilan
- Qendrën e paraburgimit në Mitrovicë
- Qendrën e paraburgimit në Pejë
- Qendrën e paraburgimit në Prishtinë

Institucionet psikiatrike/të mirëqenies sociale

- Njësinë për psikiatri dhe neurologji të spitalit rajonal të Mitrovicës
- Klinikën psikiatrike të spitalit universitar të Prishtinës
- “Institutin special” të Shtimes (Institucion për personat me paaftësi mendore dhe qendrën integruese për shëndetin mendor).

**C. Këshillimet e mbajtura nga delegacioni dhe bashkëpunimi**

4. Delegacioni i KPT-së ka hasur në bashkëpunim shumë të mirë gjatë tërë vizitës edhe nga UNMIK-u edhe nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse. Në veçanti, është pranuar mirë në të gjitha vizitat që ua ka bërë vendeve ku njerëzit privohen nga liri, përfshirë edhe vendet të cilat nuk ishin njoftuar paraprakisht, dhe delegacioni ka pas qasje të menjëhershme në të gjitha institucionet dhe në informatat e nevojshme për ta kryer punën e tij.

5. Gjatë vizitës, delegacioni ka mbajtur këshillime me z. Joachim RÜCKER, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (PSSP), me z. Steven P. SCHOOK, zëvendës kryesor i PSSP-së, dhe me përfaqësuesit e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse, përfshirë zotërinjtë Sadik IDRIZ, ministër i shëndetësisë, Ibrahim SELMANAJ, ministër i punës dhe i mirëqenies sociale, Jonuz SALIHAI, ministër i drejtësisë, dhe Blerim KUQI, ministër i punëve të brendshme, si edhe me oficerët e lartë të UNMIK-ut dhe të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse. Po ashtu është takuar me z. Hilmi JASHARI, ushtrues i detyrës së Ombudspersonit të Kosovës, dhe me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të OJQ-ve të ndryshme.

Një listë e të gjitha autoriteteve, të organizatave ndërkombëtare dhe joqeveritare me të cilat është takuar delegacioni është dhënë në Shtojcën II të këtij raporti.

#### **D. Vërejtjet e menjëhershme sipas nenit 4, paragrafit 5, të marrëveshjes**

6. Në fund të vizitës më 29 mars 2007, delegacioni i paraqiti tri vërejtje të menjëhershme sipas nenit 4, paragrafit 5, të marrëveshjes:

Vërejtja e parë e menjëhershme kishte të bënte me shfrytëzimin e qelive plotësisht boshe, siç është qelia nr. 1 në bllokun 5 në burgun e Dubravës, në të cilën mbahen të burgosurit e “shqetësuar” për periudha kohore deri në 48 orë. Delegacioni theksoi që qelia e sipërpërmendur në burgun e Dubravës, në gjendjen e tanishme, ishte plotësisht e papërshtatshme për t’u përdorur për vendosjen e ndonjë të burgosuri aty dhe kërkoi që ajo të tërhiqej menjëherë nga shfrytëzimi (afati i fundit: një muaj).

Vërejtja e dytë e menjëhershme u bë lidhur me qelitë e gjetura në qendrën e paraburgimit në Pejë (blloku D), të cilat ishin më të vogla se 4 m<sup>2</sup> dhe plani i të cilave ishte shumë i ngjashëm, pothuajse identik, me qelitë disiplinore. Delegacioni theksoi që qelitë e tilla, duke marrë parasysh vetëm madhësinë e tyre, ishin plotësisht të papërshtatshme për vendosjen e të burgosurve dhe kërkoi që ato menjëherë të tërhiqeshin nga shfrytëzimi (afati i fundit: një muaj).

Vërejtja e tretë e menjëhershme lidhur me mungesën e plotë të ushtrimeve jashtë për pacientët në njësinë e mjekësisë ligjore (“pavijoni i burgut”) në klinikën psikiatrike të spitalit universitar në Prishtinë. Delegacioni kërkoi nga autoritetet përkatëse të ndërmarrin hapa të menjëhershëm për të siguruar që të gjithë pacientëve të mbajtur në njësi t’ju ofrohet së paku një orë ushtrime jashtë për çdo ditë, nëse gjendja e tyre shëndetësore ua lejon këtë (afati i fundit: 15 qershor 2007).

Vërejtjet e sipërpërmendura janë konfirmuar në një letër të datës 30 prill 2007 të cilën kryetari i KPT-së ja ka dërguar PSSP-së.

7. Më 26 qershor 2007, UNMIK-u ofroi komente lidhur me çështjet e ndryshme të cilat i ka ngritur delegacioni në fund të vizitës, përfshirë vërejtjet e menjëhershme të sipërpërmendura. Kjo informatë është marrë parasysh në pjesë përkatëse të këtij raporti.

## II. FAKTET E GJETURA GJATË VIZITËS DHE VEPRIMET E PROPOZUARA

### A. Ndalimi nga ana e policisë

#### 1. Vërejtjet paraprake

8. Delegacioni i ka vizituar gjithsej nëntë stacione të policisë në Kosovë në: Deçan; Gjilan; Istog; Mitrovicë të veriut; Mitrovicë të jugut; Pejë; Prishtinë nr. 1; Prishtinë nr. 2; Viti.

9. Sipas nenit 212, paragrafit 4, të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPP)<sup>2</sup>, një person mund të ndalohet nga policia për një periudhë e cila nuk i kalon 72 orë. Në rastin e të miturve, kohëzgjatja maksimale e ndalimit nga ana e policisë është e kufizuar në 24 orë (neni 63, paragrafi 2, i KPPP-së).

#### 2. Keqtrajtimi

10. Gjatë vizitës, delegacioni ka pranuar një numër të pohimeve për keqtrajtimit fizik të personave të mbajtur të ushtruar nga ana e oficerëve të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) në stacionet e policisë anembanë Kosovës. Pohimet për keqtrajtimit të shkallëve të ndryshme të ashpërsisë janë bërë nga personat, të cilët janë mbajtur në stacionet e policisë në vijim: Deçan, Ferizaj, Graçanicë, Istog, Kaçanik, Lipjan, Mitrovicë e veriut dhe e jugut, Prishtinë stacionet 1, 2, 3 dhe 4, Prizren, Skenderaj dhe Viti.

Pohimet kryesisht kishin të bënin me grushtimet, goditjet me pëllëmbë dhe shkelmimet nga ana e oficerëve të SHPK-së të cilën mundoheshin t'i shtynin të dyshuarit t'i pranonin veprat penale gjatë intervistimit. Në disa raste, ashpërsia e keqtrajtimit të pohuar ishte e atij niveli sa që lehtë do të mund të përshkruhej si torturë (si për shembull ekzekutimi i simuluar ose të rrahurat e gjata dhe të ashpra). Për më tepër, një numër i personave të paraburgosur kanë pohuar që oficerët e SHPK-së kanë ushtruar presion psikologjik tek ata për të mos ushtruar ankesë lidhur me keqtrajtimitin e pësuar.

11. Vlen të theksohet që nuk është pranuar asnjë pohim për keqtrajtimit nga ana e oficerëve të policisë ndërkombëtare (CIVPOL). Në anën tjetër, një numër i personave të paraburgosur ia kanë konfirmuar delegacionit që janë keqtrajtuar nga oficerët e SHPK-së pasi që oficerët e policisë ndërkombëtare kishin shkuar nga institucioni. Në disa raste, sipas pohimeve, keqtrajtimiti është ndërprerë menjëherë kur një oficer i CIVPOL-it ka ardh në stacionin policor. Në një rast, një person i paraburgosur të cilin e ka takuar delegacioni ka pohuar që në stacionin e policisë në Deçan një oficer i policisë e kishte penguar një intervenim mjekësor nga mjeku (qepjen e plagës në buzë), pasi që i paraburgosuri ishte rrahur dhe goditur në fytyrë nga i njëjti oficer. Mjeku mundi ta përfundonte intervenimin mjekësor vetëm pas intervenimit të një oficeri të policisë ndërkombëtare, i cili kishte ardhur më vonë.

12. Të gjitha pohimet e pranuar kishin të bënin me incidentet të cilat kishin ndodhur disa javë para vizitës së delegacionit dhe asnjë shenjë e lëndimit nuk ishte e dukshme. Megjithatë, në së paku dy raste, gjatë pranimit të personave në fjalë në qendrat e paraburgimit në Mitrovicë dhe në Prishtinë ishin bërë fotografi në të cilat dukeshin lëndimet.

---

<sup>2</sup> I shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/26.

Më tej, gjatë shikimit të dosjeve mjekësore nga ana e delegacionit janë gjetur shenja të cilat janë në përputhje me pohimet e pranuar.

13. **KPT rekomandon që deklarata formale, që buron nga autoritetet kompetente më të larta politike t'ju paraqitet të gjithë oficerëve të SHPK-së (përfshirë oficerët e policisë kundër krimit), e cila ua përkujton atyre që duhet t'i respektojnë të drejtat e personave të cilët janë të ndaluar nga ata dhe që keqtrajtimi i personave të tillë do të ketë për pasojë sanksione të ashpra. Atyre po ashtu duhet t'ju bëhet me dije që gjatë arrestimit të ndonjë personi nuk duhet të përdoret forcë më e madhe se që është e nevojshme.**

Më tej, **duhet të ndërmerren hapa të duhur për të siguruar që personat të cilët kanë qenë viktimë të keqtrajtimit nga ana e oficerëve të policisë të jenë në gjendje në mënyrë efikase të parashirojnë ankesë formale.**

14. Njëra nga mjetet më efikase për parandalimin e keqtrajtimit nga ana e oficerëve të policisë është ekzaminimi i kujdesshëm nga ana e autoriteteve kompetente i të gjitha informatave relevante lidhur me keqtrajtimin e pohuar, të cilat ju bëhen me dije atyre, pavarësisht nga fakti nëse ajo informatë e merr formën e ankesës formale; mosveprimi do të kontribuojë në krijimin e klimës së mosndëshkimit. Në lidhje me këtë, gjykatësit dhe prokurorët kanë pozitë vendimtare.

Është për t'u brengosur që disa persona të paraburgosur, të cilët i ka takuar delegacioni, kanë treguar që kanë pësuar lëndime të dukshme nga keqtrajtimi i policisë dhe që ja kanë përmendur gjykatësit shkakun e këtyre lëndimeve. Megjithatë, sipas pohimeve në këto raste gjykatësi nuk ka ndërmarrë kurrfarë veprimi. Disa persona po ashtu kanë pohuar që nuk kishin guxuar ta informonin gjykatësin lidhur me keqtrajtimin e pësuar, pasi që oficeri i policisë, i cili ia kishte shkaktuar lëndimet, ishte i pranishëm gjatë seancës gjyqësore.

**KPT-ja u rekomandon autoriteteve përkatëse të sigurojnë që sa herë që një person i arrestuar, i cili sillet para prokurorit ose gjykatësit pohon që është keqtrajtuar nga policia, ato pohimet të regjistrohen me shkrim, të urdhërohet menjëherë kryerja e kontrollit mjekoligjor, dhe të ndërmerren hapat e nevojshëm për të siguruar hetim të duhur lidhur me pohimet. Një qasje e tillë duhet të respektohet pavarësisht nëse personi në fjalë ka lëndime të dukshme apo jo. Për më tepër, madje edhe në mungesë të pohimit të qartë për keqtrajtim, prokurori ose gjykatësi duhet të kërkojë të kryhet kontrolli mjekoligjor kurdo që ka arsye të tjera (p.sh. lëndime të dukshme; pamja ose sjellja e përgjithshme e personit) që të bëjnë të besosh që mund të ketë ndodhur keqtrajtimi.**

Për më tepër, **Komisioni rekomandon që të ndërmerren hapa të duhur për të siguruar që prokurorët/gjykatësit e udhëheqin seancën në atë mënyrë që personat në fjalë të kenë rast të vërtetë të flasin lidhur me mënyrën si janë trajtuar.**

15. KPT dëshiron ta theksojë rolin kryesor që mund të luajnë mjekët në parandalimin e keqtrajtimit, sidomos në kontekst të kontrollit mjekësor, i cili kryhet gjatë pranimit në objektet e paraburgimit, përmes regjistrimit sistematik të lëndimeve, dhe, në rastet kur kjo është e përshtatshme, duke ju dhënë informata autoriteteve përkatëse. Megjithatë, delegacioni i ka vënë re disa mungesa në këtë aspekt në qendrat e ndryshme të paraburgimit të cilat i ka vizituar<sup>3</sup>. Në lidhje me këtë, **ju referohemi vërejtjeve dhe rekomandimeve të bëra në paragrafët 91 deri 95.**

<sup>3</sup> Për shembull, në qendrën e paraburgimit në Prishtinë, gjatë pranimit të të paraburgosurit nuk është regjistruar asnjë lëndim i tij, ndërsa fotografia e bërë gjatë pranimit ishte në dosjen administrative dhe në të shiheshin qartë mavijosje rreth syrit.

16. Është e pakundërshtueshme që të gjitha ankesat për keqtrajtim nga ana e oficerëve të policisë duhet t'iu nënshtrohen hetimeve efikase të cilat, në rast që kjo është e nevojshme, çojnë deri te shqiptimi i dënimit të përshtatshëm. Kjo do të ketë një ndikim shumë të fuqishëm zbindës.

KPT e mirëpret faktin që Inspektorati i Policisë së Kosovës<sup>4</sup> (IPK), i cili është krijuar më 2006, do të jetë plotësisht funksional së shpejti (me një numër të personelit prej 50 vetave). Kështu, do të vendoset një mekanizëm gjithëpërfshirës për monitorimin e policisë. IPK-së, në mesin e gjërave të tjera, do t'i besohet hetimi i ankesave për sjellje të keqe nga ana e policisë dhe zhvillimi i hetimeve penale nën drejtimin e prokurorëve, ndërsa Njësia për Standarde Profesionale (NJSP) do të mbetet përgjegjëse për hetimin e kundërvajtjeve.

**KPT do të dëshironte t'i merrte të dhënat për të gjitha ankesat lidhur me keqtrajtim nga ana e policisë të cilat i ka pranuar IPK në vitin 2007 dhe për rezultatet e procedurave përkatëse disiplinore dhe/ose penale (pohimet, përshtatjet e shkurtra të rezultateve të gjykatës ose trupit përkatës, vendimin, dënimin/sanksionet e shqiptuara).**

17. Inspektimi i objekteve të paraburgimit të policisë nga një autoritet i pavarur po ashtu mund të japë një kontribut të rëndësishëm për parandalimin e keqtrajtimit të personave të cilët mbahen nga policia, dhe në përgjithësi, nëse është e nevojshme, mund të ndihmojnë në përmirësimin e kushteve të paraburgimit. Për të qenë plotësisht efikase, vizitat e autoriteteve të tilla duhet të jenë edhe të shpejta edhe të paralajmëruara, dhe autoriteti në fjalë duhet të autorizohet për t'i intervistuar personat e paraburgosur pa praninë e të tjerëve. Për më tepër, duhet t'i shqyrtojë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trajtimin e personave të paraburgosur: regjistrimin e paraburgimit; informatat të cilat ju ofrohen personave të paraburgosur lidhur me të drejtat e tyre dhe të ushtruarit e atyre të drejtave (në veçanti tri të drejtat e përmendura në paragrafin 21); pajtueshmërinë me rregullat sipas të cilave bëhet marrja në pyetje e të dyshuarve për aktivitete kriminale; dhe kushtet materiale për paraburgim.

18. Trupa të ndryshëm kanë kryer inspektime të rregullta të objekteve policore. IPK kryen inspektime të zakonshme<sup>5</sup> dhe të jashtëzakonshme<sup>6</sup>. Inspektime të objekteve të paraburgimit të policisë ka kryer po ashtu edhe Ombudspersoni i Kosovës. Përveç kësaj, kushtet e paraburgimit në objektet e paraburgimit të policisë janë monitoruar edhe nga OSBE-ja<sup>7</sup>.

**KPT do të donte të merret informata të hollësishme lidhur me inspektimet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të kryera nga IPK prej prillit 2007 (objektivat, përfundimet, etj.).**

19. Në fund, KPT dëshiron t'i përmendë incidentet e rënda, në të cilat janë përfshirë njësitë e formuara policore (NJFP) të SHPK-së dhe të CIVPOL-it, edhe Njësitë Lëvizëse Mbështetëse (NJLM) të NATO-s. Gjatë demonstratës së dhunshme më 10 shkurt 2007 në Prishtinë është hedhur gaz lotsjellës dhe plumba të gomës në drejtim të turmës së demonstruesve, të cilët përqipeshin t'ju

---

<sup>4</sup> Sipas nenit 9, paragrafëve 2 dhe 3, të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/54 mbi Kornizën dhe Parimet Udhëzuese të Shërbimit Policor të Kosovës, IPK është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe është plotësisht i pavarur nga SHPK-ja.

<sup>5</sup> Deri tani IPK i ka kryer katër inspektime të zakonshme. Inspektimi i fundit është kryer në tetor 2006 dhe është përqendruar në "arrestimin dhe mënyrën e menaxhimit të paraburgimit nga ana e SHPK-së".

<sup>6</sup> Më së fundi IPK ka kryer një inspektim të jashtëzakonshëm në shkurt 2007, në mënyrë që ta vlerësojë sjelljen e SHPK-së gjatë trazirave civile në Prishtinë më 10 shkurt 2007.

<sup>7</sup> "Raporti për qelinë e mbajtjes: rivlerësim", Departamenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit (nëntor 2005).

ofroheshin ndërtesave të Qeverisë. Sipas raporteve, dy demonstrues u vranë, disa u lënduan rëndë dhe shumë prej tyre u ndaluan.

Menjëherë pas kësaj u krijua një grup punues për të kryer hetime lidhur me incidentin e sipërpërmendur. Përveç kësaj, më 14 shkurt 2007 PSSP-ja e emëroi një prokuror të posaçëm hetues, z. Robert L. Dean, për ta mbikëqyrë një “hetim të pavarur lidhur me rrethanat në të cilat ka ndodhur vdekja e dy personave, si pasojë e veprimit të policisë”. Prokurori hetues i emëruar posaçërisht dhe grupi punues ja kushtuan hetimin e tyre rikonstruimit të ngjarjes si dhe pse u vranë dy protestuesit dhe u plagosën rëndë shumë të tjerë, nëse veprimet e tilla ishin të arsyeshme dhe të shmangshme, nëse dëshmitë i mbështetnin akuzat penale për gjuajtje kundër ndonjë individi, dhe për të ofruar udhëzime për veprimet e ardhshme të policisë. Përveç kësaj, prokurori Dean i shqyrtoi standardet ekzistuese për përdorimin e duhur dhe gjuajtjen e plumbave të gomës nga ana e policisë gjatë kryerjes së funksioneve për kontrollimin e turmës dhe planifikimin operativ dhe procesin vendimmarrës nga Policia e UNMIK-ut më 10 shkurt 2007.

Gjatë vizitës, delegacioni zhvilloi diskutime të frytshme me prokurorin e posaçëm, si edhe zëvendëskomesarin e policisë së CIVPOL-it për operacione dhe me drejtorin e operacioneve. Në këtë rast, delegacionit ju ofruan informata të hollësishme lidhur me disa çështje specifike (Politikat dhe procedurën e Policisë së UNMIK-ut; asetet; aftësimin; karakteristikat e gazit lotsjellës dhe të plumbave të gomës për secilën NJFP të përfshirë, etj.). KPT po ashtu i kushtoi vëmendje raportit të përkohshëm për hetimet të cilin e kishte vënë në dispozicion prokuroria më 16 prill 2007.

20. Më 4 korrik 2007, KPT e mori një kopje të raportit të dytë të prokurorit të posaçëm për PSSP-në lidhur me vdekjet dhe plagosjen e rëndë të protestuesve gjatë demonstratave, të mbajtura më 10 shkurt 2007 në Prishtinë (të datës 29 qershor 2007). Për dallim nga raporti i prillit, raporti i qershorit nuk e ka për qëllim vlerësimin e përgjegjësisë penale, por e ka për qëllim “rishikimin e ligjit ekzistues dhe vlerësimin dhe të kritikuarit e praktikës dhe të procedurave të përdorura nga Policia e UNMIK-ut gjatë planifikimit dhe kryerjes së funksioneve policore, para dhe gjatë protestave të 10 shkurtit”. Raporti përfundon që “gjuajtja e gabuar e plumbave të gomës nga së paku një ose ndoshta dy gjuajtësve të NJFP rumune ishte shkaktari i drejtpërdrejtë ose i afërt i vdekjeve të panevojshme dhe të pajustificuara që u shkaktuan atë ditë”. Në të po ashtu është dhënë një listë e faktorëve të cilët duket se kanë kontribuar në ndodhjen e incidentit fatal<sup>8</sup>.

KPT dëshiron të informohet lidhur me masat konkrete të cilat janë ndërmarrë nga autoritetet përkatëse në frymën e hetimeve të sipërpërmendura, me qëllim që ta parandalojnë ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen.

---

<sup>8</sup> Në veçanti, (1) mjedisi juridik i popujve të cilët kanë kontribuar (ekziston një mosmarrëveshje ndërmjet ligjit vendorë rumunë dhe të drejtës ndërkombëtare të pranuar në përgjithësi dhe parimeve udhëheqëse të KB-ve lidhur me përdorimin e forcës vdekjeprurëse dhe ka shumë të ngjarë edhe lidhur me përdorimin e plumbave të gomës; (2) municioni i dalë nga përdorimi (municioni i përdorur nga NJFP të Rumanisë ishte i vjetruar, 13 vjet i vjetër); (3) dykuptimësia e urdhrat operativ; (4) mosfunksionimi i zinxhirit komandues; (5) mosfunksionimi i mbikëqyrjes; dhe (6) dykuptimësia dhe mosaktësia lidhur me dhënien e autorizimit për përdorimin e plumbave të gomës.

### 3. Mbrojtja

21. KPT u kushton rëndësi të madhe tri mbrojtjeve themelore kundër keqtrajtimit të personave të privuar nga liria nga ana e policisë, domethënë të drejtës për ta njoftuar një anëtar të familjes ose ndonjë person të tretë në lidhje me paraburgimin, të drejtës për qasje në avokat dhe të drejtës për qasje te mjeku. Këto të drejta duhet të vlejnjë që nga fillimi i privimit nga liria, me fjalë të tjera, prej momentit kur personi në fjalë është i obliguar të mbetet në polici. Këto të drejta nuk duhet t'i gëzojnë vetëm të dyshuarit për veprimtari kriminale, por edhe të gjitha klasifikimet e tjera të personave të privuar nga liria (p.sh. personat e vendosur në paraburgim administrativ, personat e paraburgosur sipas legjislacionit për të huaj, etj.). Për më tepër, personat e paraburgosur nga policia duhet të informohen qartë lidhur me të gjitha të drejtat e tyre, përfshirë edhe ato të përmendura më sipër, pa vonesë dhe në gjuhën të cilën e kuptojnë.

22. Në Kosovë vlejnjë, në parim, të gjitha të drejtat e sipërpërmendura që nga momenti kur personi privohet nga liria<sup>9</sup>. Megjithatë, zbatimi në praktikë i këtyre të drejtave nuk ka qenë gjithmonë i kënaqshëm, sidomos, lidhur me të drejtën e personave të paraburgosur për të pasur qasje në avokat.

23. E drejta e njoftimit për ndalim është paraqitur në nenin 14, paragrafët 1 dhe 3<sup>10</sup>, dhe në nenin 215, paragrafin 1<sup>11</sup>, të KPPP. Në bazë të informatave të mbledhura gjatë vizitës në intervistat e bëra me personat e paraburgosur dhe shqyrtimit të dosjeve individuale shihet që kjo e drejtë në përgjithësi është respektuar mirë (përfshirë edhe rastet kur në pyetje ishin të miturit, ku është i detyrueshëm njoftimi i përfaqësuesve ligjor ose të Qendrës për Punë Sociale për ndalimin e të miturit<sup>12</sup>).

Sipas nenit 215, paragrafit 4, të KPPP, njoftimi për ndalimin e një të rrituri mund të vonohet deri në 24 orë në bazë të vendimit të prokurorit publik nëse “është e nevojshme të bëhet njoftimi më vonë për shkak të nevojave të jashtëzakonshme të hetimeve lidhur me rastin”. Informatat e mbledhura gjatë vizitës kanë treguar që mundësia e shtyrjes së të ushtruarit të së drejtës për njoftim është përdorur shumë rrallë (lidhur me ofrimin e informatave personave të paraburgosur për të drejtën për njoftim, shih paragrafin 29).

---

<sup>9</sup> Lidhur me të paraburgosurit e imigrimit, të drejtat e personave të paraburgosur të paraqitura në KPPP vlejnjë përshtatshmërisht (*mutatis mutandis*) (sipas nenit 20, paragrafit 2, të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/16 mbi Lëvizjen e Personave që hyjnë në Kosovë dhe dalin nga ajo).

<sup>10</sup> Personi i privuar nga liria e gëzon të drejtën për ta njoftuar ose kërkuar që të njoftohet një anëtar i familjes ose ndonjë person tjetër i përshtatshëm të cilin e zgjedhë ai lidhur me arrestimin *gjatë tërë kohës së qenit i privuar nga liria* (me theks të posaçëm).

<sup>11</sup> Personi i arrestuar ka të drejtë ta njoftojë një anëtarë të familjes ose ndonjë person tjetër të përshtatshëm të cilin e zgjedhë ai lidhur me arrestimin dhe vendin e ndalimit *menjëherë pasi që të bëhet arrestimi* ose të kërkojë nga policia ta bëjë këtë (me theks të posaçëm)

<sup>12</sup> Neni 215, paragrafi 2, i KPPP.

24. KPPP<sup>13</sup> dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/36 për ndihmën juridike<sup>14</sup> përmban dispozita të ndryshme të cilat zyrtarisht e garantojnë të drejtën e personit të paraburgosur të ketë qasje te avokati dhe, nëse është e përshtatshme, të përfitojnë nga ndihma juridike falas, “që nga momenti i arrestimit e më tutje”. Neni 213, paragrafi 3, i KPPP përcakton që “personi i arrestuar ka të drejtë të komunikojë në fshehtësi me avokatin mbrojtës me gojë dhe me shkrim”<sup>15</sup>. Nëse personi i arrestuar dyshohet për terrorizëm ose krim të organizuar dhe ka arsye të besohet që avokati mbrojtës të cilin e ka zgjedhur personi i arrestuar është i përfshirë në kryerjen e veprës penale, ose do ta pengojë kryerjen e hetimeve, gjykatësi i procedurës paraprake mund, me kërkesë të prokurorit publik, të urdhërojë që të emërohet një avokat tjetër mbrojtës për ta përfaqësuar personin e arrestuar për periudhën maksimale prej 72 orëve prej kohës së arrestimit<sup>16</sup>.

25. Një numër i personave të paraburgosur kanë pohuar që nuk kanë mundur të kontaktojnë me avokatin në fillim të privimit të tyre nga liria, por vetëm në kohën kur ka nisur periudha fillestare e marrjes në pyetje nga oficeri i policisë për hetime penale (e cila në disa raste ka ndodhur disa orë pas privimit të personit nga liria). Në disa raste, e drejta e qasjes në avokat sipas pohimeve është bërë efektive pas periudhës fillestare të marrjes në pyetje.

Po ashtu duhet të shtohet që një numër i personave të paraburgosur me të cilët është takuar delegacioni kanë theksuar që nuk ishin këshilluar me avokat, meqë nuk kishin mundësi ta paguanin atë. Kjo tregon që personat në fjalë nuk janë informuar si duhet lidhur me mundësinë që avokati të emërohet *jashtë detyrës zyrtare*. Në lidhje me këtë, ju referohemi vërejtjeve dhe rekomandimeve të bëra në paragrafin 29.

26. KPT dëshiron të theksojë që në bazë të përvojës së tij, rreziku më i madh për kërcënim dhe keqtrajtim është në periudhën e menjëhershme pas privimit nga liria. Si rrjedhojë, mundësia që personat e ndaluar nga policia të kenë qasje te avokati gjatë asaj periudhe është mbrojtje themelore kundër keqtrajtimit. Ekzistimi i asaj mundësie do të ketë ndikim zhbindës te ata persona që mendojnë t'i keqtrajtojnë personat e paraburgosur; për më tepër, avokati është në pozitë të mirë ta ndër marrë vëprimin e duhur nëse vërtetë ndodhë keqtrajtimi.

**KPT rekomandon që të ndërmerren hapa për të siguruar që të drejtën për qasje te avokati e gëzojnë të gjithë personat, të cilët janë të obliguar të qëndrojnë në polici, që nga fillimi i privimit të tyre nga liria.**

27. E drejta e personit të paraburgosur të ketë qasje te mjeku (përfshirë të drejtën e zgjedhjes së mjekut) është shprehur në nenin 214, paragrafi 1, pika 6<sup>17</sup>, dhe 216, paragrafët 1 dhe 2<sup>18</sup>, të KPPP.

Nga informatat e mbledhura gjatë vizitës, duket që e drejta e qasjes te mjeku është garantuar në praktikë.

<sup>13</sup> Nenet 12, 14, paragrafët 1 dhe 3, 213, 214, paragrafi 4, dhe 218, paragrafi 1, i KPPP.

<sup>14</sup> Shih në veçanti nenin 15.

<sup>15</sup> Neni 213, paragrafi 3, i KPPP po ashtu thotë që “komunikimin ndërmjet personit të arrestuar dhe avokatit të tij mbrojtës mund ta shikojë oficeri i policisë por nuk mund ta dëgjojë atë.”

<sup>16</sup> Neni 213, paragrafi 5, i KPPP.

<sup>17</sup> “Personi i arrestuar i gëzon të drejtat në vijim: (...) kryerjen e kontrollit mjekësor dhe trajtimin mjekësor, përfshirë trajtimin psikiatrik”.

<sup>18</sup> “(1) Personi i arrestuar ka të drejtë, në bazë të kërkesës së tij, të kontrollohet nga mjeku ose dentisti të cilin ai e zgjedhë vetë sa më shpejtë që të jetë e mundur pas arrestimit të tij në çdo kohë gjatë periudhës së paraburgimit. (2) Personi i arrestuar ka të drejtë në trajtim mjekësor, përfshirë trajtimin psikiatrik, kurdo që është e nevojshme, në bazë të kërkesës të personit të arrestuar ose të anëtarëve të familjes”.

Megjithatë, ky vlerësim pozitiv i nënshtrohet një kufizimi të madh. Është për t'u brengosur shumë që, pothuajse në të gjitha institucionet policore të vizituara, kontrollet mjekësore në mënyrë sistematike janë kryer në prani të oficerit të policisë. Një gjë e tillë e minon seriozisht efikasitetin e kësaj mbrojtjeje kundër keqtrajtimit; po ashtu është në kundërshtim flagrant me parimin e konfidencialitetit mjekësor. Në lidhje me këtë, **vërejtjet e dhe rekomandimet e paraqitura në paragrafin 95 vlejné njëlloj për të gjitha institucionet policore.**

28. Për më tepër, në shumicën e institucioneve të vizituara nuk ishte garantuar konfidencialiteti i të dhënave mjekësore, pasi që certifikatat mjekësore mbaheshin në dosjet administrative të personave të paraburgosur dhe kështu personeli jomjekësor kishte qasje në to. **Duhet të ndërmerren hapa për ta rregulluar këtë çështje.**

29. Lidhur me informimin për të drejtat, në nenin 14, paragrafin 1, të KPPP, thuhet që çdo person i privuar nga liria informohet menjëherë, në gjuhën të cilën e kupton, lidhur me të drejtat për ta njoftuar një anëtar të familjes ose ndonjë person tjetër të përshtatshëm të cilin e zgjedhë vetë, ose për të kërkuar që të bëhet njoftimi i tyre për arrestimin dhe mbi të drejtën që e ka për pranimin e ndihmës juridike sipas zgjedhjes së tij.

Megjithatë, duket që në praktikë personat e paraburgosur shpesh nuk janë njoftuar menjëherë për të drejtat e tyre. Nga vizita është kuptuar që shumë rrallë është dhënë njoftimi me gojë gjatë arrestimit, dhe njoftimi me shkrim në formë të listës me informata shpesh është vonuar (në disa raste për disa orë), do të thotë deri në momentin kur të dyshuarit njëherë janë intervistuar nga polici që merret me hetimin e krimeve.

**KPT rekomandon që të ndërmerren hapa për të siguruar që të gjithë personat e paraburgosur nga policia – për çfarëdo arsye – të informohen plotësisht lidhur me të drejtat e tyre fundamentale (përfshirë të drejtën për të pasur qasje te mjeku) që nga fillimi i privimit të tyre nga liria (d.m.th, nga momenti kur janë të obliguar të qëndrojnë në polici). Kjo duhet të sigurohet përmes ofrimit të informatave të qarta të cilat jepen me gojë në fillim të ndalimit, dhe të plotësohen në rastin më të shpejtë të mundshëm (d.m.th, menjëherë pasi që personi të hyjë në objektet e policisë) duke ja ofruar një fletë me shkrim, në të cilën paraqiten të drejtat e personave të paraburgosur në mënyrë të hapur. Kjo fletë duhet të jetë në dispozicion në gjuhët e përshtatshme. Për më tepër, nga personat në fjalë duhet të kërkohet ta nënshkruajnë një deklaratë në të cilën dëshmojnë që janë informuar për të drejtat e tyre.**

30. Delegacioni ka gjetur dëshmi që, në disa raste, personat të cilët në realitet ishin të dyshuar për vepra penale u janë nënshtruar intervistave para se të arrestohen zyrtarisht, dhe kjo është bërë pa i njoftuar ata për të drejtat e tyre. Për shembull, në stacionin e policisë në Pejë, delegacioni është takuar me një njeri i cili ishte intervistuar gjoja si “dëshmitar” dhe prandaj nuk ishte informuar për të drejtat e tij. Pas intervistës, hetuesi e informoi delegacionin që, në të vërtetë, personi në fjalë tashmë ishte identifikuar si i dyshuar për vepër penale i përfshirë në një rast serioz dhe që “për momentin” nuk ishte i lirë ta lëshonte stacionin e policisë.

Ky është shembull flagrant i shmangies së policisë nga mbrojtja ekzistuese juridike duke e intervistuar të dyshuarin pa e informuar atë për të drejtat e tij. **Duhet të ndërmerren hapa për t'i ndërprerë praktikat e tilla.**

31. Delegacioni po ashtu ka vërejtur që, në disa raste, të dyshuarit e paraburgosur janë transferuar në dhomat e intervistimit të cilat gjenden jashtë objekteve të paraburgimit të policisë dhe, nganjëherë, ata janë dërguar në dhoma të tilla menjëherë pas kapjes së tyre, para se të transferohen në objektin e ndalimit. Për shembull, në stacionin nr. 2 të policisë në Prishtinë gjendeshin zyrat e skuadrës rajonale për krime (si edhe zyrat e njërive të tjera të specializuara) dhe të dyshuarit herë pas here janë intervistuar aty; megjithatë, në stacion të policisë nuk kishte ndonjë lokal për paraburgim.

Është e qartë që praktika e tillë e krijon mundësinë për keqpërdorim dhe sigurisht nënkupton që mbrojtja kundër keqtrajtimit ka më shumë gjasa të shkilet. KPT e pranon që, në gjendjen e tanishme, intervistimi i të dyshuarve vetëm në stacionet e policisë të cilat kanë lokale të paraburgimit mund të shkaktojë probleme të konsiderueshme logjistike. Megjithatë, **si rregull, kryerja e intervistave vetëm në objektet e tilla duhet të jetë objektiv më afatgjatë.**

Sa i përket mbajtjes së dosjeve lidhur me ndalimin në rast se të dyshuarit transferohen në dhomat për intervistim jashtë objekteve për paraburgim të policisë, referojuni vërejtjeve dhe rekomandimeve të bëra në paragrafin vijues.

32. Gjatë vizitës, delegacioni i ka vënë re disa probleme lidhur me mbajtjen e dosjeve për ndalim:

(a) Delegacioni u befasua kur mori informatën nga kapiteni përgjegjës i njësisë rajonale të krimeve në stacionin nr. 2 të policisë në Prishtinë që ai nuk kishte ide nëse në atë kohë aty ishte duke u mbajtur ndonjë i dyshuar, dhe që e vetmja mënyrë për ta kuptuar këtë ishte të shkonte në secilën zyrë të ndërtesës për të kontrolluar. Nuk ekzistonte asnjë regjistër me dosjet kur ishin sjellë personat e paraburgosur në ndërtesë për intervistë, dhe i vetmi shënim mbahej në dosjet individuale dhe në dosjet e ndalimit në objektin e paraburgimit në stacionin e policisë nr. 1 në Prishtinë.

(b) Ekzistonin disa versione të dosjeve të ndalimit të cilat përdorshin në Kosovë; delegacioni i pa së paku gjashtë versione të ndryshme dhe, me sa duket, kishte edhe më shumë lloje të ndryshme të dosjeve në përdorim. KPT e ndanë plotësisht shqetësimin e shprehur në këtë aspekt nga ana e IPK në raportin e tij të përkohshëm të inspektimit të nëntorit 2006<sup>19</sup>.

(c) Standardi i përfundimit të dosjeve të ndalimit ishte goxha i dobët. Delegacioni hasi në shembuj të shumtë të dosjeve të plotësuara në mënyrë të pasaktë, nënshkrime të vendosura gabimisht, asnjë nënshkrim në vendet ku duhej nënshkruar, dosje të fshira me lëng për përmirësimin e gabimeve të shtypit, etj. Kjo është në veçanti serioze sa i përket qasjes të avokati— në shumë dosje të ndalimit mungonin nënshkrimet në këtë aspekt.

(d) Ruajtja dhe mbajtja e dosjeve të ndalimit dukej që ishte problematike, ashtu siç është vënë re nga inspektorati policor në raportin e përkohshëm të inspektimit të nëntorit 2006<sup>20</sup>. Në disa raste, delegacioni nuk ka mundur t'i gjejë dosjet specifike të ndalimit në stacione të caktuara të policisë, madje edhe në rastet kur personi në fjalë përfundimisht ishte mbajtur aty.

(e) Nga diskutimet me oficerët e policisë në stacione të ndryshme të policisë të vizituara, u kuptua që nuk kishte ndonjë sistem unik për dërgimin e dosjeve origjinale të ndalimit me të paraburgosurin kur ai transferohej në stacionin tjetër policor, dhe kopjet e dosjeve nuk mbahehin gjithmonë në stacionin e parë ku ai ishte ndaluar. Kjo mund të çojë deri te humbja e dosjeve dhe mbajtja e dosjeve jo të plota.

---

<sup>19</sup> Shih paragrafin 2.2.

<sup>20</sup> Shih paragrafin 2.9.

(f) Delegacioni u informua nga oficerët e lartë të policisë që kërkesa për hapjen e dosjeve të ndalimit nuk ka filluar deri sa prokurori e ka autorizuar paraburgimin për një periudhë deri në 72 orë. Në praktikë, dosjet nuk janë hapur deri sa i dyshuari ka arritur në qeli, që mund të jetë një kohë pas paraburgimit të tij, ose madje edhe pas kryerjes së intervistimit nga ana e policisë.

33. KPT mendon që garancitë fundamentale të personave të ndaluar nga policia do të forcoheshin nëse për secilin person do të mbahej një dosje e vetme dhe gjithëpërfshirëse për ndalimin. Në këtë dosje do të futeshin të gjitha aspektet e ndalimit dhe të gjitha masat të cilat janë ndërmarrë në lidhje me të (kur dhe për çfarë arsye (arsyesh) është marrë masa e ndalimit; kur ka mbërri personi në lokalet e policisë; kur është informuar ai lidhur me të drejtat e tij; nëse ka shenja të lëndimit, probleme shëndetësore, çrregullim mendor, etj.; në cilën (cilat) qeli është vendosur; kur është ushqyer; kur është marrë në pyetje; kur ka pasur kontakte me të afërmit, avokatin, mjekun ose përfaqësuesin e shërbimeve këshillimore apo kur është vizituar nga ata; kur është transferuar; kur është sjellë para prokurorit; kur është mbajtur ose liruar, etj.).

**Komisioni rekomandon që në çdo stacion të policisë të hapet një dosje ndalimi e vetme dhe gjithëpërfshirëse për secilin person të paraburgosur.**

Për më tepër, **duhet të ndërmerren hapa për të siguruar që:**

- **dosja për ndalim të dërgohet me të paraburgosurin kur ai të transferohet në një stacion tjetër të policisë dhe një kopje të mbahet në stacionin e policisë ku personi është ndaluar së pari;**
- **kërkesa për hapjen e dosjes së ndalimit vlen prej momentit kur i paraburgosuri arrin në stacionin e policisë (d.m.th madje gjatë gjashtë orëve të para të paraburgimit, para se prokurori ta autorizojë paraburgimin deri në 72 orë);**
- **kërkesa për hapjen e dosjes së ndalimit vlen madje edhe në stacionet e policisë të cilat nuk kanë lokale të paraburgimit, po ku të dyshuarit mbahen në fillim me qëllim që të intervistohen.**

#### 4. Kushtet e paraburgimit

34. Në parim ndalimi nga policia në Kosovë ka kohëzgjatje relativisht të shkurtër. Si rrjedhojë, nuk mund të pritët që kushtet fizike të paraburgimit të jenë po aq të mira në institucionet policore sa edhe në vendet e tjera të paraburgimit ku personat mund të mbahen për kohë më të gjatë. Megjithatë, duhet plotësohen disa kërkesa elementare materiale.

Të gjitha qelitë e policisë duhet të jenë të pastra, të kenë madhësi të arsyeshme për numrin e personave të cilët vendosen aty dhe të kenë ndriçim të përshtatshëm (d.m.th ndriçim të mjaftueshëm për të lexuar, duke e përjashtuar kohën e gjumit) dhe ajrosje; parapëlqehet që qelitë të kenë ndriçim natyror. Për më tepër, qelitë duhet të jenë të pajisura me mjete për pushim dhe personave të cilët janë të obliguar të qëndrojnë tërë natën në ndalim duhet t'ju sigurohet dysheku dhe batanijet e pastra.

Personave të ndaluar nga policia duhet t'ju lejohet t'i kryejnë nevojat fiziologjike kurdo që kjo është e nevojshme, në kushte të pastra dhe të dinjitetshme, dhe duhet t'ju sigurohen lokale të përshtatshme për larje. Ata duhet të kenë qasje të drejtpërdrejtë në ujë të pijshëm dhe duhet t'ju ofrohet ushqim në kohë të duhur, përfshirë së paku një shujtë të plotë (d.m.th diçka më të pasur se një sandviç) çdo ditë.

Personave që mbahen për periudha të gjata (24 orë apo më shumë) duhet t'ju ofrohen artikuj të përshtatshëm për higjienë personale dhe, për aq sa është e mundur, duhet t'ju ofrohen ushtrime jashtë për çdo ditë.

35. Me përjashtim të dukshëm të stacionit policor të Istogut, kushtet materiale në stacionet e policisë të cilat janë vizituar ishin të mjerueshme. Shumë qeli ishin tepër të vogla për numrin e personave të cilët mbaheshin aty, nuk kishin dritë natyrale dhe/ose ndriçim të mjaftueshëm artificial dhe ishin në gjendje të mjerueshme sa i përket pastërtisë. KPT është në veçanti i shqetësuar me madhësinë e dy qelive në stacionin e policisë në Deçan, të dyja ishin diku 2.5 m<sup>2</sup>. Sipas mendimit të Komisionit, **qelitë e madhësisë së tillë duhet të shfrytëzohen vetëm për mbajtje të përkohshme, jo më gjatë se disa orë, dhe kurrë nuk duhet të shfrytëzohen për vendosjen e personave për tërë natën.**

36. KPT dëshiron ta shprehë mirënjohjen e tij për monitorimin e kryer nga Departamenti për të drejta të njeriut dhe sundim të ligjit i OSBE-së për kushtet e paraburgimit në objektet e paraburgimit të policisë në Kosovë. Pas vizitave të kryera në të gjitha 89 qelitë e ndalimit nga ana e policisë në Kosovë, kushtet ekzistuese u vlerësuan duke i krahasuar me standardet përkatëse të KPT-së dhe janë konkretizuar në hollësi në "Raportin për qelitë e mbajtjes: rivlerësim" në nëntor 2005.

Fatkeqësisht, informatat e mbledhura gjatë vizitës së KPT-së kanë dëshmuar që shumë pak përmirësime janë bërë në lidhje me kushtet e paraburgimit në stacionet e policisë, të cilat janë vizituar që nga publikimi i raportit të sipërpërmendur<sup>21</sup>. Në disa aspekte, situata madje është përkeqësuar prej atëherë.

---

<sup>21</sup> Të meta të ndryshme janë vërtetuar po ashtu nga IPK në raportin e tij të përkohshëm të inspektimit të nëntorit 2006 mbi "Arrestimet e SHPK-së dhe mënyra e kryerjes së menaxhimit të paraburgimit".

37. Duke i marrë parasysh gjërat e mësipërme, **KPT rekomandon që të ndërmerren hapa pa vonesë për të siguruar përmirësimin kuptimplotë të kushteve materiale në stacionet e policisë të cilat janë vizituar (dhe, nëse është e nevojshme, në objektet e tjera policore të paraburgimit në Kosovë), në veçanti, sigurimin e dritës natyrale, ajrosjes dhe higjienës.**

Për më tepër, **Komisioni rekomandon që autoritetet ta krijojnë një plan të hollësishëm në mënyrë që t'i rinovojnë në mënyrë progresive të gjitha objektet policore të paraburgimit në Kosovë.**

## 5. Çështjet e tjera

38. KPT është i shqetësuar për mënyrën si janë shfrytëzuar prangat në disa raste. Për shembull, një i paraburgosur ka pohuar që është mbajtur i lidhur me pranga për radiatorit në stacionin e policisë në Fushë Kosovë për disa orë. Një person tjetër i paraburgosur ka pohuar që ia kishin lidhur një dorë me pranga për karrige (e cila ishte e ngjitur për dyshemeje) deri sa ishte duke u marrë në pyetje nga oficeri i policisë për çështje kriminale.

Komisioni ka rezerva serioze lidhur me praktikën e prangosjes së personave të paraburgosur për objekte të fiksuara. Mund të jetë e pranueshme në rrethana të jashtëzakonshme (për shembull prangosja për parmakë në zyrën e ndalimit në rastet kur disa persona të paraburgosur presin për shqyrtim). Megjithatë, **përdorimi i mjeteve të tilla nuk është i pranueshëm nëse përdoren për një periudhë të gjatë ose në prani të të tjerëve. Për më tepër, nuk ka kurrfarë arsytimi për përdorimin e prangave deri sa i dyshuari është duke u intervistuar. Përgjithësisht, prangat nuk duhet të përdoren si zëvendësim për objektet e përshtatshme për mbajtje.**

39. KPT po ashtu ka dyshime lidhur me ekspozimin e papërshtatshëm të simboleve politike, ashtu siç i ka vërejtur delegacioni në stacionin e policisë nr. 1 në Prishtinë. Në kuadër të kompleksit ishte zyra për administrata/zbulim ku, në mesin e gjërave të tjera, mbaheshin të dhënat në kompjuter për personat të cilët mbaheshin në stacion. Në zyrë ishin ekspozuar në vend të dukshëm dy fotografi të oficerëve të SHPK-së, përgjegjës për mbajtjen e shënimeve, në uniformë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Edhe pse personat e paraburgosur nuk kishin qasje në zyrë dhe prandaj nuk do kishin mundësi t'i shihnin fotografitë, ekspozimi i materialit të tillë, sipas mendimit të KPT-së, është i padëshirueshëm në stacionin e policisë sepse mund ta vë në dyshim paanshmërinë e oficerëve në fjalë<sup>22</sup>. **Komisioni dëshiron t'i pranojë komentet e UNMIK-ut lidhur me këtë çështje.**

---

<sup>22</sup> Cf., në lidhje me këtë, shih po ashtu nenet IV-K ("Qëndrimi dhe paanshmëria") dhe V-D ("Shfrytëzimi i ndikimit të pozitës për qëllime politike") të "Rregullave të udhëheqjes dhe sjelljes" të politikave dhe procedurave të SHPK-së.

## **B. Institucionet ndëshkimore**

### **1. Vërejtjet paraprake**

40. Delegacioni i KPT-së i ka vizituar gjashtë institucione ndëshkimore: burgun e Dubravës, qendrën korrektuese të Lipjanit dhe qendrat e paraburgimit në Gjilan, Mitrovicë, Pejë dhe Prishtinë.

41. **Burgu i Dubravës** është institucioni më i madh i burgut në Kosovë, i vendosur në një hapësirë të madhe në mes të natyrës, pak më larg se fshati me të njëjtin emër. I ndërtuar më 1976, kompleksi i burgut ka pësuar dëmtim të rëndë nga bombat gjatë luftës së vitit 1999 – rreth njëqind të burgosur e humbën jetën– dhe, që atëherë, është rindërtuar dhe rinovuar në mënyrë të konsiderueshme. Burgu i ka tetë blloqe të paraburgimit dhe një bllok të ndarë ku gjenden spitali i burgut dhe infermeria. Me një kapacitet zyrtar prej 1,105 vendeve, gjatë vizitës në institucion ishin të vendosur 884 meshkuj të burgosur (787 të dënuar dhe 97 të paraburgosur).

**Qendra korrektuese e Lipjanit**, e cila gjendet në objekte të mëdha diku 20 km në jug të Prishtinës, shërben si objekt i vetëm i paraburgimit në Kosovë për femrat e burgosura dhe të miturit (edhe për të dënuarit edhe ata të paraburgosur). Për shkak të mungesës së ndonjë institucioni të përshtatshëm arsimor në Kosovë, të miturit të cilët në bazë të urdhrit të gjykatës i nënshtrohen vendosjes në “qendër disiplinore”<sup>23</sup>, në “institucion arsimor”<sup>24</sup> ose në “institucion arsimor - korrektues”<sup>25</sup> po ashtu mbahen në qendrën korrektuese në Lipjan. Qendra po ashtu ka kapacitet zyrtar prej 152 vendeve. Në kohën kur është kryer vizita, aty ishin të vendosura 36 femra të burgosura (26 të dënuara dhe dhjetë të paraburgosura) dhe 48 të mitur (32 të dënuar, tetë të paraburgosur dhe tetë të cilët i ishin nënshtuar vendosjes në institucion arsimor).

Të gjitha **qendrat e vizituara të paraburgimit** ishin projektuar si objekte të paraburgimit, por aty po ashtu ishin të vendosur një numër i konsiderueshëm i të burgosurve të dënuar, pjesa më e madhe e të cilëve vuante dënime të shkurta. Megjithatë, një numër i të burgosurve vuante dënime shumë të gjata (deri në 20 vjet) sidomos në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë. Femrat e burgosura dhe të miturit kurrë nuk pranoheshin në qendrat e paraburgimit, por menjëherë transferoheshin në qendrën korrektuese të Lipjanit. Në kohën e kryerjes së vizitës, në qendrën e paraburgimit në Gjilan (kapaciteti: 90 vende) ishin të vendosur 85 të burgosur (përfshirë 24 të dënuar), në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë (kapaciteti: 79 vende) 47 të burgosur (përfshirë 23 të dënuar), në qendrën e paraburgimit në Pejë (kapaciteti: 76 vende) 75 të burgosur (përfshirë 13 të dënuar) dhe në qendrën e paraburgimit në Prishtinë (kapaciteti: 65 vende) 60 të burgosur (përfshirë 6 të dënuar).

---

<sup>23</sup> Sipas nenit 19 të Kodit për të Mitur të Kosovës (KM – i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/8).

<sup>24</sup> Sipas nenit 24 të KM.

<sup>25</sup> Sipas nenit 25 të KM.

## 2. Keqtrajtimi

42. Delegacioni nuk ka marrë kurrfarë pohimesh për keqtrajtim të qëllimshëm fizik të shkaktuar nga ana e personelit që merret me ndalim në asnjërin prej qendrave të paraburgimit të cilat i ka vizituar. Megjithatë, disa pohime të këtij lloji janë dëgjuar në burgun e Dubravës dhe në qendrën korrektuese të Lipjanit. Për më tepër, disa të burgosur me të cilët është takuar delegacioni në Lipjan dhe në qendrën e paraburgimit në Prishtinë janë ankuar për raste të sharjes nga oficerët e burgut.

**KPT rekomandon që menaxhmenti i burgut të Dubravës, i qendrës korrektuese në Lipjan dhe i qendrës së paraburgimit në Prishtinë t'ua përkujtojnë personelit të tyre që asnjë formë e keqtrajtimit të të burgosurve (përfshirë sharjen) nuk është e pranueshme dhe do të ndëshkohet në përputhje me rrethanat.**

43. Në burgun e Dubravës delegacioni e ka marrë një numër të pohimeve për keqtrajtim dhe/ose përdorim të tepruar të forcës nga ana e pjesëtarëve të njësisë intervenuese të institucionit (të cilëve ju referohen si "Delta Bravo"). Këto pohime që kryesisht kanë të bëjnë me përdorimin e tepruar të forcës gjatë intervenimeve (goditjet me shkop ose me objekte të tjera të topitura, shkelmimet, grushtimet, goditjet me pëllëmbë, etj.), përfshirë edhe rastet kur të burgosurit në fjalë tashmë veç ishin vënë nën kontroll. Për më tepër, në pothuajse të gjitha blloqet e Dubravës, delegacioni ka dëgjuar pohime të shumta për sjellje të vrazhda dhe provokuese nga pjesëtarët e njësisë për intervenim gjatë kryerjes së kontrollimit të qelive.

Disa pohime po ashtu janë dëgjuar në qendrën korrektuese të Lipjanit lidhur me keqtrajtimin dhe/ose përdorimin e tepruar të forcës nga pjesëtarët e njësisë intervenuese të qendrës.

44. Tri raste relativisht të reja janë posaçërisht të rëndësishme në këtë aspekt pasi që i ilustrojnë çështjet e ndryshme.

Rasti i parë ka të bëjë me pohimet për keqtrajtim dhe/ose përdorimin e tepruar të forcës nga pjesëtarët e njësisë për intervenim në burgun e Dubravës, të cilët kanë intervenuar pas një kacafytjeje ndërmjet dy të burgosurve më 22 shkurt 2007. Njëri nga dy të burgosurit gjoja është dërguar nga pjesëtarët e njësisë speciale në shkollën e burgut dhe është rrahur atje, deri sa është mbajtur i shtrirë në tokë dhe i prangosur, në prani të drejtorit të burgut (si edhe të të burgosurve). Për pasojë, zyrtari në fjalë me sa duket është dërguar në sektorin disiplinor (blloku 5) dhe është kontrolluar nga mjeku, i cili e ka shpallur atë të aftë për t'u ndëshkuar (që nuk e ka penguar transferimin e të burgosurit në fjalë në spital dy ditë më vonë).

Dokumentet e konsultuara nga delegacioni (njësia për intervenim, departamenti i sigurisë, etj.) lidhur me këtë incident nuk i përmendin pohimet e sipërpërmendura për keqtrajtim/përdorim të tepruar të forcës. Kur delegacioni e ngriti këtë incident me drejtorin, ky i fundit nuk e mohoi faktin që ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes dhe që nuk ka reaguar lidhur me veprimet e njësisë për intervenim. Qëndrimi i tillë mund vetëm të shkaktojë një ndjenjë të mosndëshkimit në mesin e personelit të njësisë për intervenim (dhe të mos i përmendim pjesëtarët e tjerë të personelit të burgut) dhe, sa ju përket të burgosurve, mund ta minojë rëndë autoritetin e drejtorit të institucionit. **KPT rekomandon të kryhet një hetim i pavarur lidhur me këtë incident dhe nëse është e nevojshme të shqiptohen sanksione të përshtatshme në të gjitha nivelet.**

45. Në rastin e dytë në Dubravë, një grup prej katër të burgosurve gjoja janë rrahur me shkopinj nga pjesëtarët e njësisë për intervenim gjatë kontrollimit të një qelie më 20 shkurt 2007. Në mënyrë më specifike thuhet që keqtrajtimi ka filluar në qelinë për izolim në katin e njëjtë ku ishin vendosur të katër të burgosurit në fjalë gjatë kontrollimit dhe kishte vazhduar në qelinë e sigurisë (e ashtuquajtur qelia “VS”) në katin për dhese, në mënyrë që t’i shtyjnë ata ta zbulojnë e kujt ishte thika dhe një kartelë e telefonit mobil të cilat ishin gjetur gjatë kontrollimit. Pas pranimit, njëri nga të burgosurit në fjalë ka pohuar që ishte vendosur në qelinë për izolim dhe në të njëjtën ditë ishte kontrolluar nga mjekët e burgut, të cilët, pa hyrë fare në qelinë për izolim, gjoja kishin thënë që “çdo gjë ishte në rregull”, në praninë e oficerit të burgut.

46. Rasti i tretë ka të bëjë me rrahjen e pohuar kolektive të të burgosurve në qendrën korrektuese të Lipjanit. Më 23 shkurt 2005, pas zbulimit të një telefoni mobil gjatë kontrollimit të një qelie në njësinë në të cilën ishin të vendosur të burgosurit « me rrezik të lartë » në bllokun D, të miturit në fjalë gjoja u vendosën për disa orë në qelitë për izolim të cilat gjenden në katin për dhese të ndërtesës. Pastaj, ata gjoja i kanë kthyer përsëri në qelitë e tyre. Duke u ngjitur shkallëve, ata janë rrahur njëri pas tjetrit nga pjesëtarët e njësisë për intervenim (të cilët mbanin maska), të cilët kishin përdorur shkopinj të gomës dhe të metalit. Një i mitur gjoja kishte pësuar thyerje të njëres dorë si pasojë e rrahjes, ndërsa të tjerët thuhet që kishin pësuar lëndime më pak serioze. Më tej është pohuar që të miturit në fjalë kishin kërkuar të fotografohen dhe të bënin ankesë në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, por të dy kërkesat ishin refuzuar.

47. Të gjitha incidentet e lartpërmendura kanë ndodhur disa javë apo më shumë kohë para vizitës së delegacionit; për pasojë nuk mund të arrihet në asnjë konkludim në bazë të faktit që të burgosurit në fjalë nuk kishin kurrfarë lëndimi të dukshëm në kohën e vizitës. Të shikuarit e dosjeve të tyre mjekësore ka zbuluar që shënimet ishin të kufizuara, në rastin më të mirë, në regjistrimin e faktit që i burgosuri është vizituar nga mjeku në qelinë për izolim. Në lidhje me këtë, **KPT dëshiron të theksojë që çdo i burgosur kundër të cilit është përdorur forca duhet të ketë të drejtë të kontrollohet menjëherë nga mjeku dhe nëse është e nevojshme të trajtohet.** Lidhur me regjistrimin e lëndimeve dhe praninë e oficerit të burgut gjatë këshillimeve mjekësore, **referojuni vërejtjeve dhe rekomandimeve në paragrafët 91 deri 95.**

48. Delegacioni ka biseduar gjatë me udhëheqësin e njësisë për intervenim në burgun e Dubravës. Njësia përbëhet nga 14 pjesëtarë, dhe detyrat e tyre janë si vijon: kontrollimet e qelive; intervenimi për t’u marrë me rezistencë aktive apo pasive; përdorimi i mjeteve të përmbajtjes dhe kontrollit (me kërkesë të drejtorit ose të njërit nga zëvendësit e tij); aftësimi i rojave të sigurisë lidhur me teknikat e përmbajtjes dhe të kontrollit; patrullimet për sigurimin e perimetrit të burgut, etj. Personeli i njësisë rekrutohet dhe zgjidhet nga mesi i personelit të burgut dhe duhet të jenë të aftë fizikisht. Ata vijojnë një aftësim themelor një javor lidhur me teknikat e përmbajtjes dhe të kontrollit dhe pastaj angazhohen në ushtrime fizike çdo ditë (50% e programit ditor, ndërsa pjesa tjetër ju kushtohet detyrave të sipërpërmendura).

49. KPT nuk e konteston nevojën e ekzistimit të njësive të posaçme për intervenim, të cilat janë të afta të intervenojnë në institucionet ndëshkimore në Kosovë si mjet i fundit. Megjithatë, duhet të ndërmerren masa themelore për parandalimin e reagimeve joadekuate, të cilat janë të lidhura me një ndjenjë të fuqishme se i takon një force elite të bashkuar me rreziqet me të cilat duhet ballafaquar. Në këto masa përfshihet menaxhmenti i vendosur profesional i vëmendshëm ndaj çdo sjellje të keqe, që është me rëndësi jetike të dënohet, dhe ndaj politikës për alternimin e personelit. Për më tepër, për të qenë në gjendje të vlerësosh si kryhet intervenimi, është me rëndësi themelore që raportet e intervenimeve të hartuara nga udhëheqësit e ekipit të jenë sa më të hollësishme që është e mundur. Në këto raste, është për t'u habitur që ishin të shkurta. Në fund, incidenti i përmendur më sipër i 22 shkurtit 2007 duket që nuk është trajtuar ashtu si duhet në takimin informativ pasues të organizuar me personelin dhe nga udhëheqësi i njësisë nuk është kryer asnjë hetim disiplinor.

50. Duke i marrë parasysh gjërat e lartpërmendura, **KPT rekomandon që të ndërmerren hapa të menjëhershëm në burgun e Dubravës dhe në qendrën korrektuese të Lipjanit për t'u siguruar që, kurdo që shfaqen pohime për keqtrajtim pas intervenimit të njësive për intervenim, të kryhen menjëherë hetime të brendshme (pa paragjykime ndaj ndonjë hetimi që duhet të kryhet nga autoritetet administrative dhe/ose gjyqësore).** Për më tepër, **pas çdo intervenimi udhëheqësit e ekipit në fjalë duhet të hartojnë raporte të hollësishme lidhur me intervenimin.**

Për më tepër, **Komisioni i fton autoritetet përkatëse ta fusin në përdorim politikën e alternimit për pjesëtarët e njësive për intervenim.**

Përgjithësisht, është me rëndësi themelore që t'i kushtohet vëmendje më e madhe zgjedhjes, rekrutimit, aftësisht (përfshirë menaxhimin e stresit), ushtrimit fizik dhe pajisjes së pjesëtarëve të njësive speciale, në mënyrë që të sigurohet që ata janë të përgatitur për t'u marrë në mënyrë të përshtatshme (p.sh. duke e përdorur forcën minimale) me situatat e rrezikshme.

51. KPT e ka parasysh faktin që detyrat e njësive për intervenim shpesh janë të vështira dhe të rrezikshme dhe që shpesh do të jetë i nevojshëm përdorimi i forcës kundër të burgosurve gjatë kryerjes së atyre detyrave. Megjithatë çdo forcë e përdorur gjatë intervenimit duhet të jetë e kufizuar vetëm në atë që është e domosdoshme. Përveç kësaj, sapo të vihet nën kontroll i burgosuri i pabindur, nuk mund të ketë arsytim për goditjen e tij. **KPT rekomandon që, në përputhje me rrethanat, kjo t'ju kujtohet të gjithë pjesëtarëve të njësive për intervenim në burgun e Dubravës dhe në qendrën korrektuese në Lipjan.**

52. Po ashtu duhet theksuar që pjesëtarët e njësive për intervenim shpesh kanë vënë maska gjatë intervenimeve dhe nuk i kanë ekspozuar distinkтивët ose simbolet e tjera të cilat e bëjnë të mundur identifikimin e tyre. KPT e kundërshton mbajtjen e maskave nga pjesëtarët e njësive për intervenim – ose nga ndonjë anëtarë tjetër i personelit të burgut – brenda burgut. Në veçanti, kjo mund ta pengojë identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës kur ndodhin aktet e keqtrajtimit.

Komisioni e kupton që, për arsye operative, zbatimi i ndonjë forme për mbrojtjen e fytyrës mund të jetë i domosdoshëm. Megjithatë, në atë rast, mbajtja e etiketave që duken qartë në uniformë me emër dhe numër duhet ta mundësojnë identifikimin e personit në fjalë në çdo kohë nga ana e autoriteteve të cilat janë përgjegjëse për operacionet dhe nga ata që e kanë për detyrë ta bëjnë monitorimin, si edhe nga të burgosurit.

**KPT rekomandon të ndërmerren hapa nga autoritetet përkatëse për të siguruar që rregullat e mësipërme të zbatohen praktikë në të gjitha institucionet ndëshkimore në Kosovë.**



### 3. Kushtet materiale të paraburgimit

#### a. Burgu i Dubravës

53. Kushtet materiale në burgun e Dubravës<sup>26</sup> ndryshonin në mënyrë të konsiderueshme nga njëri bllok në tjetrin dhe nganjëherë madje edhe ndërmjet dy njësive të bllokut të njëjtë.

Ato mund të konsiderohen në përgjithësi të mira në blloqet e ndërtuara së fundi ose të renovuara (siç janë blloqet 2 dhe 6) dhe të kënaqshme në bllokun 1. Hapësira jetësore e siguruar për secilin të burgosur në bllokun 6 (një bllok i ri i vënë në përdorim në shtator 2005) ishte e përshtatshme; në qelinë standarde (rreth 20 m<sup>2</sup>) ishin të vendosur katër të burgosur. Kushtet ishin më të kufizuara në bllokun 2, ku në qelitë prej 20 m<sup>2</sup> ishin të vendosur deri në gjashtë të burgosur (tri grupe me nga dy shtretër të burgut) dhe në qelitë prej rreth 15 m<sup>2</sup> ishin të vendosur deri në katër të burgosur. Në bllokun 1, qelitë ishin rreth 15 m<sup>2</sup> dhe varësisht nga rrethanat në to mund të vendoseshin deri tre të burgosur. Qelitë në këto tri blloqe ishin të ndriçuara dhe të ajrosura shumë mirë dhe të pajisura në mënyrë gjithëpërfshirëse (shtretërit dhe shtresat e mbulesat, tavolinat, karriget, dollapi i rrobave, tualeti dhe lavamani të ndara).

54. Në anën tjetër, në bllokun 5 kushtet materiale ishin mesatare ndërsa në disa pjesë të blloqeve 7 dhe 8 në disa raste ishin madje edhe të mjerueshme. Pjesë të caktuara të këtyre blloqeve ishin të stërmbushura (për secilin të burgosur vetëm 2 m<sup>2</sup> të hapësirës për jetesë). Në një qeli në bllokun 7, për shembull, delegacioni i ka parë tetë të burgosur në një qeli prej 16.5 m<sup>2</sup>; një qeli tjetër të madhësisë së ngjashme në bllokun 8 (njësia V1) e ndanin gjashtë të burgosur. Për më tepër, delegacioni u njoftua që situata ishte edhe më e keqe disa muaj më parë, pasi që në njësinë V2 në bllokun 8, në të cilën ishin të vendosur 24 të burgosur në kohën e kryerjes së vizitës, kishin qëndruar deri 77 të burgosur më 2006.

Efektet negative të mbipopullimit ishin kombinuar me gjendjen e përparuar të rrënimt të disa prej lokaleve të vizituara<sup>27</sup>, si edhe me problemet e higjienës dhe të mirëmbajtjes<sup>28</sup>.

Në një letër të datës 26 qershor 2007, UNMIK-u e informoi KPT-në që “renovimi i blloqeve 4 dhe 8 është caktuar të bëhet këtë viti (2007). Megjithatë, për shkak të kufizimeve buxhetore, nuk do të jetë e mundur të bëhet asnjë renovim i qelive të burgut gjatë këtij viti fiskal”.

**KPT rekomandon marrjen e hapave pa vonesë për renovimin e blloqeve, të cilat nuk kanë përfituar nga puna e tillë, në burgun e Dubravës. Po ashtu duhet të bëhet përpjekje për ta zvogëluar numrin e personave në ato qeli të cilat aktualisht janë të mbipopulluara; qëllimi duhet të jetë të sigurohen së paku 4 m<sup>2</sup> të hapësirës për jetesë për secilin të burgosur në qelitë e destinuara për më shumë të burgosur dhe 9 m<sup>2</sup> të hapësirës për jetesë në qelitë për një person.**

<sup>26</sup> Delegacioni e ka përqendruar vizitën e tij në blloqet 1, 2, 5, 6, 7 dhe 8.

<sup>27</sup> Qarqet elektrike në disa prej ndërtesave (në disa pjesë të blloqeve 5 dhe 8, për shembull) ishin nxjerrë jashtë ose nuk ishin në rregull.

<sup>28</sup> Në nëntor 2006, shumë të burgosur hynë në grevë urie duke protestuar kundër kushteve ekzistuese të paraburgimit.

55. Delegacioni po ashtu ju ka kushtuar vëmendje masave të marra për ta siguruar sigurinë fizike të të burgosurve. Në lidhje me këtë, ai ka vënë re që, pas marrjes së pengjeve dhe incidentit të arratisjes së dështuar në bllokun 1 në dhjetor 2005, çelësat e drynave të të gjitha dyerve të qelive në institucion dhe të daljeve në raste urgjente të të gjitha blloqeve ishin centralizuar në një vend të sigurt natën. Sistemi i tillë në mënyrë të pashmangshme e ngritë çështjen nëse në rast të ndonjë incidenti serioz (si zjarri)<sup>29</sup> do të ishte i mundur evakuimi i shpejtë i njësisë – ose madje i tërë bllokut. Kur u ngrit kjo çështje me menaxhmentin e burgut, këta të fundit thanë që ishin të sigurt që po të ndodhte ndonjë incident, personeli që ishte kujdestar (të cilët kishin qasje te të gjithë çelësat) do të reagonte me shpejtësi të mjaftueshme për t'iu shmangur ndonjë problemi serioz. Sidoqoftë, po ashtu e pranuan që kurrë nuk kishin kryer ndonjë ushtrim të evakuimit gjatë natës, në kushte të vërteta, në mënyrë që të mund ta vërtetonin në mënyrë efikase sigurinë e procedurave të evakuimit. Delegacioni mori vesh që menaxhmenti kishte për qëllim ta kryente një ushtrim të tillë gjatë javëve në vijim pas vizitës së delegacionit.

**KPT dëshiron të informohet në hollësi për rezultatin e atij ushtrimi si edhe për ndonjërin prej masave të cilat janë marrë më pas.**

b. Qendra korrektuese në Lipjan

56. Kushtet materiale të paraburgimit ishin në përgjithësi të pranueshme në qendrën korrektuese në Lipjan, sa i përket rregullimit, hapësirës jetësore<sup>30</sup>, higjienës dhe qasjes në dritë natyrore dhe ndriçim artificial. Të gjitha qelitë ishin të pajisura ngjashëm me shtretër, tavolina dhe karrige, dhe me tualet të ndarë plotësisht. Qelitë në njësinë e femrave ishin po ashtu të dekoruara mirë. Delegacioni fitoi përshtypje posaçërisht të favorshme në njësinë e nënës dhe fëmijës, e cila gjendej në një ndërtesë të posaçme. Ajo kishte madhësi prej 40 m<sup>2</sup> dhe përbëhej nga dhoma e ditës, njësia e kuzhinës, dhoma e fjetjes dhe banja, që të gjitha të mobiluara mirë dhe kishin qasje shumë të mirë në dritë natyrore dhe në ajrosje.

57. Mirëpo, delegacioni ka gjetur disa të meta në qendër.

Kushtet materiale në *njësinë e të miturve* ishin goxha të ashpra dhe krijonin një atmosferë shtypëse.

Në *njësinë e femrave*, nën-njësia për të burgosurat e dënuara ishte e mbipopulluar në kohën kur është kryer vizita (26 të burgosura, përfshirë një të mitur, në një kapacitet zyrtar prej 21 vendeve). Si rrjedhojë, dy të burgosura ishin vendosur përkohësisht në njërin nga qelitë disiplinore<sup>31</sup>. Për më tepër, qasja te drita natyrore ishte e kufizuar në njërin qeli (nr. 9), për shkak të faktit që dritarja ishte e ndarë në dy pjesë nga muri që e ndante tualetin nga hapësira për jetesë. Përveç kësaj, të burgosurave nuk ju siguroheshin mantarët higjienik. Ato mund të bliheshin në shitoren e burgut, por disa gra treguan që nuk kishin para për të blerë artikuj të tillë.

<sup>29</sup> Shqetësimet e KPT-së lidhen po ashtu me faktin që në gusht 2004 shpërtheu një zjarr në bllokun 2, duke shkaktuar vdekjen e pesë të burgosurve, me sa duket nga asfiksia. Sistemi i "mbledhjes së çelësave gjatë natës" ende nuk ishte në përdorim në atë kohë.

<sup>30</sup> Në sektorin e femrave, pjesa më e madhe e të burgosurave mbaheshin në qeli për dy persona (me madhësi afërsisht 11 m<sup>2</sup>), dhe disa ishin në qeli me katër shtretër (me madhësi afërsisht 16 m<sup>2</sup>).

<sup>31</sup> Gjendja e dy grave në fjalë ishte lehtësuar nga fakti që të dyjat punonin në kuzhinë dhe e kalonin pjesën më të madhe të ditës jashtë qelisë së tyre.

Në përgjithësi, KPT është i shqetësuar me disa prej masave ekzistuese të sigurisë, të cilat mund të jenë të dëmshme për sigurinë e të burgosurve. Së pari, gypat e ujit në rast të zjarrit nuk ishin lehtë të arritshëm, meqë drynat e dollapëve në të cilët ishin vendosur ata ishin të siguruar nga një lloj i plumbimit plastik i cili përdoret për 'prangat nga plastika', të cilët nuk mund të hapen pa përdorimin e mjete të forta për prerje. Së dyti, ngjashëm me gjendjen në Dubravë, çelësat për qelitë ishin marrë nga secili bllok dhe mbaheshin në dhomën kryesore të kontrollit gjatë natës. Në rast të zjarrit ose të ndonjë incidenti tjetër ku do të nevojitej qasja në qeli, dikush duhet të shkonte dhe t'i merrte ata. Oficerët me të cilët biseduam e pranuan që në rast të ndonjë incidenti, vështirë se do të arrihej hyrja në qeli me kohë.

KPT rekomandon që të merren hapa të duhur nga autoritetet përkatëse për ta përmirësuar të metën e sipërpërmendur në qendrën korrektuese në Lipjan.

c. Qendrat e paraburgimit të cilat janë vizituar

58. Kushtet materiale në qendrat e paraburgimit të cilat janë vizituar ndryshonin në mënyrë të konsiderueshme nga njëra qendër në tjetrën. Në përgjithësi ishin të kënaqshme në Gjilan dhe në Mitrovicë, më pak të kënaqshme ishin në Prishtinë dhe shumë të këqija ishin në Pejë.

*Qendra e paraburgimit në Gjilan* ishte në gjendje mjaft të mirë sa i përket rregullimit dhe pastërtisë. Megjithatë, hapësira e jetesës për të burgosurit ishte goxha e kufizuar në qelitë më të mëdha (afërsisht 18 m<sup>2</sup> për gjashtë të burgosur) dhe qartë e pamjaftueshme në qelitë më të vogla, të cilat kishin më pak se 6 m<sup>2</sup> dhe shfrytëzoheshin për dy persona. Një sallë për aktivitete të brendshme sportive ishte rinovuar rishtazi, por ende i mungonin pajisjet. Për më tepër, një numër i të burgosurve treguan që nuk kishin mundësi të blinin prodhime për higjienë personale.

Në *qendrën e paraburgimit në Mitrovicë*, kushtet materiale të paraburgimit ishin po ashtu në përgjithësi të kënaqshme. Por, shumë të burgosur ankoheshin për temperaturat tepër të larta në qeli gjatë verës dhe hapësira jetësore për të burgosur ishte qartë e pamjaftueshme në disa prej qelive më të vogla. Për shembull, delegacioni gjeti qeli me madhësi prej vetëm 5 m<sup>2</sup> në të cilën ishin të vendosur dy të burgosur. Diçka e tillë është e papranueshme.

Në *qendrën e paraburgimit në Prishtinë*, kushtet në qeli ishin në përgjithësi të pranueshme. Megjithatë, në disa qeli, qasja te drita natyrore ishte goxha e kufizuar. Për më tepër, në disa prej dusheve mungonin dorëzat për dush. Një numër i të burgosurve po ashtu pohuan që prodhimet për higjienë personale nuk siguroheshin rregullisht dhe që materiali për pastrim nuk sigurohej fare. Lidhur me sigurinë e të burgosurve, disa të burgosur pohuan që personeli nuk ishte në gjendje ta hapte derën e qelisë për më tepër se një orë pasi që ishin alarmuar për një sulm epileptik që kishte pësuar një i burgosur.

Kushtet materiale në përgjithësi ishin shumë të këqija në *qendrën e paraburgimit në Pejë*, sidomos në blloqet B dhe D. Në të dy blloqet, shumica e qelive nuk kishin dritare dhe ajrosja ishte shumë e keqe. Për më tepër, të burgosurit mbaheshin shumë ngushtë<sup>32</sup>. Është posaçërisht shqetësuese që në bllokun D disa të paraburgosur mbaheshin me javë ose edhe muaj të tërë në qeli prej më pak se 4 m<sup>2</sup>, plani i të cilave ishte shumë i ngjashëm, ndoshta identik, me atë të qelive disiplinore.

---

<sup>32</sup> Për shembull, në shumë qeli me madhësi prej 11 m<sup>2</sup> (përfshirë aneksin sanitar) mbaheshin nga katër të burgosur.

Sipas këndvështrimit të KPT-së, qelitë e tilla, duke e marrë parasysh vetëm madhësinë e tyre, nuk duhet të shfrytëzohen për vendosjen e të paraburgosurve. Gjatë bisedimeve të kryera në fund të vizitës, delegacioni e bëri një vërejtje të menjëhershme sipas nenit 4, paragrafit 5, të marrëveshjes dhe kërkoi që qelitë e sipërpërmendura të tërhiqen menjëherë nga përdorimi si vend për vendosjen e të burgosurve.

Në një letër të datës 26 qershor 2007, UNMIK-u e informoi KPT-në që katër qelitë e llojit të përshkruar më lart ishin hequr nga shfrytëzimi në qendrën e paraburgimit në Pejë.

**59. KPT rekomandon që autoritetet përkatëse të marrin hapa të përshtatshëm për përmirësimin e të metave të sipërpërmendura që janë hasur në qendrat e paraburgimit të cilat janë vizituar. Në veçanti, duhet të ndërmerren hapa për të siguruar që:**

- në qendrat e paraburgimit në Mitrovicë dhe në Gjilan, qelitë me madhësi ndërmjet pesë dhe gjashtë metra katrorë të shfrytëzohen për vendosjen e vetëm të një personi;
- në qendrat e paraburgimit në Pejë dhe në Prishtinë, të gjitha qelitë të kenë qasje adekuate në dritë natyrore.

Në përgjithësi, Komisioni dëshiron të sjellë ndër mend që qëllimi duhet të jetë që për secilin të burgosur në qelitë e destinuara për më shumë persona të sigurohen së paku 4 m<sup>2</sup> të hapësirës jetësore dhe në qelitë për një person 9 m<sup>2</sup> të hapësirës jetësore.

#### **4. Regjimi**

##### **a. Burgu i Dubravës**

60. Regjimi i paraburgimit në burgun e Dubravës bazohet në klasifikimin prej katër niveleve: themelor, standard, i përparuar dhe i përmirësuar.

Të burgosurit pranohen në institucion me regjim themelor dhe nuk kanë kurrfarë aktiviteti në dispozicion gjatë ditës, përveç ushtrimeve jashtë (më së shumti dy orë në ditë) dhe qasje të kufizuar në të shikuarit e televizionit (një orë në ditë). Pjesën tjetër të kohës janë të mbyllur në qelitë e tyre.

Regjimi standard përfshinë privilegje të konsiderueshme, siç është regjimi i "qelisë së hapur" në pjesën më të madhe të ditës<sup>33</sup>, si edhe periudhat shtesë të ushtrimeve jashtë, dhe mundësia për t'u marrë me aktivitete sportive (përveç fundjavave) ose të vizitojnë sallën e ushtrimeve.

Regjimi i përparuar u jep të drejtë të burgosurve të përfitojnë nga pushimi i përkohshëm dhe ua mundëson aktivitetet për aftësim (nëse ka vende të mjaftueshme për aftësim, që fatkeqësisht është larg nga të qenit kështu), si edhe katër vizita dhe thirrje telefonike çdo muaj. Të burgosurit me këtë regjim kanë qenë kryesisht të vendosur në blloqet 4 dhe 7.

Regjimi i përmirësuar është më i zhvilluari plotësisht. Të burgosurit e përgatitur për status gjysmë-ndalimi kanë të drejtë të dalin më shpesh jashtë burgut dhe në përgjithësi kryejnë punë me pagesë. Ata të gjithë mbaheshin në bllokun 6.

---

<sup>33</sup> Dyert e qelive mbylleshin shkurt tri herë në ditë (gjatë kohës së thirrjes së të burgosurve) dhe po ashtu gjatë natës.

61. Për një institucion siç është Dubrava, i cili duhet t'i strehojë të gjithë personat e dënuar të Kosovës<sup>34</sup>, përfshirë ata që vuajnë dënime shumë të gjata (deri në 40 vjet burgim), ofrimi i një programi të aktiviteteve i hartuar t'i vë të burgosurit në rrugën e ripërfshirjes dhe t'i përgatis ata për t'u kthyer në shoqëri, përfshirë edhe përmes aftësimit të duhur, është me rëndësi themelore. Fatkeqësisht, duhet të thuhet që shumë pak të burgosur<sup>35</sup> kanë përfituar nga regjimi i paraburgimit që do ta favorizonte ripërfshirjen e tyre. Për të gjithë të tjerët (shumicën dërmuese), dita karakterizohet nga periudha të ushtrimit jashtë, ndoshta edhe duke e shikuar televizionin pak.

KPT i mirëpret përpjekjet fillestare të ndërmarra nga menaxhmenti i burgut të Dubravës për ta organizuar aftësimin dhe aktivitetet që e meritojnë të quhen ashtu<sup>36</sup>. Sigurimi i një programi të kënaqshëm të aktiviteteve (punë, arsimim dhe sport) është me rëndësi themelore për mirëqenien e të burgosurve. Qëllimi është të sigurohet që të burgosurit janë në gjendje të kalojnë një pjesë të arsyeshme të ditës jashtë qelisë së tyre, duke u angazhuar në aktivitete të ndryshme që e kanë një qëllim. Për më tepër, për të gjithë të burgosurit e dënuar duhet të krijohen plane për trajtim individual. **Komisioni rekomandon që të ndërmerren hapa për t'i zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme aktivitetet dhe aftësimin që është në disponim të të burgosurve në burgun e Dubravës. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet krijimit të planeve për trajtim individual për të burgosurit dhe regjimit për ata të cilët vuajnë dënime të gjata.**

62. Një kërkesë tjetër për regjim të kënaqshëm të paraburgimit është shpërndarja dhe klasifikimi i përshtatshëm i të burgosurve sipas kriterëve të ndryshme, përfshirë statusin e tyre juridik dhe faktorët e sigurisë. Në këtë aspekt, delegacioni kishte mundësi të shihte që parimet përgjithësisht të pranuar, siç është ndarja e personave të paraburgosur dhe të burgosurve të dënuar, të kundërvajtësve që kryejnë veprën për herë të parë dhe të atyre që e përsërisin veprën, të burgosurve që vuajnë dënime të shkurta apo të gjata, të burgosurve të rinj dhe të vjetër, etj., nuk respektohej pothuajse aspak<sup>37</sup>. Është e qartë që puna për ndërtimin dhe renovimin e bllokut të paraburgimit që është kryer ndërmjet vitit 2000 dhe 2005 e ka komplikuar në masë të madhe punën e menaxhmentit. Sidoqoftë, **është koha e duhur që menaxhmenti të bëjë përpjekje të veprojnë më në përputhje me parimet për shpërndarjen dhe klasifikimin e të burgosurve të cilat i ka përkrahur vetë.**

63. Megjithatë, KPT është shqetësuar më së shumti për pohimet e përsëritura për nepotizëm në burgun e Dubravës. Gjatë vizitës në institucion, delegacioni është vërsuar me ankesa lidhur me ndikimin e pafavorshëm të favorizmit dhe korrupsionit të cilat, sipas pohimeve, shqetësonin institucionin. Një numër goxha i madh i të burgosurve pohonin që një klan familjar e kontrollonte burgun, dhe që për kalimin prej një regjimi të paraburgimit në tjetrin ose për ndërrimin e bllokut ose madje edhe për pranimin e caktuar të kujdesit të specializuar mjekësor paguhej një shumë e konsiderueshme e parave. Shqetësimet e para të delegacionit ishin kur u ballafaqua me këto pohime të forcuara nga mungesa e dukshme e kriterëve të qarta dhe transparente në bazë të të cilave bëhet transferimi ndërmjet regjimeve të paraburgimit/blloqeve, dhe kjo i jepte personelit hapësirë edhe më të madhe të lirisë së veprimit.

<sup>34</sup> Përveç femrave dhe të miturve, të cilët janë të burgosur në qendrën korrektuese në Lipjan.

<sup>35</sup> Sipas listave të ofruara nga menaxhmenti, vetëm katër të burgosur kanë përfituar nga aftësimi profesional në një punëtori më 2006 dhe asnjë në vitin 2007. Më 2006 janë organizuar disa kurse aftësimi për teknologji informative (TI) (47 kurse për programet softuerike word dhe excel) dhe disa aktivitete ishin paraparë të fillonin më 2007 (për 17 të burgosur).

<sup>36</sup> Me një letër të datës 26 qershor 2007, UNMIK-u e informoi KPT-në që "punëtoritë për aftësim profesional kanë filluar në javën që ka filluar me 14 maj 2007".

<sup>37</sup> Të burgosurit me të cilët foli delegacioni gjatë vizitës në bllokun 8 ishin duke vuajtur dënime që silleshin nga pesë ditë deri në 25 vjet dhe ata në bllokun 5 vuanin dënim nga një muaj deri në 25 vjet. Në bllokun e njëjtë ishte një i burgosur 71 vjeçar që e ndante qelinë me një të burgosur të moshës 23 vjeçare.

64. Duke e marrë parasysh seriozitetin e pohimeve të pranuar, delegacioni e ka ngritur këtë çështje me ministrin e drejtësisë në Prishtinë, i cili menjëherë i pranoi analizat e delegacionit dhe e shprehu gatishmërinë e tij për t'u marrë me problemin. KPT e mirëpret të kuptuarit, në nivel qeveritar, të problemeve të nepotizmit (dhe të korrupsionit) në burgun e Dubravës. Komisioni dëshiron të theksojë që një sistem i cili eksploatues ose në masë të madhe perceptohet si eksploatues i personave të privuar nga liria është i papranueshëm. Në mënyrë më specifike, të ushtruarit e të drejtave dhe përfitimi i privilegjeve nga ana e të burgosurve kurrë nuk duhet të varet nga paratë që ju jepen pjesëtarëve të personelit ose nga shërbimet e ndaluara të cilat ju bëhen atyre. Sjellja e tillë është e barasvlershme me keqpërdorimin e kompetencave dhe duhet të sanksionohet ashpër.

**KPT rekomandon që autoritetet t'i japin porosi të qartë personelit, atyre në pozita mbikëqyrëse dhe atyre në nivel më të ulët, që keqpërdorimi i pozitës duke pranuar shpërblim nga të burgosurit apo duke kërkuar shpërblim nga ata është i papranueshëm dhe që çdo akt i llojit të tillë do t'iu nënshtrohet sanksioneve të ashpra. Kjo porosi duhet të përsëritet rregullisht dhe në mënyrë të duhur.**

65. Siç u përmend tashmë, mungesa e kritereve të përcaktuara mirë, në bazë të të cilave bëhet organizimi i transferimit ndërmjet regjimeve/bloqeve të paraburgimit, e ka trasuar rrugën goxha shumë për praktika keqpërdoruese. **KPT rekomandon të bëhet hartimi i rregullave dhe kritereve të qarta dhe transparente, sidomos për regjimet e paraburgimit dhe për shpërndarjen e të burgosurve.** Për më tepër, të burgosurit duhet të informohen përmes kanaleve të përshtatshme lidhur me këto rregulla dhe kritere.

66. Përveç blloqeve "të zakonshme" të paraburgimit, në burgun e Dubravës gjendet edhe blloku i sigurisë së lartë (blloku 1). Ky bllok është shfrytëzuar ekskluzivisht për mbajtjen e të paraburgosurve dhe të burgosurve të dënuar<sup>38</sup> që ndiqeshin penalisht për krime lufte, akte të terrorizmit ose shkelje lidhur me krim të organizuar dhe që të gjithë, me përjashtim të njërit, ishin klasifikuar si niveli i sigurisë "A" (në lidhje me këtë shih paragrafët 69 deri 71).

Blloku 1 ishte si "burg brenda burgut", ku të burgosurit ishin plotësisht të shkëputur nga pjesa tjetër e kompleksit: aktivitetet, vizitat nga familja dhe kirurgjia mjekësore janë të organizuara në atë mënyrë që të sigurojnë që të burgosurit dalin nga kjo zonë e sigurt sa më pak që është e mundur<sup>39</sup>. Kështu, brenda bllokut të tyre të burgosurit i gëzonin kushtet e paraburgimit dhe një regjim (themelor, standard ose të përparuar) që ishte në mesin e më të mirëve në tërë institucionin (me përjashtim të dukshëm të politikës së "alternimit" sistematik "të qelisë", i cili zbatohet çdo dy javë, paragrafi 73).

67. Është e qartë që menaxhmenti bënte përpjekje për zbatimin e një regjimi të paraburgimit në bllokun 1 të frymëzuar nga parimet e krijuara nga KPT për njësitë e rrezikut të lartë<sup>40</sup>. Në veçanti, këto parime parashikojnë që të burgosurit të cilët paraqesin nivel të lartë të rrezikut sa i përket sigurisë duhet që, brenda kufijve të njërive të tyre të paraburgimit, të gëzojnë një regjim relativisht të lehtësuar si mënyrë e kompensimit për gjendjen e tyre të rëndë të arrestimit. Për më tepër, menaxhmenti po ashtu ishte në dijeni për konceptin e "sigurisë dinamike".

<sup>38</sup> Në kohën kur është kryer vizita, në bllokun 1 ishin të vendosur 29 të burgosur (në një kapacitet prej 53 vetave), vetëm një prej të cilëve ishte dënuar përfundimisht; të tjerët ishin duke u ankuar për dënimet e shqiptuara në shkallën e parë (18 të burgosur) ose mbaheshin të paraburgosur (10 të burgosur).

<sup>39</sup> Në kompleksin e burgut madje është vendosur një gjykatore e posaçme në mënyrë që të mos kenë nevojë t'i transferojnë këta të burgosur në qytet në kohën kur duhet të paraqiten në gjyq.

<sup>40</sup> Për më shumë hollësi, shih "Standardet e KPT-së" (CPT/Inf/E (2002) 1 - Rev. 2006, neni II, paragrafi 32).

68. Megjithatë, nevojitet përparim i mëtejshëm lidhur me aktivitetet të cilat janë të disponueshme për të burgosurit e bllokut 1. Ekzistimi i një programi të kënaqshëm të aktiviteteve është po aq i rëndësishëm – në mos jo edhe më i rëndësishmi – në njësitë e sigurisë së lartë se sa në njësinë e zakonshme. Ai mund të ndikojë shumë në kundërshtimin e efekteve të dëmshme në personalitetin e të burgosurit i cili jeton në atmosferën e mbyllur të njësisë së tillë. Aktivitetet të cilat ofrohen duhet të jenë sa më të llojllojshme që të jetë e mundur (arsim, sport, punë me vlerë profesionale, etj.). Sa ju përket, në veçanti, aktiviteteve të punës, është e qartë që arsyet lidhur me sigurinë mund t'i pengojnë shumë lloje të punës të cilat gjenden në mjedisin e zakonshëm të burgut. Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që të burgosurve t'ju ofrohen vetëm punë të mërzitshme. **KPT rekomandon të ndërmerren hapa për krijimin e një programi të aktiviteteve të frymëzuar nga parimet e sipërpërmendura.**

69. Delegacioni po ashtu ka pyetur lidhur me sistemin e klasifikimit të sigurisë që zbatohet në institucion, i cili e përcakton nëse të burgosurit duhet të pranohen në bllokun 1. Sa i përket KPT-së, nënkuptohet që të burgosurit nuk duhet t'i nënshtrohen një regjimi të posaçëm të sigurisë më gjatë se paraqitet e nevojshme në bazë të rrezikut që paraqesin dhe prandaj nevojitet që të bëhen rishikime të rregullta të vendimeve për vendosje. Rishikimet e tilla duhet gjithmonë të bazohen në vlerësimin e vazhdueshëm të të burgosurit individual nga ana e personelit të aftësuar në mënyrë të posaçme për kryerjen e vlerësimit të tillë. Për më tepër, sa më shumë që të jetë e mundur të burgosurit duhet të informohen vazhdimisht lidhur me arsyet për vendosjen e tyre dhe, nëse është e nevojshme, për vazhdimin e qëndrimit; në mes tjerash, kjo do t'ua mundësojë atyre t'i shfrytëzojnë në mënyrë efikase rrugët e ankesës kundër asaj mase.

70. Në përgjithësi, janë ofruar katër nivele të ndryshme të sigurisë së lartë për: "A-të jashtëm" (për të burgosurit me siguri të lartë kontaktet e të cilëve me botën e jashtme duhet të mbikëqyreshin); "A-të brendshëm" (për të burgosurit me siguri të lartë kontaktet e të cilëve brenda burgut duhet të mbikëqyreshin); "E-i lartë" (për të burgosurit që paraqesin rrezik të madh për arratisje); "E-normal" (për të burgosurit që paraqesin rrezik normal për arratisje). Në parim, të burgosurit e "kategorisë A" janë gjithmonë të ndarë nga të burgosurit e tjerë.

71. Vendimin për vendosjen e një të burgosuri në nivelin e sigurisë "A" e merr gjyqi dhe bazohet në mendimin e dhënë nga Komisioni për Mbikëqyrjen e të Burgosurve (KMB). Kriteri themelor që zbatohet ka të bëjë me natyrën e krimit të kryer (për të burgosurit e dënuar) ose gjoja të kryer (për të paraburgosurit), ndikimi në shoqëri dhe pasojat e arratisjes së mundshme. Kjo do të thotë që i burgosuri arrinë në burgun e Dubravës (ose në qendër të paraburgimit) me nivelin e sigurisë të përcaktuar më parë<sup>41</sup>.

Vetëm një vendim i mëvonshëm i KMB-së mund të ndikojë në riklasifikimin e vendimit. Megjithatë, procedurat e rishikimit nuk parashikojnë marrjen e informatave nga personeli i burgut. Kontrollimi i dosjeve individuale, të zgjedhura kuturu nga delagacioni, ka treguar që këto procedura të rishikimit ishin para së gjithash teorike. Delegacioni nuk ka mundur të identifikojë ndonjë rast që kishte rezultuar me ndryshimin e klasifikimit të nivelit të sigurisë.

---

<sup>41</sup> Për shembull, në dosjen e një të burgosuri shkruante: "Çdo individ që vuan dënimin prej 20 apo më shumë viteve duhet të konsiderohet si i burgosur i rrezikshmërisë së lartë dhe të klasifikohet në nivelin "A", në bazë të gjatësisë së dënimit dhe të moshës të tyre. Në këtë rast, i burgosuri është 24 vjeç". Deklarata të ngjashme gjendeshin në një numër të dosjeve të tjera. Disa të burgosur ishin klasifikuar në "A" me të arritur në institucion më 2001 dhe statusi i tyre nuk ishte rishikuar prej atëherë.

Është e qartë që sistemi i klasifikimit të nivelit të sigurisë që zbatohet në Kosovë duhet të rishikohet dhe të vendoset në linjë me kriteret e caktuara në paragrafin 69 dhe në parimet e formuluar në Rregullat Evropiane për Burgje (në mënyrë specifike rregullat 51 deri 53). Në veçanti, ky sistem duhet t'i përfshijë konceptet e individualizimit të masës, përpjestimin, rishikimin e rregullt (në veçanti por jo ekskluzivisht) në bazë të mendimeve të personelit të burgut, dhe mundësinë që të burgosurit në fjalë të ankohen kundër klasifikimit. **KPT rekomandon që të bëhet rishikimi i sistemit të klasifikimit në Kosovë në frymën e vërejtjeve të mësipërme.**

72. Niveli i sigurisë lidhur me rrezikun nga arratisja ("E") ishte përcaktuar nga administrata e burgut<sup>42</sup> dhe ishte bazuar kryesisht në ndonjë përpjekje të mëparshme për arratisje, si edhe në mbajtjen ose jo të lidhjeve nga ana e të burgosurit në fjalë me rrethin e tij kriminal (sidomos kur ishte në pyetje krimi i organizuar). Sipas rregulloreve në fuqi, klasifikimi në nivelin "E" duhet të rishikohet çdo 28 ditë; megjithatë, duket që rishikimi i tillë nuk është kryer në praktikë. Për më tepër, si edhe në rastin e sistemit të përmendur më herët, duket që të burgosurit nuk e kishin në dispozicion asnjë rrugë të ankesës për kundërshtimin e vendimeve të tilla. **KPT dëshiron të marrë nga UNMIK-u komente lidhur me këto dy çështjet e fundit.**

73. KPT duhet ta shprehë shqetësimin lidhur me politikën e "alternimit" sistematik "të qelisë", e cila zbatohet çdo dy javë, në bllokun 1 (ku janë të vendosur pothuajse të gjithë të burgosurit e "kategorisë A"). Kjo ishte ankesa e vetme e vërtetë e këtyre të burgosurve, të cilët përndryshe e kishin pranuar situatën në të cilën gjendeshin. Një masë e tillë ka mundësi të ndikojë në gjendjen mendore të të burgosurve në fjalë në një afat të gjatë. Siç i tha delegacionit njëri nga të burgosurit: "Është e mërzitshme ta ndërrosh qelinë pa pushim, përfundoj duke mos e ditur më kush jam apo nga po shkoj ...".

Në letrën e datës 26 qershor 2007, UNMIK-u ka treguar që "praktika e ndërrimit të qelisë çdo 14 ditë vlen vetëm për të burgosurit dhe të paraburgosurit e "kategorisë A", si masë e sigurisë për të burgosurit/të paraburgosurit me siguri maksimale. Duke e marrë parasysh rrezikun jashtëzakonisht të madh të një numri relativisht të vogël të të burgosurve/të paraburgosurve, Departamenti i Drejtësisë /DMB ngurron ta ndryshojë këtë praktikë".

Sipas mendimit të KPT-së, sqarimet e dhëna nga UNMIK-u janë larg nga të qenit bindëse. Komisioni e pranon që në rrethana të caktuara (për shembull kur brenda ose jashtë burgut merren informata të besueshme për arratisje të mundshme), mund të jetë e nevojshme të ndërmerret hapi i zhvendosjes së të burgosurit, pa e bërë ndonjë paralajmërim paraprak, nga qelia aktuale ose madje edhe nga institucioni. Megjithatë, masat e tilla duhet të jenë përjashtim e jo të bëhen rregull; çdo vendim në këtë aspekt duhet, në mes tjerash, t'i respektojë parimet e sipërpërmendura të përpjesëtimit.

**KPT rekomandon që autoritetet ta ndërprejnë praktikën e "alternimit" sistematik "të qelisë" ashtu siç bëhet në burgun e Dubravës, në frymën e vërejtjeve pararendëse.**

<sup>42</sup> Lidhur me të burgosurit në bllokun 1, klasifikimi lidhur me rrezikun nga arratisja ishte ende detyrë e zyrtarëve ndërkombëtarë të UNMIK-ut. Sa për informim, më 14 mars 2007: 32 të burgosur ishin klasifikuar si "A-i brendshëm" (të gjithë në bllokun 1); tetë të burgosur ishin klasifikuar si "A-i jashtëm" (një në bllokun 1, tre në bllokun 2, një në bllokun 3, një në bllokun 4, dhe dy në bllokun 6); 19 të burgosur ishin klasifikuar si "E-i lartë" (18 prej të cilëve ishin klasifikuar tashmë si "A") dhe një i burgosur (në bllokun 5) ishte klasifikuar si "E-normal".

74. Në fund, KPT dëshiron ta ngrisë çështjen e rolit të një duzine apo më shumë oficerëve ndërkombëtarë të policisë të caktuar në bllokun 1. Komisioni shpreh mosbesim, si çështje e parimit, lidhur me praninë e oficerëve të policisë brenda institucionit të burgut, dhe aq më tepër kur ata janë në kontakt të drejtpërdrejtë me të burgosurit (duket që nuk ishte kështu gjatë vizitës së zhvilluar në bllokun 1). Kështu, shpërndarja e oficerëve ndërkombëtarë të policisë, e cila ka filluar në maj, duhet të ishte vetëm masë e përkohshme. Ndërsa ka argumente konkrete për ruajtjen e pranisë së personelit ndërkombëtarë në bllokun 1, vetëm personeli me përvojë të bazuar të punës në burgje duhet të pozicionohen aty<sup>43</sup>. Kjo po ashtu do të ndihmojë në sigurimin e aftësisë të vazhdueshëm për stafin vendor të cilët duhet të merren me të burgosurit që paraqesin rrezik të lartë për sigurinë. **KPT dëshiron t'i pranojë komentet e UNMIK-ut lidhur me këtë çështje.**

b. Qendra Korrektuese në Lipjan

75. Në *sektorin e femrave*, të gjitha të burgosurat e dënuara ishin në regjimin standard. Ato mund të lëviznin lirshëm jashtë qelive të tyre gjatë ditës dhe pjesa më e madhe e tyre merreshin me aktivitete të ndryshme (siç është gatimi, pastrimi, qepja ose merreshin me bujqësi). Për çdo ditë mund të qëndronin dy orë në kopshtin e rregulluar këndshëm. Dy herë në javë ato mund ta shfrytëzonin sallën e ushtrimeve nga një orë.

Gjendja e femrave të paraburgosura ishte shumë më e pafavorshme. Aktivitetet jashtë qelisë ishin të kufizuara në ushtrime jashtë dy herë në ditë nga një orë dhe në qasjen në aneksin e kuzhinës në një dhomë shumë të vogël të përbashkët. Pjesën tjetër të kohës ato ishin të mbyllura në qelitë e tyre dhe puna e vetme e tyre ishte të shikonin televizion, të luanin lojëra ose të lexonin. Thuajse asnjërës prej tyre nuk i ishte ofruar punë ose ndonjë aktivitet tjetër i qëllimshëm. Në lidhje me këtë, **rekomandimi i bërë në paragrafin 61 vlen njësoj edhe për të paraburgosurat në qendrën korrektuese në Lipjan.**

76. Në Lipjan qartë bëheshin përpjekje për t'ju siguruar arsimim shkollor dhe aktivitete sportive të *burgosurve të mitur* (sallë për ushtrime, volejball, basketboll). Të miturit po ashtu kishin regjim standard (gjatë kohës së kryerjes së vizitës ishin nëntë të mitur), ju jepeshin gjithsej tri orë të ushtrimeve jashtë për çdo ditë. Të burgosurit që ishin në regjim të përparuar (gjatë kohës së kryerjes së vizitës ishin nëntë të tillë), mund të dilnin në ajër të pastër katër orë në ditë dhe atyre ju ofroheshin aktivitete sportive shtesë.

Gjithsej pesë mësimdhënës (tre të punësuar nga Mistria e Arsimit dhe dy të kontraktuar) ofronin arsim themelor çdo mëngjes nga tri orë, prej të hënës deri të premten (gjuhë shqipe dhe angleze, matematikë, aftësim për kompjuter, gjeografi, histori dhe art). Përveç kësaj, pasditeve kishte orë të edukatës fizike.

Kështu, është për t'u shqetësuar që pjesa më e madhe e personelit që merreshin me të mitur nuk kishin kryer ndonjë aftësim të specializuar për këtë qëllim. Sipas drejtorit ekzistonin plane për përmirësimin e situatës. **KPT dëshiron të informohet lidhur me hapat konkret që janë marrë deri tani në këtë aspekt.**

---

<sup>43</sup> Sipas informatave të cilat ishin në dispozicion të delegacionit, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara dhe Italia kishin marrë kërkesë për personel të përshtatshëm shtesë të burgjeve, por si duket pa ndonjë sukses.

c. Qendrat e paraburgimit të cilat janë vizituar

77. Siç janë në dijeni edhe vetë autoritetet, kushtet aktuale në qendrat e paraburgimit të cilat janë vizituar nuk janë të përshtatshme për paraburgim afatgjatë dhe, aq më pak për të burgosurit që vuajnë dënime të gjata, meqë qendrat nuk kanë ndonjë objekt të përshtatshëm (p.sh. dhoma të përbashkëta) për ta organizuar një regjim për të qenë. Kështu, menaxhmenti në disa qendra të paraburgimit të cilat i vizituam (sidomos në Gjilan dhe në Mitrovicë) bënte përpjekje të prekshme për të siguruar punë dhe aktivitete për të burgosurit.

78. Sa ju përket të *burgosurve të dënuar*, gjendja ndryshonte nga një qendër e paraburgimit në tjetrën. Situata ishte më e favorshme në Prishtinë ku të gjashtë të dënuarve që ishin aty gjatë kohës së vizitës ju ishte ofruar punë (në kuzhinë, mirëmbajtje). Në Gjilan, tetë nga 24 të dënuarit kishin mundësi të punon (të pastronin, në kuzhinë, të lanin dhe hekurosnin rroba, në bibliotekë, të shkurtonin flokë), ndërsa në Mitrovicë, dymbëdhjetë të burgosur i ndanin pesë vende të punës (pastrimin, në kuzhinë, mirëmbajtjen)<sup>44</sup>. Për fat të keq në Pejë thuajse asnjë punë nuk ju ofrohej të burgosurve.

KPT është në veçanti i shqetësuar lidhur me situatën e pasigurt të disa të dënuarve në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë, që vuanin dënime deri në 20 vjet<sup>45</sup>, të cilëve nuk ju ofrohej asnjë aktivitet i qëllimshëm. Një regjim i tillë i varfër është qartë i dëmshëm për shëndetin mendor të të burgosurve në fjalë. Sipas drejtorit të qendrës, disa të burgosur vuanin nga probleme psikologjike. **Është çështje prioritare që për të burgosurit që vuajnë dënime të gjata në Mitrovicë të gjendet një zgjidhje e zbatueshme alternative.**

79. Në të gjitha qendrat e paraburgimit të cilat i kemi vizituar, shumica dërrmuese e të *paraburgosurve*, nëse jo të gjithë ata, i nënshtroheshin një regjimi shumë të varfër. Aktivitetet jashtë qelisë zakonisht ishin të kufizuara në ushtrimet jashtë dy herë në ditë nga një orë (me disa aktivitete sportive). Pjesën tjetër të kohës, të paraburgosurit ishin të mbyllur në qelitë e tyre, në një gjendje të papunësisë së imponuar. Burimi i tyre i vetëm që ua tërhiqte vëmendjen ishte të lexuarit, luajtja e lojërave ose të shikuarit e televizionit. Gjendja dukej të ishte sidomos e pasigurt në Pejë dhe në Prishtinë, ku të burgosurve nuk ju ofrohej asnjë aktivitet sportiv dhe nuk ju sigurohej materiali për lexim. Për më tepër, në Pejë shumë qeli nuk ishin të pajisura me aparat televiziv.

80. Si u përmend tashmë në paragrafin 61, qëllimi duhet të jetë që të sigurohet që të gjithë të burgosurit, pavarësisht a janë të dënuar apo të paraburgosur, ta kalojnë një kohë të arsyeshme të ditës jashtë qelive të tyre të angazhuar në aktivitete të qëllimshme të natyrës së ndryshme. Në lidhje me këtë, **rekomandimi i bërë në paragrafin 61 vlen njësoj për të gjitha qendrat e paraburgimit të cilat janë vizituar dhe, nëse është e përshtatshme, edhe për qendrat e tjera të paraburgimit në Kosovë.**

Për më tepër, **KPT rekomandon, si hap të parë, që autoritetet ta hulumtojnë mundësinë që në qendrat e vizituara të paraburgimit të mbahen të hapura dyert e qelisë gjatë një pjese të ditës.**

<sup>44</sup> Në Mitrovicë planifikohej që së shpejti të fillojë një kurs i rrobaqepësisë.

<sup>45</sup> Në mënyrë që t'ua mundësonin të burgosurve në fjalë vendosjen në afërsi të familjeve të tyre (dhe për shkak të sigurisë së tyre), ata nuk mbaheshin në burgun e Dubravës.

81. Në disa prej qendrave të paraburgimit të cilat janë vizituar, kishte të burgosur të cilët ishin klasifikuar si të burgosur të kategorisë “A” ose “E” dhe në këtë mënyrë i nënshtroheshin në mënyrë sistematike një sistemi të “alternimit të qelisë”. Në lidhje me këtë, **vërejtjet dhe rekomandimet e bëra në paragrafët 69 deri në 73 duhet të zbatohen njëjloj në qendrat e paraburgimit në Kosovë.**

## 5. Kujdesi shëndetësor

### a. Personeli dhe objektet

82. Në *burgun e Dubravës* (përfshirë njësinë e spitalit të burgut), personeli që merrej me kujdes shëndetësor përbëhej prej gjithsej tetë mjekëve<sup>46</sup> dhe rreth 30 infermiereve. Numri aq i madh i personelit e mundësonte mbulimin e nevojave të institucionit në të cilin ishin të vendosur deri 1,100 të burgosur (dhe, në mesin e gjërave të tjera, ofrimin e kujdesit mjekësor dhe të infermierisë në institucion njëzet e katër orë, edhe ditën edhe natën, si edhe gjatë fundjavave).

Megjithatë, posti i dentistit ishte i lirë qe sa kohë, ndërsa këshillimet dentare më parë ishin të organizuara dy herë në javë.

Në një letër të datës 26 qershor 2007, UNMIK-u konfirmoi që rishtazi ishte punësuar dentisti me orar të plotë. KPT e mirëpret këtë zhvillim.

83. Në *qendrën korrektuese në Lipjan*<sup>47</sup> niveli i personelit përgjegjës për kujdes shëndetësor dukej të ishte në përgjithësi i kënaqshëm, ashtu si edhe në qendrat e tjera të paraburgimit të cilat janë vizituar<sup>48</sup>. Në të gjitha këto institucione personeli i infermierisë ishte i pranishëm njëzet e katër orë.

84. Në të gjitha institucionet ndëshkimore objektet për kujdes shëndetësor në përgjithësi ishin të pranueshme dhe në njësinë e spitalit të burgut në burgun e Dubravës ishin të standardit të mirë. Kështu, është shqetësuese që në qendrat e paraburgimit në Mitrovicë dhe në Pejë mungonte karrigia e dentistit dhe pajisjet e tjera. Për pasojë, dentisti në Mitrovicë nuk mund të ofronte kujdes të duhur për dhëmbët, me përjashtim të nxjerrjes së dhëmbëve (shih po ashtu paragrafin 89). **KPT rekomandon marrjen e menjëhershëm të hapave për përmirësimin e kësaj mungese.**

<sup>46</sup> Ishin gjashtë mjekë të vendit dhe dy mjekë të caktuar nga UNMIK-u (një internist dhe një psikiatër). Të gjithë ata punonin me orar të plotë në institucion (përveç psikiatrit).

<sup>47</sup> Ishin dy mjekë të përgjithshëm (që punon me orar jo të plotë), një psikiatër (i cili ishte i pranishëm dy herë në javë nga dy ose tri orë), një dentist (i pranishëm tri herë në javë nga gjysmë dite) dhe dhjetë infermiere. Përveç kësaj, një psikolog ishte i punësuar tri ditë në javë.

<sup>48</sup> Në qendrën e paraburgimit në Gjilan, në ekipin për kujdes shëndetësor bënin pjesë dy mjekë (një i përgjithshëm dhe një psikiatër) dhe gjashtë infermiere. Në qendrat e paraburgimit në Mitrovicë dhe në Pejë ishin të punësuar nga tre mjekë (mjek i përgjithshëm, psikiatër, dentist) dhe gjashtë infermiere. Në qendrën e paraburgimit në Prishtinë ishte një mjek i përgjithshëm (i cili punonte me orar jo të plotë) dhe gjashtë infermiere.

b. Trajtimi dhe mundësia e shfrytëzimit të kujdesit shëndetësor

85. Në *burgun e Dubravës*, kujdesi trupor ishte organizuar në bazë të vizitave alternuese në blloqet e ndryshme (dy vizita në javë për bllok) përveç, me sa duket, për rastet urgjente, të cilat, në parim, trajtoheshin sa më shpejt që ishte e mundur. Shfrytëzohej një formular i kërkesës për kontroll mjekësor, i cili plotësohej nga të burgosurit. Formularët pastaj i dorëzoheshin personelit të burgut, të cilët ua jepnin ata shefave të blloqeve; pastaj ata shënoheshin në regjistër dhe ju përcilleshin zëvendës drejtorëve, të cilët ishin përgjegjës për blloqet, dhe këta vendosnin a ta çonin kërkesën deri në fund apo jo.

Shkurt, ishte një procedurë administrative e pavolitshme, e cila shkaktonte vonesa për të cilat ankoheshin shumë të burgosur, dhe lidhur me të cilat vendimet që duhet të merreshin vetëm nga personeli mjekësor i merrte personeli i pakualifikuar (siç ishin vendimet për "filtrimin" e kërkesave të cilat dërgoheshin në shërbimin për kujdes shëndetësor, të cilat i kishte vërejtur delegacioni drejtpërdrejt).

**KPT rekomandon të ndërmerren hapa në burgun e Dubravës në mënyrë që të sigurohet që çdo kërkesë për këshillime mjekësore që bëhet nga i burgosuri të përcillet pa vonesa të panevojshme në shërbimin për kujdes shëndetësor dhe që këshillimet të organizohen në të gjitha blloqet gjatë ditëve të punës (dhe jo vetëm dy herë në javë). Për më tepër, Komisioni dëshiron të sjellë ndër mend që nga personeli jomjekësor nuk duhet të kërkohej ta bëjnë shoshitjen e kërkesave për këshillime mjekësore.**

86. Në Dubravë, kujdesi i specializuar ofrohej nga mjekë të ndryshëm specialistë, të cilët zakonisht ishin të pranishëm në institucion një ose dy herë në muaj. Hospitalizimet në përgjithësi bëheshin në spitalet në Prishtinë ose në Pejë. Në shikim të parë, hospitalizimet e këtij lloji duket që nuk shkaktonin probleme të posaçme. Megjithatë, delegacioni kuptoi që, në disa raste, kishte vonesa të konsiderueshme (shpesh me muaj), sidomos për operacione. **KPT dëshiron të marrë komente nga UNMIK –u lidhur me këtë çështje.**

87. Si u përmend tashmë, kujdesi psikiatrik ofrohej në njësinë psikiatrike (15 shtretër) në Dubravë nga një psikiatër që punonte me orar jo të plotë, i cili ndihmohej nga dy infermiere për psikiatri, një terapeut për mjekim nëpërmjet ushtrimeve fizike në punë, dhe një psikolog i cili punonte një herë në javë. Mesatarisht, në institucion për çdo muaj mbaheshin rreth pesëmbëdhjetë këshillime psikiatrike.

KPT e mirëpret faktin që në proces e sipër ishte punësimi i një psikologu për punë me orar të plotë. Megjithatë, duke e marrë parasysh përhapjen e çrregullimeve mendore në burg dhe problemet lidhur me varësinë nga droga, prania e një psikiatri me orar jo të plotë pune duket që është e pamjaftueshme. **Komisioni rekomandon që prania e psikiatrit në burgun e Dubravës të rritet në një post me orar të plotë pune.**

88. Delegacioni fitoi përshtypje të favorshme lidhur me kujdesin shëndetësor të ofruar në *qendrën korrektuese në Lipjan*; nuk ka nevojë për kurrfarë komenti të posaçëm lidhur me këtë temë.

89. Në përgjithësi, kujdesi shëndetësor i ofruar në *qendrat e paraburgimit të cilat janë vizituar* ishte i përshtatshëm.

Mirëpo, ofrimi i kujdesit dentar ishte problem serioz në secilën prej qendrave të paraburgimit të cilat u vizituan; deri më tani të gjitha përpjekjet e menaxhmentit të institucioneve për të punësuar dentistë kishin dështuar<sup>49</sup>. Për pasojë, të burgosurit shpesh duhet të prisnin me javë ose muaj të tërë për t'u vizituar te dentisti. Me sa duket, autoritetet në nivelin më të lartë janë në dijeni lidhur me këtë problem dhe po bëjnë përpjekje të konsiderueshme ta gjejnë një zgjidhje.

**KPT rekomandon që autoritetet përkatëse t'i dyfishojnë përpjekjet e tyre për të siguruar që, në të gjitha qendrat e paraburgimit të vizituara, të burgosurit të mund të pranojnë kujdes adekuat dentar.**

90. Më tej, qasja në kujdesin psikiatrik duket të jetë problematike në disa prej institucioneve të vizituar. Në Prishtinë, një numër i të burgosurve u ankuan për vonesat e gjata për kryerjen e këshillimeve psikiatrike.

Gjendja dukej të ishte posaçërisht problematike në Mitrovicë. Në parim, të burgosurit mund të transferoheshin për trajtim dhe të shtriheshin në klinikën e psikiatrisë në Prishtinë, por të burgosurit etnik serb zakonisht refuzonin të trajtoheshin në Prishtinë (po ashtu nga frika e ndonjë dhune ndërmjet pacientëve). Për pasojë, të burgosurit në fjalë transferoheshin në spitalin rajonal në Mitrovicën veriore. Megjithatë, sipas menaxhmentit të qendrës, ishte bërë shumë e vështirë që të burgosurit që kishin nevojë të shtriheshin në spital për kujdes psikiatrik të transferoheshin në atë spital, për shkak të mosmarrëveshjeve për pagesën e llogarive të spitalit nga Shërbimi Korrektues i Kosovës. **KPT dëshiron t'i marrë komentet e UNMIK-ut lidhur me këtë çështje.**

c. Ekzaminimi mjekësor dhe regjistrimi i lëndimeve

91. Lidhur me ekzaminimin mjekësor, KPT e mirëpret faktin që, në të gjitha institucionet e vizituara, të burgosurit e sapo ardhur kontrolloheshin gjithmonë nga një infermiere dhe një mjek brenda 24 orëve prej pranimit të tyre (përfshirë fundjavat).

Megjithatë, në shumicën e institucioneve të vizituara u vunë re disa mangësi. Së pari, kontrollimi i dosjeve mjekësore nga ana e delegacionit nxori në shesh që përshkrimet e lëndimeve të zbuluara (gjatë pranimit ose pas incidenteve të dhunshme brenda burgut) nuk ishin regjistruar gjithmonë<sup>50</sup> ose nuk ishin regjistruar në hollësi, dhe nuk jepej kurrfarë informate shtesë. Së dyti, në disa raste, kontrollimi mjekësor me rastin e pranimit ishte sipërfaqësor (p.sh. vetëm kontrollimi i pulsit dhe i shtypjes së gjakut). Së treti, të burgosurit e ardhur rishtazi nuk ekzaminoheshin në mënyrë sistematike për sëmundje ngjitëse në asnjërin prej institucioneve të vizituara. Duke i marrë parasysh karakteristikat e popullsisë të të burgosurve (p.sh. mungesën e qasjes në shërbime shëndetësore në bashkësi, praktikat që paraqesin rrezik nga sëmundjet ngjitëse, etj.), mungesa e ekzaminimit të tillë është posaçërisht shqetësuese.

<sup>49</sup> Në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë, ishte një dentist që punonte me orar jo të plotë, por në qendër mungonin pajisjet themelore për intervenime dentare.

<sup>50</sup> Si u përmend tashmë në shënimin në fund të faqes numër 3, delegacioni zbuloi që në qendrën e paraburgimit në Prishtinë nuk ishte regjistruar asnjë lëndim në dosjen mjekësore të të paraburgosurit kur është pranuar ai, ndërsa fotografia e bërë kur është pranuar personi gjendej në dosjen administrative dhe në të shiheshin qartë të mavijosurat rreth syrit.

92. KPT konsideron që në dosjen e krijuar pas kontrollimit të të burgosurit të ardhur rishtazi – pavarësisht a hyn ai në sistemin e burgut apo është aty transit– duhet të gjenden si vijon:

- i) një përmbledhje e plotë e deklaratave të personit në fjalë të cilat janë relevante për kontrollin mjekësor (përfshirë përshkrimin e gjendjes së tij shëndetësore dhe cilindo pohim për keqtrajtim);
- ii) një përmbledhje të plotë të rezultateve objektive mjekësore bazuar në ekzaminimin e plotë;
- iii) konkluzionet e mjekut në bazë të i) dhe ii).

Në konkluzionet e tij, mjeku duhet ta tregojë shkallën e përputhshmërisë ndërmjet ndonjë pohimi të bërë dhe rezultateve objektive mjekësore; kjo do t'ua mundësojë autoriteteve përkatëse dhe, në veçanti prokurorëve, t'i vlerësojnë si duhet informatat e shënuara në regjistër. Në bazë të kërkesës, konkluzionet e mjekut duhet t'i vihen në dispozicion të burgosurit dhe avokatit të tij.

Qasja e njëjtë duhet të përdoret edhe në rastet kur të burgosurit i bëhet kontroll mjekësor pas ndonjë ngjarjeje të dhunshme në burg. Përveç kësaj, nëse i burgosuri e kërkon këtë, mjeku duhet t'ia jap atij një vërtetim në të cilin përshkruhen lëndimet e vërejtura.

**KPT rekomandon të ndërmerren hapa në të gjitha institucionet ndëshkimore në Kosovë për të siguruar që rregullat e sipërpërmendura të zbatohen plotësisht në praktikë.**

Më tej, **Komisioni rekomandon të bëhet rishikimi i procedurave ekzistuese në mënyrë që të sigurohet që, kurdo që lëndimet regjistrohen nga mjeku dhe janë në pajtueshmëri me pohimet për keqtrajtim të bëra nga i burgosuri, prokurori përkatës të informohet në mënyrë sistematike lidhur me regjistrin.**

Në fund, **duhet të ndërmerren hapa për të siguruar që të burgosurit e ardhur rishtazi të ekzaminohen për sëmundjet ngjitëse.**

93. Delegacioni vuri re që në asnjërin prej institucioneve ndëshkimore të vizituara nuk mbahej regjistri specifik për regjistrimin e lëndimeve të cilat vëreheshin tek të burgosurit gjatë pranimit të tyre ose të cilat ata i kishin pësuar në burg (vetë gjymtimi, dhuna ndërmjet të burgosurve ose ndonjë shkak tjetër). Sipas mendimit të KPT-së, **do të ishte e dëshirueshme që një regjistër i tillë të mbahej në të gjitha institucionet ndëshkimore**. Një regjistër i këtij lloji, në mes tjerash, do t'ia mundësonte institucionit mbikëqyrjen e nivelit të dhunës brenda institucionit.

94. Është çështje posaçërisht shqetësuese që, me përjashtim të dukshëm të qendrës korrektuese në Lipjan, në të gjitha institucionet e vizituara ndëshkimore ekzaminimet mjekësore kryheshin në mënyrë sistematike në prani të oficerëve të burgut.

Sipas mendimit të KPT-së, nuk mund të ketë arsytim për praninë sistematike të personelit të burgut gjatë ekzaminimeve të tilla; prania e tyre është e dëmshme për vendosjen e raportit të duhur mjek-pacient dhe zakonisht është e panevojshme nga këndvështrimi i sigurisë. Munden dhe duhet të gjenden zgjidhje alternative për koordinimin e nevojave legjitime të sigurisë me parimin e konfidencialitetit mjekësor. Një mundësi mund të jetë instalimi i një sistemi të thirrjes, kur mjeku do të ishte në gjendje t'i alarmojë shpejtë oficerët e burgut në ato raste të jashtëzakonshme kur i burgosuri shqetësohet ose bëhet kërcënues gjatë ekzaminimit mjekësor.

95. Përmes letrës së datës 26 qershor 2007, UNMIK-u informoi KPT-në se “u janë dhënë udhëzime të qarta me shkrim të gjithë drejtorëve të burgjeve dhe të qendrave të paraburgimit, ku thuhet se të gjitha kontrollet mjekësore duhet të kryhen në praninë e zyrtarit të burgut, por pa mundësinë e dëgjimit nga ai. Përjashtimet mund të bëhen vetëm me kërkesë të mjekut për arsye të sigurisë personale”.

Përderisa i miraton hapat e ndërmarrë nga UNMIK-u, KPT-ja mendon se duhet të jetë si rregull që kontrollet mjekësore të të burgosurve (qoftë menjëherë pas ardhjes së tyre apo më vonë) duhet po ashtu të bëhen pa praninë e zyrtarëve të burgut, përveç nëse mjeku në fjalë kërkon ndryshe në ndonjë rast të caktuar. **KPT-ja rekomandon që drejtoria e burgut të Dubravës dhe drejtoritë e të gjitha qendrave të paraburgimit në Kosovë të udhëzohen në mënyrë të duhur.**

96. Në të gjitha qendrat korrektuese të vizituara, delegacioni ka vënë re se të burgosurit nuk informoheshin në mënyrë sistematike nga punonjësit shëndetësorë për sëmundjet ngjitëse, siç janë tuberkulozi, AIDS-i (SIDA) dhe hepatiti. Do të ishte e udhës që punonjësit shëndetësorë t’ua japin këto informata të burgosurve me shkrim (p.sh. përmes broshurave) në gjuhën që ata e kuptojnë.

## 6. Çështjet e tjera

### a. Disiplina

97. Korniza juridike për çështjet disiplinore është përcaktuar përmes nenit 118 dhe 119 të Ligjit për ekzekutimin e dënimeve<sup>51</sup> dhe nenit 295 e 296 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale - KPPP, si dhe përmes nenit 5.1 të “Procedurave Standarde të Punës (PSP, të nxjerra nga komisionari i Shërbimit Korrektues të Kosovës – SHkK në mars të vitit 2006)

Të burgosurit e dënuar dhe ata të mbajtur në paraburgim mund t’i nënshtrohen sanksioneve vijuese disiplinore: qortimi, heqja e privilegjit të dhënë (deri në 15 ditë) dhe urdhri për kthimin e një shume parash (shuma maksimale është 25 euro, duke marrë gjithashtu parasysh gjendjen financiare të të burgosurit në fjalë) dhe burgosja në vetmi (vetëm për të burgosurit e rritur<sup>52</sup>, me një kohëzgjatje jo më shumë se 15 ditë, dhe në raste të shkeljeve të shumëfishta – 30 ditë<sup>53</sup>). Lidhur me të paraburgosurit (duke përfshirë të miturit), vizitat dhe letërkëmbimet po ashtu mund të ndalohen apo të kufizohen për arsye disiplinore përmes një urdhri të gjykatës<sup>54</sup> (ligji nuk përcakton ndonjë afat kohor për këtë qëllim).

Delegacioni nuk ka parë shenja të zbatimit të tepërt të sanksioneve disiplinore (duke përfshirë izolimin në vetmi) në asnjërin nga burgjet a qendrat e paraburgimit të vizituara. Për më tepër, kontaktet e të burgosurve me jashtë kanë qenë shumë rrallë të kufizuara për arsye disiplinore. Ky është një zhvillim i mirëpritur.

<sup>51</sup> I shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/46.

<sup>52</sup> Shih nenin 135, paragrafi 2 të Kodit penal për të mitur.

<sup>53</sup> I burgosuri nuk mund t’i kalojë i burgosur në vetmi më shumë se dy muaj në vit.

<sup>54</sup> Vizitat nga avokati, mjekët, Avokati i Popullit dhe nga përfaqësuesit e misionëve diplomatike apo letërkëmbimi me ta nuk janë të përfshira në këto kufizime.

Megjithëkëtë, KPT-ja dëshiron të thekson se kontaktet me familjen asnjëherë nuk duhen të ndalohen plotësisht si formë e dënimit<sup>55</sup>. Po kështu, kufizimet e kontakteve me jashtë duhet të shqiptohen vetëm për një periudhë kohore më të shkurtë të mundshme, dhe duhet që të jetë si rregull që ato të mos vlejnjë për të burgosurit e mitur. **Komisioni rekomandon që këto praktika të zbatohen në të gjitha qendrat korrektuese të Kosovës.**

98. Sa u përket procedurave disiplinore, dispozitat ligjore të lartpërmendura përmbajnë masa mbrojtëse që avancohen nga KPT-ja, siç janë të drejtat e të burgosurve të dëgjohen personalisht (nga këshilli disiplinor, që udhëhiqet nga drejtori), t'i thërrasin dëshmitarët e vet dhe t'i parashtrojnë pyetjet rreth dëshmive kundër tyre, të marrin kopjen e vendimit disiplinor, si dhe të parashtrojnë ankesë kundër vendimit të tillë (komisionarit të ShKK-së në rastin e të burgosurve të dënuar apo gjykatës në rastin e të paraburgosurve).

Të burgosurve u jepet e drejta e parashtrimit të ankesës kundër vendimit disiplinor vetëm nëse dënohen me burgosje në vetmi<sup>56</sup> apo, në rastin e të paraburgosurve, përmes ndalimit apo kufizimit të vizitave ose të letërkëmbimit<sup>57</sup>. Kjo gjendje është shumë e pakënaqshme dhe gjithashtu paraqet dallim nga Rregullat e ndryshuara të burgjeve evropiane<sup>58</sup>. **KPT-ja rekomandon ndërmarrjen e hapave për t'u siguruar që të gjithë të burgosurve që i nënshtrohen dënimit disiplinor t'u jepet e drejta zyrtare për parashtrimin e ankesës.**

99. Pas shqyrtimit të regjistrave dhe dosjeve disiplinore dhe pas konsultimeve me punonjësit doli përfundimi se në të gjitha qendrat korrektuese të vizituara, procedurat disiplinore zakonisht janë zbatuar në përputhje me kushtet e lartpërmendura ligjore.

Sidoqoftë, janë identifikuar një numër mangësish në disa prej burgjeve a qendrave të paraburgimit të vizituara. Për shembull, në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, të burgosurit nuk janë dëgjuar gjithmonë nga këshilli disiplinor para se të merrej vendimi për çështjen në fjalë nga ana e drejtorit. Për më tepër, në shumicën e burgjeve dhe qendrave të paraburgimit të vizituara, nuk është dhënë arsyetimi për vendimet disiplinore.

**KPT-ja rekomandon ndërmarrjen e hapave në të gjitha burgjet dhe qendrat e paraburgimit të vizituara për të siguruar që të gjithë të burgosurit:**

- **Të dëgjohen në procedura disiplinore;**
- **Të marrin kopje të vendimit disiplinor, që i informon ata për arsyet e vendimit dhe për mundësitë e parashtrimit të ankesës. Të burgosurit në fjalë duhet të vërtetojnë me shkrim se kanë marrë kopjen e vendimit.**

<sup>55</sup> Cf. gjithashtu rregulla 60.4 e "Rregullave të ndryshuara evropiane për burgjet" (Rekomandimi R (2006) 2 i Komisionit të ministrave të Këshillit të Evropës).

<sup>56</sup> Vlen të përmendet se çdo dënim disiplinor mund të ketë ndikim në vendimin për lirim të parakohshëm.

<sup>57</sup> Neni 115, paragrafi 1 i Ligjit për ekzekutimin e dënimeve dhe neni 295, paragrafi 4 i KPPP-së.

<sup>58</sup> Shih Rregullën 61.

100. KPT-ja është e ndruajtur përkitazi me përfshirjen e mjekëve në procedurat disiplinore kundër të burgosurve<sup>59</sup>. Rrjedhimisht, KPT-ja dëshiron të thekson se personeli mjekësor që punon në burgje janë mjekë personalë të të burgosurve dhe garantimi i marrëdhënies pozitive mes mjekut dhe pacientit është faktor kryesor në ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së të burgosurit. Vënia e obligimit ndaj mjekëve të burgut për të vërtetuar se të burgosurit janë të aftë për vuajtjen e këtij dënimi ka pak gjasa të avancojë këtë marrëdhënie. Për këtë pikë është arritur pajtimi edhe në Rekomandimin (2006) 2 për Rregullat e ndryshuara evropiane për burgje të Komisionit të Ministrave; në fakt Rregulla në versionin paraprak të këtyre Rregullave, që parasheh se mjekët burgut duhet të vërtetojnë se i burgosuri është i aftë për vuajtjen e dënimit të mbylljes disiplinore tani është hequr.

**Kështu, KPT-ja rekomandon rishikimin e rregullimeve dhe praktikave ekzistuese ligjore lidhur me rolin e mjekëve të burgut në çështjet disiplinore. Gjatë kësaj procedure, duhet t'i kushtohet vëmendje Rregullave të ndryshuara evropiane për burgje dhe komenteve të bëra nga KPT-ja në paragrafin 53 të Raportit të tij të përgjithshëm nr. 15 (CPT/Inf (2005) 17).**

101. Me një përjashtim, kushtet në qelitë disiplinore kanë qenë të pranueshme në të gjitha burgjet dhe qendrat e paraburgimit të vizituara. Përjashtimi kishte të bënte me të vetmen qeli disiplinore në Qendrën e paraburgimit në Mitrovicë, e cila ishte klaustrofobike (me sipërfaqe më të vogël se 4 metra katrorë dhe me një largësi prej dy mureve prej vetëm një metri dhe e pajisur dobët (kishte vetëm një shtrat palues që ishte i ngjitur për mur në pozitë të drejtë dhe kishte edhe një karrige). **KPT-ja duhet të thekson se vetëm duke marrë parasysh madhësinë e saj, qelia e lartpërmendur nuk është e përshtatshme për qëndrim gjatë natës. Andaj, duhet të gjendet një zgjidhje tjetër për të burgosurit që vuajnë dënimin me burgosje në vetmi.**

b. Qelitë e sigurisë

102. Shumica e burgjeve dhe e qendrave të paraburgimit të vizituara kishin qeli speciale të vetmisë (të ashtuquajtura “qelitë VS”- *Vetmia Speciale*), të cilat shfrytëzoheshin për vendosjen e të burgosurve të dhunshëm dhe (apo) të shqetësuar.

Në burgun e Dubravës, një qeli e tillë është parë në Bllokun 5, e cila nuk ishte fare e pajisur dhe shfrytëzohej për mbajtjen e personave të shqetësuar për afate kohore deri në 48 orë. Një gjendje e tillë nuk është e pranueshme.

Gjatë bisedave të bëra në fund të vizitës, delegacioni tha se në gjendjen e saj të tanishme, qelia e lartpërmendur ishte plotësisht e papërshtatshme për shfrytëzim nga të burgosurit. Në pajtim me nenin 4, paragrafi 5 të marrëveshjes, delegacioni kërkoi që qelia në fjalë menjëherë të hiqej nga shfrytëzimi.

Përmes letrës së datës 26 qershor 2007, UNMIK-u informoi KPT-në se qelia lartpërmendur është hequr nga shfrytëzimi.

---

<sup>59</sup> Neni 114, paragrafi 4 i Ligjit për ekzekutimin e dënimeve, parasheh që “dënimi disiplinor i burgosjes në vetmi mund të mos shqiptohet para marrjes së mendimit të mjekut, ku thuhet se personi i dënuar është në gjendje fizike dhe psikologjike të kalojë një periudhë kohore në vetminë e burgut, në dhomën ku zbatohet dënimi i mbylljes në vetmi.

c. Kontakti me botën jashtë burgut

103. Në bazë të dispozitave përkatëse ligjore dhe të PSP-ve, të burgosurit kanë të drejtë të dërgojnë dhe të pranojnë letra<sup>60</sup>, të pranojnë vizita<sup>61</sup> (për të burgosurit, e rritur së paku një vizitë njëorëshe në muaj dhe një vizitë treorëshe çdo tre muaj; për të miturit, një orë në javë) dhe kanë të drejtë në telefonata<sup>62</sup> (një herë në javë me kohëzgjatje prej pesë deri në dhjetë minuta).

Informatat e grumbulluara gjatë vizitës treguan se rregullat e lartcekura në përgjithësi janë respektuar në të gjitha burgjet dhe qendrat e paraburgimit të vizituara. Në disa prej tyre, të drejtat ekzistuese për vizita në fakt ishin më të favorshme sesa sa të drejtat minimale të parapara me ligj (p.sh. të burgosurit e dënuar mund të kishin vizitë njëorëshe çdo javë, ndërsa të paraburgosurit – vizitë 30 minutëshe çdo javë). KPT-ja e mirëpret këtë zhvillim.

### C. Institucionet e mirëqenies psikiatrike dhe sociale

#### 1. Komentet paraprake

104. Delegacioni ka vizituar kliniken psikiatrike në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës dhe Repartin psikiatrik dhe neurologjik në Spitalin regjional të Mitrovicës, si dhe institucionin special në Shtime.

**Klinika psikiatrike në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës** përbëhet prej dy reparteve të mbyllura, një reparti të kujdesit intensiv – emergjencës (kapaciteti: 14 shtretër) dhe reparti i mjekësisë ligjore (“reparti i të burgosurve”; kapaciteti: 8 shtretër), si dhe reparteve të ndryshme të hapura (reparteve të përgjithshme psikiatrike për pacientët meshkuj dhe femra, repartit për narkomanë si dhe qendrës për kujdesin ditor të fëmijëve). Delegacioni përqendroi vizitën e tij në dy reparte të mbyllura. Po ashtu, delegacioni intervistoi pacientët që iu nënshtruan trajtimit të detyrueshëm të urdhëruar nga gjykata<sup>63</sup>. Në kohën e vizitës, nëntë pacientë (duke përfshirë dy femra ishin vendosur në repartin emergjent, ndërsa katër pacientë meshkuj gjendeshin në repartin e mjekësisë ligjore.

Atmosfera e ngjashme me atë të burgut në repartin e mjekësisë ligjore ishte shqetësuese. Të vetmit punonjës që ishin të pranishëm në repart ishin zyrtarët e burgut, dhe pacientët shpesh prangoseshin me rastin e sjelljes së tyre në zyrën e mjekut jashtë repartit. Po kështu, pacientët nuk kanë pasur mundësi që të merren me ushtrime në ambient të hapur për periudha mjaft të gjata kohore (shih paragrafët 109, 110, 118).

---

<sup>60</sup> Neni 60 dhe 61 i Ligjit për ekzekutimin e dënimeve dhe neni 294, paragrafi 4 i Kodit të Përkohshëm të Procedures Penale - KPPP.

<sup>61</sup> Neni 64 dhe 68 i Ligjit për ekzekutimin e dënimeve; neni 294, paragrafi 1 dhe 2 i KPPP-së; Neni 116 i Kodit Penal për të Mitur – KPM; Praktikave standarde të punës 7.1.

<sup>62</sup> Neni 62 i Ligjit për ekzekutimin e dënimeve.

<sup>63</sup> Për shkak të mungesës së institucioneve të duhura në Kosovë, pacientët në fjalë mbaheshin në një repart të hapur për pacientët psikiatrikë meshkuj.

**Spitali regional i Mitrovicës** gjendet në qendrën e qytetit të Mitrovicës së veriut. Reparti i psikiatrisë dhe neurologjisë i spitalit kishte kapacitetin prej 40 shtretërish (20 për pacientët e psikiatrisë dhe 20 për ata të neurologjisë), dhe në kohën e vizitës aty ishin të vendosur 13 pacientë të psikiatrisë (duke përfshirë 6 femra). Për shkak të mungesës së infrastrukturës së duhur për vendosjen e pacientëve jovullnetarë, këta pacientë mbareshin në spital vetëm për një periudhë të shkurtë kohore. Zakonisht ata më pas transferoheshin për trajtim të mëtejshëm në spitalin psikiatrik në Serbi.

“**Instituti special i Shtimes**” është hapur para disa dekadash si një institucion për persona që vuajnë nga paaftësitë mendore. Gjatë viteve u bë një institucion më i madh i këtij lloji në Kosovë, ku vendoseshin qindra persona të të gjitha grupmoshave që vuanin nga paaftësitë mendore apo ato fizike, sëmundjeve mendore apo ata që ishin në nevojë për kujdes për ndonjë arsye tjetër (alkoolistët, fëmijët e braktisur, etj.). Në vitin 2000 ka filluar zbatimi i politikës së mospranimimit dhe është filluar procesi i deinstitutionalizimit. Qëllimi i kësaj ka qenë që të bëhet një bartje progresive e të gjithë pacientëve banorë në qendrat e kujdesit të bazuara në komunitet gjithandej Kosovës. Qëllimi përfundimtar i këtij procesi ishte shpërbërja e tërë institucionit<sup>64</sup>. Në shtator të vitit 2006 Instituti Special është ndarë zyrtarisht në dy institucione të ndara – një për personat me paaftësi mendore nën kompetencën e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale dhe tjetri – një qendër integruese për shëndetin mendor të pacientëve kronik psikiatrik nën kompetencën e Ministrisë së Shëndetësisë. Në kohën e vizitës, institucioni i parë kishte 74 banorë (30 meshkuj dhe 22 femra) dhe i fundit kishte 72 pacientë (39 meshkuj dhe 33 femra).

105. KPT-ja ka vënë re se Spitali regional në Mitrovicën e veriut në fakt ishte i administruar në mënyrë ekskluzive (në kuptim të buxhetit, menaxhimit, punonjësve, mbikëqyrjes, etj) nga Ministria e Shëndetësisë e Serbisë. Përfaqësuesit e UNMIK-ut ia kanë vërtetuar delegacionit se UNMIK-u nuk ushtronte kurrfarë kontrolli mbi këtë institucion (pasi që ky i fundit ishte pjesë e të ashtuquajturave struktura paralele).

Sidoqoftë, **Komisioni kërkon nga UNMIK-u që të bëjë çdo përpjekje të mundshme për të lehtësuar zbatimin e rekomandimeve dhe komenteve të bërë në paragrafët 111, 112, 123, 127, 131 deri 133, 136, 138 dhe 139 lidhur me Repartin për psikiatri dhe neurologji të Spitalit regional të Mitrovicës.**

## **2. Keqtrajtimi**

106. Delegacioni nuk dëgjoi ndonjë pohim për keqtrajtim nga ana e punonjësve të *Klinikës psikiatrike në Prishtinë* dhe të *Spitalit regional në Mitrovicë*. Atmosfera në të dy institucionet ka qenë e relaksuar (në një shkallë më të vogël të relaksimit në repartin e mjekësisë ligjore në Klinikën psikiatrike në Prishtinë), dhe marrëdhëniet mes punonjësve dhe pacientëve ishin të mira.

Megjithëkëtë, disa pohime për keqtrajtim fizik (siç janë shuplakat) nga mbajtësit e rendit janë bërë në *Institutin special në Shtime*.

Përmes letrës së 26 qershorit 2007 UNMIK-u informoi KPT-në se “drejtori i Departamentit për shëndetin mendor i përkujtoi punonjësit në Qendër për përgjegjësitë e tyre të punës dhe etikën mjekësore. Ai po ashtu ua tërhoqi vëmendjen se nëse Ministria e Shëndetësisë (MSh) informohet për çfarëdo keqtrajtimi, atëherë ajo do të ndërmerë masa përkatëse disiplinore”.

---

<sup>64</sup> Deri më tani janë hapur pesë qendra për të rritur dhe dy për fëmijë; të gjitha këto qendra janë degë të Institutit special të Shimës.

Ky është një zhvillim i mirëpritur. **KPT-ja rekomandon që e njëjta porosi t'u dërgohet edhe punonjësve të institucionit për persona me paaftësi mendore në Shtime.**

107. Po kështu një numër i pacientëve/banuesve, shumica femra që i takuam në Shtime. pohuan se i janë nënshtruar dhunës dhe (apo) ngacmimit nga pacientët/banuesit e tjerë.<sup>65</sup> Deklaratat e tilla nuk janë dhënë në institucionet e tjera psikiatrike që janë vizituar.

**KPT-ja rekomandon që punonjësit në Shtime t'i shfrytëzojnë të gjitha mjetet në dispozicion për parandalimin e dhunës dhe ngacmimeve mes pacientëve dhe (apo) banuesve. Për ta trajtuar këtë problem punonjësit duhet të jenë të vëmendshëm për shenjat e problemeve dhe po ashtu duhet të jenë të vendosur dhe të aftësuar në mënyrë të duhur për të ndërhyrë në rast të nevojës.**

### 3. Kushtet e jetesës së pacientëve/banuesve

108. Në çdo institucion psikiatrik/të mirëqenies sociale qëllimi duhet të jetë ofrimi i kushteve të mira për trajtim dhe mirëqenie të pacientëve/banuesve; thënë në gjuhën psikiatrike, ofrimi i një mjedisi pozitiv terapeutik. Krijimi i një mjedisi të tillë pikësepari përfshinë sigurimin e hapësirës së mjaftueshme për jetesë për person, si dhe ndreqim, ngrohje dhe ajrosje adekuate që e mban institucionin në një gjendje të kënaqshme të funksionimit dhe që i përmbush kërkesat higjienike të spitalit. Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet dekorimit të dhomave dhe të vendeve rekreative të pacientëve dhe të banuesve.

109. Kushtet e jetesës në repartin e kujdesit intensiv/emergjencës në Klinikën psikiatrike në Prishtinë ishin në përgjithësi shumë të mira dhe nuk kanë nevojë për ndonjë koment të posaçëm.

Megjithatë, kushtet në repartin e mjekësisë ligjore ishin shumë të ngjashme me ato të burgut dhe shumë pak të përshtatshme për krijimin e një mjedisi terapeutik. Mbjajtja e pacientëve në një gjendje plotësisht joaktive është mjaft shqetësuese: ata nuk kanë pasur kurrfarë mundësie të dalin jashtë ambienteve të mbyllura e as nuk u janë dhënë materiale për lexim dhe nuk kanë mundur të shikojnë televizor apo të dëgjojnë radio e as që kanë mundur të bëjnë telefonata. Duhet të shtohet se pacientët janë mbajtur në kushte të tilla për muaj të tërë. Në kohën e vizitës një pacient ishte mbajtur në repartin e mjekësisë ligjore 9 muaj, ndërsa më parë aty një pacient ishte mbajtur 18 muaj.

110. Gjatë bisedave të fundit të vizitës delegacioni kërkoi nga autoritetet përkatëse ndërmarrjen e hapave të menjëhershëm për të siguruar që të gjithë pacientëve që mbahen në repartin e mjekësisë ligjore të Klinikës psikiatrike në Prishtinë t'u ofrohet çdo ditë, nëse gjendja e shëndetësore e tyre e lejon, së paku një orë të ushtrimeve në ambiente të hapura.

---

<sup>65</sup> Për shembull, një banore femër që e tregoi "syrin e mavijosur" pohoi se ishte sulmuar me shtagë dhe ishte goditur nga një bashkëbanor.

Në shkresën e 26 qershorit 2007 UNMIK-u informoi KPT-në se “pas diskutimeve mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë tani është e mundur që i paraburgosuri/i burgosuri në spitalin e Prishtinës të bëjë telefonata. Gjithashtu, me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, një dhomë është siguruar për takime private, siç janë konsultimet me avokatë. Përveç kësaj, një televizor do të sigurohet nga Ministria e Drejtësisë/Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe një sistem i ushtrimeve të përditshme në kohëzgjatje prej një ore në oborret spitalit është duke u diskutuar mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë/ShKK. Brenda klinikës nuk ka vende specifike që do të mund të përdoren për këtë qëllim; që të dy ministritë janë duke punuar drejt gjendjes së një zgjidhjeje të duhur”.

Duke i miratuar hapat e ndërmarrë deri më tani nga UNMIK-u, **KPT-ja rekomandon që autoritetet të bëjnë përpjekje prioritare për të siguruar që të gjithë pacientëve që mbahen në Repartin e mjekësisë ligjore në Klinikën psikiatrike në Prishtinë t’u ofrohet çdo ditë, nëse gjendja e tyre shëndetësore e lejon, së paku nga një orë të ushtrimeve në mjedise të hapura.**

111. Kushte materiale në Repartin e psikiatrisë dhe të neurologjisë në Spitalin regjional të Mitrovicës në përgjithësi ishin të kënaqshme. Të gjitha dhomat ishin të një madhësie të arsyeshme (disa 20 metra katrorë për katër pacientë, dhe nganjëherë edhe për pesë), kishin orëndi themelore dhe ishin të ndriçuara mirë dhe të pastra. Megjithatë, për shkak të mungesës së përgjithshme të dekorimeve atmosfera ishte mjaftë e zymtë. **Autoritetet përkatëse duhet të ndërmarrin hapa për ta rregulluar këtë mangësi.**

112. KPT-ja është e brengosur nga pothuajse një mungesë e plotë e aktiviteteve rekreative (siç TV-ja, radioja, librat, gazetat) në spital. Gjithashtu, nuk është siguruar asnjë ushtrim në mjedise të hapura për pacientët psikiatrikë që nuk kanë pasur mundësi të dalin vet nga Reparti. Edhe nëse shumica e pacientëve zakonisht qëndrojnë në spital vetëm për një kohë relativisht të shkurtë, duhet të gjendet një zgjidhje për t’ua mundësuar pacientëve, gjendja shëndetësore e të cilëve ua lejon, daljen jashtë për së paku një orë në ditë.

**Komisioni rekomandon ndërmarrjen e hapave nga autoritetet relevante për t’u siguruar që në spitalin regjional të Mitrovicës:**

- **Të ofrohen disa aktivitete rekreative për pacientët psikiatrikë;**
- **Të gjithë pacienteve psikiatrikë, gjendja shëndetësore e të cilëve ua mundëson, t’u ofrohen ushtrime në mjedise të hapura së paku një orë çdo ditë.**

113. Në Institutin Special të Shtimes kushtet ishin në përgjithësi të kënaqshme në institucionin e ri për persona me paaftësi mendore, i cili është nën autoritetin e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale. I tërë institucioni ishte në një gjendje relativisht të mirë përkitazi me funksionalitetin dhe pastërtinë. Dhomat e fjetjes kishin hapësirë të mjaftueshme (disa kishin 16 metra katrorë për 4 persona), kishin dritare të mëdha, ishin të pajisura me shtretër, tavolina pranë shtretërve dhe dollap). Në çdo kat ishte nga një dhomë e ditës me një televizor dhe një divan të ri. Megjithatë, dhomat e banuesve nuk kishin ndonjë gjësend personal. **Rrjedhimisht, në këtë drejtim duhet të ndërmerren hapa për të ofruar mjedise më të personalizuar për banorët e institucionit për persona me paaftësi mendore në Shtime.**

114. Delegacioni krijoi një përshtypje të mirë për aktivitetet socio-rehabilituese dhe rekreative në dispozicion për banuesit (për shembull: qepja, qëndisja, punët e dorës, pikturimi, sportet). Banuesit gjithashtu kishin mundësi të lëvizin lirshëm brenda hapësirave të institucionit (përfshirë parkun e madh).

115. Nga ana tjetër, kushtet për pacientët në Qendrën integruese për shëndetin mendor në Ministrinë e Shëndetësisë ishin shumë të dobëta. Edhe pse dhomat e fjetjes ishin të duhura sa i përket hapësirës së jetesës (më shumë se 9 metra katrorë për një apo dy persona) dhe qasjes në ndriçimin natyror, shumë prej tyre, si dhe të gjitha dhomat e ditës ishin të vjetruara, ndërsa disa nga orenditë ishin të prishura. Gjithashtu, niveli i higjienës ishte larg nga niveli i kënaqshëm, ku kundërmimi i urinës ndjehej në shumë pjesë të Qendrës, pavarësisht se dritaret ishin të hapura<sup>66</sup>.

KPT-ja është shumë e shqetësuar nga fakti se Qendra siç duket ende kishte mungesë të fondeve për të siguruar edhe nevojat bazike të pacientëve, siç janë veshmbathjet adekuate<sup>67</sup>. Delegacioni gjithashtu është informuar se pagesa për ngrohje dhe ushqim ende nuk është siguruar. Po ashtu, është shqetësues fakti i mungesës së aktiviteteve të organizuara për pacientë.

116. Përmes letrës së 26 qershorit 2007 UNMIK-u e informoi KPT-në se “me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për ngrohje gjatë dimrit të kaluar dhe për mbulimin e shpenzimeve të ushqimit MSh-ja i ka dhënë 106 mijë euro Qendrës së Shtimes nga llogaritë apo nga vijat buxhetore të qendrave të tjera integruese të shëndetit mendor në Kosovë. Për të zgjidhur problemin ofrimit të veshmbathjeve për pacientët e institucionit të Shtimes, punëtorët shëndetësorë të kësaj Qendre integruese i intensifikuan aktivitetet e tyre për gjetjen e donatorëve, të cilat rezultuan me disa donacione nga kontingjenti i KFOR-it italian dhe ai francez si dhe nga OJQ-ja ndërkombëtare CARITAS (veshmbathje dhe medikamente). Po kështu, nevojiten mjete financiare të konsiderueshme për t'i blerjen shtretërve, dyshekëve dhe mobileve të reja. Po ashtu, buxheti mungon për organizimin e aktiviteteve ditore të pacientëve. Përkundër faktit se në shtator të vitit 2006 MSh-ja morri përgjegjësinë mbi Qendrën integruese për shëndetin mendor në Shtime dhe përkundër kërkesës së bërë me kohë për linjën e re buxhetore për vitin fiskal 2007, fondet e nevojshme nuk i janë dhënë Qendrës”.

KMP-ja mirëpret hapat e ndërmarrë deri më tani nga autoritetet relevante, megjithatë është mjaft shqetësuese se pothuajse pas një viti ekzistence Qendra integruese për shëndetin mendor ende nuk e merr buxhetin e duhur.

**Komisioni rekomandon që të ndërmerren hapa shtesë si prioritet për të përmirësuar kushtet e jetesës së pacientëve në Qendrën integruese për shëndetin mendor në Shtime në vazhden e komenteve të lartpërmendura.**

---

<sup>66</sup> Shumë pak kohë para vizitës së KPT-së e tërë sipërfaqja e katit përdhes, ku ofroheshin kushte të mjerueshme jetese (ku dhomat e fjetjes ishin pjesërisht të vërshuara, të ndyra dhe me kundërmim të keq) është hequr nga shërbimi për vendosjen e pacientëve.

<sup>67</sup> Disa pacientë nuk kanë pasur këpucë fare. Për shkak të mungesës së rrypave për pantollonat e tyre disa pacientë ishin të detyruar që vazhdimisht t'i mbanin pantollonat e tyre me duar derisa ecnin nëpër oborr.

#### 4. Punonjësit

117. Që në fillim, KPT-ja dëshiron të thekson se në të gjitha institucionet psikiatrike të vizituara shumica e pacientëve/banuesve që u takuan nga delegacioni shprehen falënderimet e tyre për mënyrën se si janë trajtuar nga punonjësit dhe, në veçanti, nga motrat medicinale.

118. Numri i të punësuarve në kujdesin shëndetësor në Repartin e emergjencës dhe të kujdesit intensiv në Klinikën psikiatrike në Prishtinë në shumë aspekte ka qenë adekuat (me tre mjekë që po ashtu kanë punuar në reparte të tjera dhe 17 motra medicinale). Përveç kësaj, njësia është vizituar nga psikologu që punonte për tërë klinikën psikiatrike (dhe ishte njëri nga psikologët e pakët të punësuar në sistemin shëndetësor të Kosovës).

Gjendja ka qenë më pak e mirë në Repartin e mjekësisë ligjore, në të cilën punonin punonjësit nga Reparti i përgjithshëm psikiatrik për pacientët meshkuj. Ekipi i kujdesit shëndetësor përfshinte një kryepsikiatër dhe tre psikiatra (të cilët gjithashtu kanë punuar në reparte të tjera të Klinikës), si dhe shtatë motra medicinale. Sidoqoftë prania e punonjëse të kujdesit shëndetësor ka qenë e kufizuar në pesë vizita ditore nga motrat medicinale me qëllim të dhënies së medikamenteve të përshkruara dhe në një vizitë nga mjeku. Kështu, të vetmit punonjës që ishin të pranishëm vazhdimisht në Repart ishin pesë apo gjashtë zyrtarë të burgut (të punësuar nga Qendra e paraburgimit të Prishtinës)<sup>68</sup>; të gjithë zyrtarët kishin vijuar një aftësim njëjavor përkitazi me detyrat e tyre.

**KPT-ja rekomandon që të ndërmerren hapa për të siguruar vijimin e rregullt të punonjësve shëndetësorë në Repartin e mjekësisë ligjore në Klinikën psikiatrike të Prishtinës.**

119. Në Repartin e psikiatrisë dhe të neurologjisë në Spitalin regional të Mitrovicës numri i mjekëve dhe i motrave ka qenë në nivel shumë të mirë. Aty ishin gjashtë mjekë (duke përfshirë 2 psikiatra) dhe 30 motra medicinale, ku të gjithë këta punonin për tërë Repartin (me 40 shtretër). Përveç kësaj, Spitali i ka punësuar edhe dy psikologë.

120. Në Institutin special në Shtime, numri i punëtorëve të kujdesit shëndetësor ishte adekuat në tërë institucionin për personat me paaftësi mendore në të cilin punonte një mjek, 16 motra medicinale dhe 8 mbajtës të rendit.

**KPT-ja rekomandon ndërmarrjen e hapave nga autoritetet përkatëse për të siguruar që në Qendrën integruese për shëndetin mendor në Shtime:**

- **Kujdesi psikiatrik të rritet përmes së paku një psikiatri që do të punonte me orar të plotë;**
- **Numri i motrave medicinale dhe i mbajtësve të rendit të rritet.**

---

<sup>68</sup> Përveç kësaj, hyrja në Repart ishte e ruajtur nga një polic i armatosur.

## 5. Trajtimi

121. Trajtimi psikiatrik duhet të bazohet në një qasje të individualizuar, e cila nënkupton hartimin e një plani të trajtimit për secilin pacient, ku ceken qëllimet e trajtimit, mjetet terapeutike të përdorura dhe punonjësi përgjegjës. Plani i trajtimit gjithashtu duhet t'i përfshijë edhe kontrollet e rregullta të gjendjes mendore të pacientit dhe kontrollet e medikamenteve apo barërave të pacientit.

Po kështu ky trajtim duhet të përfshijë një vistër të gjerë të aktiviteteve terapeutike rehabilituese dhe rekreative, siç janë qasja në terapi përmes angazhimit të punë, në terapinë grupore, në psikoterapinë individuale, në art, në dramë, në muzikë dhe në sporte. Pacientët duhet të kenë qasje të rregullt në dhoma rekreative të pajisura në mënyrë të duhur dhe të kenë qasje në ushtrime të përditshme në ambient të hapur; është po ashtu e dëshirueshme për pacientët afatgjatë që t'u ofrohet shkollim dhe punë e përshtatshme.

122. Në përgjithësi furnizimi me medikamente duket të ishte adekuat në të gjitha institucionet psikiatrike të vizituara. Në asnjërin prej institucioneve të vizituara nuk janë vërejtur raste të pranishme të tepërt të medikamenteve (shih paragrafin 125).

123. Delegacioni ka vërejtur se pothuajse asnjë formë e trajtimit, përveç farmakoterapisë, nuk është dhënë në institucionet psikiatrike të vizituara. Po ashtu, duhet të ceket se në institucionin për persona me paaftësi mendore në Shtime, më shumë se gjysma e banuesve merrnin në mënyrë të rregullt medikamente psikotropike.

**KPT-ja rekomandon që të ndërmerren hapa në të gjitha institucionet psikiatrike të vizituara në veçanti në atë në Shtime për t'i zhvilluar aktivitetet e trajtimit dhe të rehabilitimit për pacientët/banorët psikiatrikë, të cilat gjithashtu do të mundësonin zvogëlimin e medikamenteve psikotropike.**

## 6. Kontrolli i pacientëve/banuesve të shqetësuar dhe (apo) të dhunshëm

124. Në çdo institucion psikiatrik/të mirëqenies sociale kontrolli i pacientëve/banuesve të shqetësuar apo të dhunshëm mund që ndonjëherë të jetë i nevojshme. Megjithatë, kjo është një fushë e shqetësimit të posaçëm për KMP-në, duke marrë parasysh potencialin për keqtrajtim.

Është e rëndësishme që kontrolli i pacientëve/banuesve t'i nënshtrohet politikave të përcaktuara mirë. Ato politika duhet ta bëjnë të qartë se përpjekjet fillestare për kontrollin e pacientëve të shqetësuar apo të dhunshëm duhet të jenë sa më shumë të natyrës jofizike (për shembull, udhëzimet me gojë), dhe aty ku kontrolli fizik është i nevojshëm, ai në parim duhet të kufizohet në kontroll manual.

Përdorimi i kontrollit mekanik duhet të arsyetohet vetëm në raste shumë të rralla, dhe gjithnjë duhet të urdhërohet shprehimisht nga një mjek apo menjëherë të vihet në dijeni të një mjeku me qëllim të marrjes së miratimit të tij. Nëse në raste të jashtëzakonshme zgjidhja kërkohet në instrumentet e kontrollit fizik, ato duhet të largohen sa më parë që të jetë e mundur; ato nuk duhet të zbatohen asnjëherë ose të zgjatet aplikimi i tyre si ndëshkim. Pacientët që i nënshtrohen mënyrave të kontrollit mekanik duhet që gjithnjë gjenden e tyre mendore dhe fizike ta kenë të monitoruar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga një punonjës i kujdesit shëndetësor.

Gjithashtu, çdo rast i kontrollit të një pacienti/banuesi (kontrolli me dorë, kontrolli mekanik, mbyllja) duhet të regjistrohet në një regjistër të posaçëm, të krijuar për këtë qëllim (si dhe në dosjen e pacientit). Këto të dhëna duhet të përfshijnë kohën e fillimit dhe mbarimit të masës, rrethanat e rastit, arsyet për përdorimin e masës, emrin e mjekut që e ka urdhëruar apo miratuar atë dhe përshkrimin e lëndimeve të marra nga pacienti apo punonjësi. Kjo do ta lehtësojë shumë menaxhimin e incidenteve të tilla dhe mbikëqyrjen e shpeshëtisë së ndodhjes së tyre.

125. Në të gjitha institucionet psikiatrike të vizituara, pacientët e shqetësuar zakonisht janë vënë nën kontroll me medikamente qetësuese (me kontroll kimik). Kontrollat mekanike (xhaketat për persona me çrregullime mendore) janë përdorur shumë rrallë ose fare. Vetëm në Repartin e kujdesit intensiv/emergjencë në Klinikën psikiatrike në Prishtinë ka pasur dhoma të mbylljes.

Lidhur me kontrollin kimik, delegacioni ka takuar një pacient në Repartin e kujdesit intensiv/emergjencë në Klinikën psikiatrike në Prishtinë, i cili ka shfaqur simptome të qarta të dhënies së tepërt të medikamenteve (atij i janë dhënë medikamente neuroleptike shtesë pas një incidenti të dhunshëm të ndodhur dy ditë më parë me një pacient tjetër). Përveç kësaj, siç duket atij nuk i është dhënë asnjë trajtim korrektues (pra, biperidin). Delegacioni është siguruar nga mjekja përgjegjëse se ajo do ta shqyrton çështjen menjëherë.

Po kështu, delegacioni është informuar se në Repartin e mjekësisë ligjore në Klinikën psikiatrike në Prishtinë pacientëve të shqetësuar nganjëherë u prangoseshin duart për shtretërit e tyre derisa medikamenti qetësues i injektuar të kishte efekt. **KPT-ja rekomandon që kësaj praktike t'i vihet fundi; nëse kontrolli mekanik kërkohet përkohësisht, duhet të përdoren mënyrat e duhura alternative, p.sh; xhaketat për persona me çrregullime mendore.**

126. Në Qendrën integruese për shëndetin mendor në Shtime delegacioni vuri re se infermieret dukeshin se e kanë të drejtën e ndryshimit të dozave të medikamenteve që janë përshkruar paraprakisht. Rastet e kontrollit me metoda kimike nuk i janë vënë në dijeni mjekut në mënyrë sistematike.

KPT-ja dëshiron të thekson se kontrolli me metoda kimike gjithnjë duhet të urdhërohet nga mjeku; andaj **rekomandon se punonjësit infermierë në Shtime të udhëzohen siç duhet.**

127. Në asnjë prej institucioneve të vizituara nuk ka pasur raste ku përdorimi i kontrolleve (kontrollat mekanike, mbyllja, kontrollat kimike) janë regjistruar në ndonjë regjistër të posaçëm. **KPT-ja rekomandon që regjistrat e posaçëm përdorimit të mjeteve të kontrollit, të krijohen në çdo institucion psikiatrik të vizituar.**

## 7. Masat e mbrojtjes

128. Duke pasur parasysh rrezikshmërinë e tyre, të sëmurit mendorë dhe të hendikepuarit mendorë kanë nevojë për vëmendje të posaçme lidhur me parandalimin e çdo lloj sjelljeje – apo shmangieje të ndonjë lëshimi – që do të ishte në kundërshtim me mirëqenien e tyre. Rrjedhimisht, vendosja jovullentare në institucionin psikiatrik gjithmonë duhet të përcillet me masa të duhura të sigurisë.

a Procedurat e vendosjes dhe të lëshimit në institucionin psikiatrik

129. Procedura përmes së cilës merret vendimi për vendosjen jovullnetare në ndonjë institucion psikiatrik/të mirëqenies sociale duhet të ofrojë garanci të pavarësisë dhe të paanshmërisë, si dhe ekspertizë psikiatrike objektive. Gjithashtu, vendosja e tillë duhet të përfundojë menjëherë pasi të mos jetë më e kërkuar në bazë të gjendjes mendore të pacientit/banuesit. Nevoja për vendosje duhet të shqyrtohet rregullisht nga një autoritet i duhur. Gjithashtu, vet pacienti/banori duhet të kërkojë në intervale të arsyeshme që nevoja për vendosje të shqyrtohet nga një autoritet gjyqësor.

130. Ligji në fuqi në Kosovë përmban një numër dispozitash lidhur me vendosjen jovullnetare të një natyre civile të pacientëve në institucionet psikiatrike. Sipas Ligjit për procedurën jokontestimore të vitit 1986, institucionet psikiatrike janë të obliguara që ta lajmërojnë në gjykatën kompetente çdo vendosje jovullnetare (menjëherë apo brenda tri ditëve)<sup>69</sup>. Personi në fjalë duhet të kontrollohet nga tre mjekë specialistë, të cilët duhet të dalin me një mendim ekspertësh dhe ta dorëzojnë në gjykatë brenda tetë ditëve<sup>70</sup>. Gjykata duhet të merr vendimin lidhur me vendosjen jovullnetare brenda tetë ditëve nga lajmërimi (apo brenda 15 ditëve, nëse nevojitet më shumë kohë për caktimin e diagnozës).

Është rregull që pacienti duhet të dëgjohet personalisht nga gjykata, para se të merret vendimi për vendosjen jovullnetare. Në vendimin e saj, gjykata duhet të përcakton kohëzgjatjen e urdhrat të vendosjes, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se një vit<sup>71</sup>. Gjatë vendosjes jovullnetare, pacienti në fjalë, kujdestari i tij apo i afërmi mund që në çdo kohë t'ia parashtrojnë gjykatës kërkesën për lëshim<sup>72</sup>. Pas kalimit të afatit kohor, urdhrat për vendosje mund të ripërtërihen një herë për një periudhë maksimale prej një viti<sup>73</sup>.

131. Dispozitat e lartpërmendura të Ligjit për procedurën kontestimore në një shkallë të lartë i përmbushin standardet e KPT-së lidhur me vendosjen jovullnetare të pacientëve në institucionet psikiatrike. Megjithatë, është tepër shqetësuese se këto dispozita nuk janë zbatuar fare në praktikë në asnjërin nga institucionet e vizituara. Rrjedhimisht, pacientët janë privuar nga liria e tyre, disa herë edhe për vite me radhë, pa përfutur nga asnjë masë e duhur e mbrojtjes. Në praktikë, formulari i pajtimit shpesh nënshkruhet nga anëtari i familjes, nëse pacienti në fjalë nuk jep pëlqimin për vendosje.

**KPT-ja rekomandon që të ndërmerren hapa pa ndonjë vonesë për t'u siguruar që dispozitat ligjore relevante që zbatohen në Kosovë dhe të cilat vlejné për vendosjen jovullnetare të pacientëve të zbatohen në mënyrë të efektshme. Në këtë drejtim, gjykatat kompetente duhet të informohen për të gjithë personat që aktualisht mbahen jovullnetarisht në cilindo prej institucioneve psikiatrike të vizituara.**

<sup>69</sup> Shin nenin 46. procedura e njëjtë zbatohet kur pacientët vullnetarë e tërheqin pëlqimin e tyre për vendosje në një institucion psikiatrik.

<sup>70</sup> Nenet 49 dhe 38.

<sup>71</sup> Neni 51.

<sup>72</sup> Neni 55 dhe 39.

<sup>73</sup> Neni 52

132. Sa u përket personave që janë të privuar nga kapaciteti i tyre ligjor, delegacioni është informuar se në institucionin për persona me paaftësi mendore në Shtime, shumica dërrmuese e banuesve nuk kanë qenë në gjendje të japin pëlqimin valid për vendosjen e tyre. Megjithatë, vetëm një numër i vogël syresh kishin kujdestarin e vet të caktuar. Në disa raste, kujdestari siç dukej ishte caktuar shumë kohë më parë, dhe tani nuk mund të gjendej.

Në këtë drejtim, KPT-ja mirëpret faktin që kohëve të fundit janë ndërmarrë hapat e parë nga menaxhmenti në Shtime për të njoftuar gjykatën kompetente për rastet e tilla, me qëllim të caktimit të kujdestarit<sup>74</sup>. **Komisioni rekomandon ndërmarrjen e hapave në Shtime dhe, nëse ka nevojë, në institucionet e tjera të mirëqenies sociale/psikiatrike në Kosovë për të siguruar që gjykatat kompetente të jenë të njoftuara për të gjithë banorët/pacientët që supozoheshin si të paaftë për dhënien e pëlqimit për vendosjen e tyre.**

133. Nga shqyrtimi i dosjeve të banuesve/pacientëve, për të cilët procedura gjyqësore për caktimin e kujdestarit tanimë ishte kryer, doli në pah se banorët/pacientët në fjalë ishin kontrolluar nga psikiatri. Megjithatë, ata jo gjithmonë janë dëgjuar personalisht nga gjykatësi dhe nuk kanë marrë kopjen e vendimit të gjykatës.

**KPT-ja rekomandon ndërmarrjen e hapave nga autoritetet relevante për të siguruar që në kontekst të procedurave gjyqësore për privim nga kapaciteti ligjor i banuesit/pacientit dhe caktim të kujdestarit, personave në fjalë:**

- **T'u jepet e drejta që të dëgjohen personalisht nga gjykata;**
- **T'u jepet kopja e vendimit të gjykatës;**
- **Të informohen me shkrim dhe me gojë për mundësinë dhe modalitetet për parashtrimin e ankesës kundër vendimit të gjykatës.**

Po kështu, **Komisioni rekomandon ndërmarrjen e hapave për t'u siguruar që nevoja për vendosje në institucionin psikiatrik/të mirëqenies sociale të personave nën kujdestari të rishikohet në intervale të rregullta nga një autoritet i duhur.**

134. KPT-ja është e shqetësuar për gjendjen e një grupi pacientësh/banorësh prej 20 vetash me përkatësi etnike serbe që mbahen në Shtime për shumë vite me radhë. Të gjithë kishin identitetin e tyre zyrtar, por nuk ka mundur të gjendet dokumentacioni lidhur me vendosjen e tyre fillestare. Po ashtu, nuk ishte e qartë nëse ndonjëherë u është caktuar kujdestari (në bazë të punonjësve, ata të gjithë ishin të paaftë për dhënien e pëlqimit për vendosjen e tyre në institucion). Pasi që të gjithë të afërmit e tyre jetonin në Serbi, menaxhmenti ka bërë përpjekje të vazhdueshme për bartjen e tyre në institucionet e duhura të kujdesit në Serbi. Megjithatë, të gjitha këto përpjekje deri më tani nuk kanë pasur sukses. **KPT-ja do të dëshironte të merr komentet e UNMIK-ut për këtë çështje.**

---

<sup>74</sup> Kujdestarët duhet të caktoheshin nga qendra kompetente për mirëqenie sociale në bazë të një vendimi të gjykatës.

135. Lidhur me psikiatrinë forensike, vendosja e shkelësve që janë nën vlerësim apo që janë deklaruar penalisht të papërgjegjshëm dhe të cilët i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm në institucionin psikiatrik është e rregulluar përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/34 për procedurën penale që përfshinë kryerësit e veprave penale me çrregullime mendore<sup>75</sup>. Dispozitat përkatëse parashohin masat e duhura mbrojtëse dhe nuk parashohin ndonjë koment të caktuar.

Në bazë të Rregullores së lartpërmendur, vendosjet në institucionin psikiatrik me qëllim të trajtimit të obligueshëm kanë kohëzgjatje të përkohshme dhe duhet të rishikohen nga gjykata në periudha gjashtëmujore<sup>76</sup>. Mirëpo, pas shqyrtimit të dosjeve të dy pacientëve të mbajtur në Klinikën psikiatrike të Prishtinës për qëllime të trajtimit obligativ në kohën e vizitës, doli në pah se një rishikim i tillë nuk është bërë nga gjykata, përkundër faktit se për një rast vendimi fillestar për vendosje në institucion ishte marrë më shumë se një vit përpara, ndërsa në rastin tjetër më shumë se gjashtë muaj përpara.

**KPT-ja rekomandon ndërmarrjen e hapave nga autoritetet relevante për t'u siguruar që të gjitha vendosjet në institucione për trajtim obligativ t'i nënshtrohen rishikimeve të rregullta, siç parashihet në ligj.**

b. Masat mbrojtëse gjatë vendosjes në institucion

136. Një broshurë njoftuese që përcakton rregullat e institucionit dhe të drejtat e pacientëve/banuesve duhet t'i jepet çdo patienti/banuesi me rastin e pranimit të tij, si dhe familjeve të tyre. Cilido patient/banues që nuk mund të kuptojë këtë broshurë duhet të ketë ndihmesën e duhur.

Në të gjitha institucionet psikiatrike/të mirëqenies sociale të vizituara, pacientët/banorët e pranuar rishtazi kanë marrë informatat e duhura në mënyrë gojore, ndërsa informatat me shkrim nuk u janë dhënë<sup>77</sup>. **KPT-ja rekomandon ndërmarrjen e hapave në të gjitha institucionet e vizituara psikiatrike/të mirëqenies sociale për t'u siguruar që pacientëve/banuesve (si dhe familjeve të tyre) t'u jepet broshura njoftuese me rastin e pranimit të tyre që paraqet rregullat e institucionit dhe të drejta e tyre.**

137. KPT-ja gjithashtu dëshiron të thekson që si çështje parimi pacientët duhet të jenë në pozitë që të japin pëlqimin e tyre të lirë dhe të bazuar në informata për trajtim. Çdo patient/banues, qoftë me qëndrim vullnetar apo jovullnetar, duhet të ketë mundësinë e refuzimit – qoftë personalisht apo përmes kujdestarit – të trajtimit apo të çfarëdo ndërhyrjeje tjetër mjekësore. Çfarëdo shmangieje nga ky parim themelor duhet të jetë e bazuar në ligj dhe të ndërlidhet vetëm me rrethanat e jashtëzakonshme të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe strikte.

Natyrisht, pëlqimi për trajtim mund të kualifikohet si i lirë dhe i bazuar në informata vetëm nëse është i bazuar në informata të plota dhe të sakta për gjendjen e pacientit dhe për trajtimin që propozohet. Në këtë drejtim, është thelbësore që të gjithë pacientëve t'u jepen informata relevante në mënyrë sistematike lidhur me gjendjen e tyre dhe me trajtimin propozuar për ta. Informatat relevante po ashtu duhet të jepen pas përfundimit të trajtimit (rezultatet, etj).

<sup>75</sup> Nenet 10 deri në 24 dhe neni 33.

<sup>76</sup> Neni 21, paragrafi 3. Në bazë të neni 21, paragrafi 4, masa e trajtimit të detyrueshëm mund po ashtu të përfundohet nga gjykata sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë të pacientit në fjalë, avokatit të tij, institucionit të kujdesit shëndetësor apo autoritetit kompetent të kujdestarisë.

<sup>77</sup> Një broshurë informative dukej se po hartohej në Klinikën psikiatrike në Prishinë.

138. KPT-ja mirëpret faktin se normat e lartpërmendura janë të parapara në nenin 9 dhe 15 të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e banuesve të Kosovës në sistemin e kujdesit shëndetësor<sup>78</sup>.

Megjithatë, dukej se në praktikë, pranimi i personit në institucionet e vizituara psikiatrike në baza jovullnetare zakonisht është konsideruar si trajtim i autorizuar pa pëlqimin e tij.

**KPT-ja rekomandon ndërmarrjen e hapave në të gjitha institucionet psikiatrike dhe të mirëqenies sociale të vizituara për t'u siguruar që të gjithë pacientët/banuesit, duke përfshirë edhe ata të vendosur në baza jovullnetare, të kenë mundësinë e refuzimit – qoftë personalisht apo përmes kujdestarit të tyre – të trajtimit ose të ndonjë ndërhyrjeje tjetër mjekësore në përputhje me komentet e lartcekura.**

139. Një procedurë e efektshme e ankesave është një masë tjetër themelore mbrojtëse kundër keqtrajtimit në institucionet psikiatrike. Duhet të ekzistojnë rregullimet specifike që do t'ua mundësonin pacientëve/banuesve parashtrimin e ankesave zyrtare organit qartazi të paraparë për këtë qëllim dhe komunikimin në baza të mirëbesimit me autoritetin e duhur janë institucionit.

Në të gjitha institucionet psikiatrike/të mirëqenies sociale të vizituara, pacientët/banuesit (si dhe kujdestarët dhe të afërmit e tyre) kanë mundur t'ia parashtrojnë ankesat në bazë të mirëbesimit drejtorisë dhe Avokatit të Popullit. Megjithatë, një numër pacientësh/banuesish dukej se nuk ishin të njoftuar për procedurat ekzistuese të ankesave.

**KPT-ja rekomandon që në të gjitha institucionet psikiatrike/të mirëqenies sociale të vizituara pacientët/banuesit të informohen me rastin e pranimit përmes fletushkës/broshurës njoftuese për të drejtat e tyre, si dhe për modalitetet e parashtrimit të ankesës.**

140. Sa i përket mbikëqyrjes së jashtme, KPT-ja vërejti se Avokati i Popullit në Kosovë ka bërë vizita të rregullta në institucionet psikiatrike, gjatë të cilave pacientët/banorët janë intervistuar të pashoqëruar nga të tjerët.

Gjatë konsultimeve me përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, delegacioni u informua se në të kaluarën këshillat e vizitorëve kanë bërë vizita (duke përfshirë ato të paparalajmëruara) në institucionet psikiatrike, por për shkak të kufizimeve buxhetore, ky këshill tani nuk ishte funksional. **KPT-ja rekomandon që sistemi i këshillit të vizitorëve të riaktivizohet dhe që këshillat të kenë burimet e duhura që do t'ua mundësonin atyre kryerjen e detyrave në mënyrë të efektshme. Po ashtu, Komisioni fton autoritetet që të themelojnë mekanizmin e vizitave të këtij lloji për institucionet e mirëqenies sociale.**

141. Në të gjitha institucionet psikiatrike të vizituara, rregullimet ekzistuese për kontaktime me botën e jashtme kanë qenë të kënaqshme. Pacientët/banuesit kanë pasur mundësi të dërgojnë dhe të pranojnë letra, kanë pasur qasje në telefon dhe kanë pranuar vizita nga familjarët dhe miqtë.

---

<sup>78</sup> Shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/47.

## SHTOJCA I

### **LISTA E REKOMANDIMEVE TË KPT-SË, KOMENTET DHE KËRKESAT PËR INFORMATA**

#### **A. Mbajtja në arrest nga policia**

##### **Keqtrajtimi**

##### Rekomandimet

- Një deklaratë zyrtare që buron nga autoriteti më i lartë kompetent politik duhet t'u dërgohet të gjithë policëve të ShPK-së (përfshirë policët e policisë kundër krimeve), duke i përkujtuar se duhet t'i respektojnë të drejtat e personave që mbahen nën arrest, dhe se keqtrajtimi i personave të tillë do t'i nënshtrohet sanksioneve të rënda. Ata gjithashtu duhet të përkujtohen se nuk duhet ushtruar më shumë forcë sesa që nevojitet gjatë kapjes së personit (paragrafi 13).
- Duhet ndërmarrë hapa përkatës për të siguruar mundësinë e parashtrimit të ankesës zyrtare nga personat që mund të kenë qenë viktime të keqtrajtimit nga policët (paragrafi 13);
- Autoritetet relevante të sigurojnë se kur një person i paraburgosur i cili sillet para prokurorit ose gjykatësit pohon se është keqtrajtuar nga policia, ato pohime duhet të regjistrohen me shkrim, menjëherë duhet të urdhërohet analiza nga mjekësia ligjore, dhe duhet të ndërmerren hapat e domosdoshëm për të siguruar hetimin e duhur të atyre pohimeve. Qasja e tillë duhet të përcillet pa marrë parasysh nëse personi tregon lëndime të dukshme. Tutje, edhe në mungesë të pohimit të qartë për keqtrajtim, prokurori ose gjykatësi duhet të kërkojë analizat e mjekësisë ligjore nëse ekzistojnë baza të tjera (për shembull lëndimet e dukshme, paraqitja e përgjithshme e personit ose mënyra e sjelljes) që çojnë në besimin se mund të ketë pasur keqtrajtim (paragrafi 14);
- Duhet ndërmarrë hapa përkatës për të siguruar se prokurorët/gjykatësit mbajnë gjykimet në atë mënyrë që personave në fjalë iu jepet mundësia e vërtetë për t'u deklaruar në lidhje me mënyrën se si janë trajtuar (paragrafi 14).

##### Kërkesat për informata

- Një pasqyrë e të gjitha ankesave të pranuara për keqtrajtim policor nga Inspektorati i Policisë së Kosovës (IPK) në vitin 2007 dhe rezultatet e procedurave gjegjëse disiplinore dhe (ose) penale (pohimet, përshkrimet e shkurtra të konstatimeve nga gjykata ose trupi përkatës, vendimet, shqiptimet/sanksionet) (paragrafi 16);
- Informata të hollësishme të çfarëdo inspektimi të rëndomtë ose të jashtëzakonshëm të kryer nga IPK-ja që nga prilli 2007 (objektivat, përfundimet, etj.) (paragrafi 18);

- Masat konkrete të ndërmarra nga autoritetet përkatëse në bazë të hetimeve të përmendura në paragrafët 19 dhe 20, me synim të parandalimit të incidenteve të ngjashme në të ardhmen (paragrafi 20).

## **Masat mbrojtëse**

### Rekomandimet

- Duhet ndërmarrë hapa për të siguruar obligimin në polici që të gjithë personat duhet të gëzojnë të drejtën për qasje në avokat, që nga fillimi i heqjes së lirisë së tyre (paragrafi 26);
- Duhet ndërmarrë hapa që në të gjitha stacionet policore analizat mjekësore të të paraburgosurve të kryhen në pamundësi të dëgjimit nga policët – përveç nëse mjeku kërkon ndryshe në ndonjë rast të veçantë (paragrafi 27);
- Duhet ndërmarrë hapa që të gjithë personat e paraburgosur nga policia, për çfarëdo arsye, të njoftohen plotësisht për të drejtat e tyre themelore (përfshirë të drejtën për mjek) që nga fillimi i heqjes së lirisë (do të thotë nga momenti kur ata obligohen që të qëndrojnë në polici). Kjo duhet të sigurohet përmes ofrimit të informatave të qarta me gojë në fillim të mbajtjes në arrest, dhe të plotësohet në mundësinë më të hershme (do të thotë menjëherë pas hyrjes në objektet e para policore) me një fletë të shkruar që përcakton të drejtat e personave të mbajtur në arrest në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo fletë duhet të jetë në dispozicion në disa gjuhë. Tutje, nga personat në fjalë duhet të kërkohej nënshkrimi i dëshmisë se ata janë njoftuar për të drejtat e tyre (paragrafi 29);
- Në çdo stacion policie në Kosovë, për çdo person të paraburgosur duhet të hapet një regjistër i vetëm gjithëpërfshirës i mbajtjes në arrest nga policia (paragrafi 33);
- Duhet ndërmarrë hapa për të siguruar se:
  - Regjistri për mbajtjen në arrest nga policia të dërgohet së bashku me të paraburgosurin kur ai transferohet në ndonjë stacion tjetër të policisë, kurse një kopje mbahet në stacionin e policisë prej nga shkon;
  - Kërkesa për të hapur regjistrin e mbajtjes vlen nga momenti kur i paraburgosuri arrin në stacionin e policisë (do të thotë edhe gjatë gjashtë orëve të para të paraburgimit, para se prokurori të autorizojë paraburgimin, gjer në 72 orë);
- Kërkesa për të hapur regjistrin e mbajtjes në arrest vlen edhe për stacionet policore pa qendër paraburgimi, ku mbahen fillimisht të dyshuarit për qëllim të intervistimit (paragrafi 33).

### Komentet

- Duhet ndërmarrë hapa për të garantuar fshehtësinë e të dhënave mjekësore në të gjitha objektet policore (paragrafi 28);
- Duhet ndërmarrë hapa për t'i dhënë fund praktikës së intervistimit të të dyshuarve si “dëshmitarë” pa i njoftuar për të drejtat e tyre (paragrafi 30);

- Objektivi afatgjatë duhet të jetë mbajtja e intervistave, si rregull, vetëm nëpër stacione policore me qendra paraburgimi (paragrafi 31).

### **Kushtet e paraburgimit**

#### Rekomandimet

- Duhet ndërmarrë hapa që pa vonesë të përmirësohen dukshëm kushtet e paraburgimit nëpër stacionet policore të vizituara (dhe, nëse kërkohet, edhe në qendrat e paraburgimit të stacioneve të tjera policore në Kosovë), në veçanti, sa i përket ndriçimit natyror, ajrosjes dhe higjienës (paragrafi 37);
- Autoritetet duhet të hartojnë një plan të hollësishëm për të rinovuar në mënyrë progresive të gjitha qendrat e paraburgimit në Kosovë (paragrafi 37).

#### Komentet

- Qelitë me rreth 2.5 m<sup>2</sup> (siç është ajo në stacionin policor të Deçanit) duhet të përdoren vetëm për qëllime të mbajtjes së përkohshme, për jo më gjatë se disa orë, dhe kurrë nuk duhet të përdoren për mbajtje gjatë tërë natës (paragrafi 35).

### **Çështjet e tjera**

#### Komentet

- Opsioni i prangimit të personave të paraburgosur për objekte fikse nuk është i pranueshëm nëse ato përdoren për periudha të zgjatura ose në pamje të të gjithëve. Tutje, nuk ka arsyetim për përdorim të prangave për duar gjatë intervistimit të personit të dyshuar. Më përgjithësisht, prangat nuk duhet përdorë si zëvendësim për opsionet e duhura të mbajtjes (paragrafi 38).

#### Kërkesat për informatë

- Komentet e UNMIK-ut në lidhje me paraqitjen e simboleve politike të vërejtura nga delegacioni në stacionin numër 1 të policisë në Prishtinë (paragrafi 39).

## **B. Institucionet korrektuese**

### **Keqtrajtimi**

#### Rekomandimet

- Drejtoria e burgut të Dubravës, Qendrës korrektuese në Lipjan dhe Qendrës së paraburgimit në Prishtinë duhet të përkujtojë personelin e tyre se të gjitha format e keqtrajtimit të të burgosurve (përfshirë keqtrajtimin verbal) janë të papranueshme dhe do të dënohen në përputhje me rrethanat (paragrafi 42);
- Duhet të kryhet një hetim i pavarur për incidentin e përmendur nën paragrafin 44, në lidhje me keqtrajtimin e pohuar/shfrytëzimin e tepruar të forcës nga pjesëtarët e Njesisë ndërhyrëse në Burgun e Dubravës dhe, nëse kërkohet, duhet shqiptuar sanksionet përkatëse në të gjitha nivelet (paragrafi 44);
- Menjëherë duhet ndërmarrë hapa në burgun e Dubravës dhe Qendrën korrektuese në Lipjan për të siguruar një hetim të brendshëm nëse pohimet për keqtrajtime janë shfaqur pas ndërhyrjes nga Njësia për ndërhyrje (pa paragjykim në hetimet që duhet kryer nga autoritetet e tjera administrative dhe/ose gjyqësore). Tutje, raportet e detajuara të ndërhyrjes duhet të hartohen nga udhëheqësit e ekipeve të përfshira, pas çdo ndërhyrjeje (paragrafi 50);
- Të gjithë pjesëtarët e Njësive ndërhyrëse në burgun e Dubravës dhe në Qendrën korrektuese në Lipjan duhet të përkujtohen se forca e përdorur kundër të burgosurve gjatë ndërhyrjeve duhet të kufizohet në atë nivel që është e domosdoshme dhe pasi që të burgosurit kundërshtues sillen nën kontroll, nuk ka arsyetim që ata të goditen më (paragrafi 51);
- Duhet ndërmarrë hapa nga autoritetet relevante për të siguruar se rregullat e dhëna nën paragrafin 52 të zbatohen në praktikë në të gjitha qendrat korrektuese në Kosovë (paragrafi 52).

#### Komentet

- Çdo i burgosur mbi të cilin është ushtruar forcë ka të drejtën e kontrollimit të menjëhershëm nga mjeku dhe, nëse kërkohet, edhe të trajtohet (paragrafi 47);
- Autoritetet relevante ftohen për të futur një politikë të punës rotative të pjesëtarëve të njësive ndërhyrëse nëpër burgje (paragrafi 50);
- është thelbësore që t'i kushtohet kujdes përzgjedhjes, rekrutimit, trajnimit (përfshirë menaxhimin të stresit), trajnimit fizik dhe pajisjes së pjesëtarëve të njësive speciale, me qëllim të sigurimit se janë mirë të përgatitur për t'u përballë si duhet (do të thotë duke përdorur forcë minimale) me situata të rrezikshme (paragrafi 50).

#### **Kushtet materiale të paraburgimit**

#### Rekomandimet

- Duhet ndërmarrë hapa që pa vonesë të rinovohen blloqet në burgun e Dubravës që ende nuk janë rinovuar. Duhet bërë përpjekje për ulje të nivelit të shfrytëzimit në ato qeli të cilat për momentin janë të stërmbushura (paragrafi 54);
- Duhet ndërmarrë hapa përkatës nga autoritetet relevante në Njësitë e të miturve dhe femrave në Qendrën korrektuese në Lipjan për të evituar mangësitë e përshkruara nën paragrafin 57 (paragrafi 57);

- Duhet ndërmarrë hapa përkatës nga autoritetet relevante për të evituar mangësitë e vërtetuara në qendrat e vizituara korrektuese (siç është përshkruar nën paragrafin 58). Në veçanti duhet ndërmarrë hapa për të siguruar se:
  - Në qendrat e paraburgimit në Mitrovicë dhe Gjilan, qelitë me sipërfaqe pesë dhe gjashtë metra katrorë të përdoren vetëm për një person;
  - Në qendrat e paraburgimit në Pejë dhe Prishtinë, të gjitha qelitë të kenë qasje adekuate në dritë natyrore (paragrafi 59).

#### Komentet

- Duhet synuar që në të gjitha objektet korrektuese të sigurohet së paku 4 m<sup>2</sup> hapësirë për një të burgosur në qeli për shumë persona, dhe 9 m<sup>2</sup> hapësirë për qelitë për një person (paragrafët 54 dhe 59).

#### Kërkesat për informatë

- Informatat e hollësishme për rezultatet e ushtrimit për evakuim gjatë natës të cekura në paragrafin 55, si dhe për masat që më pastaj janë ndërmarrë në burgun e Dubravës si rrjedhojë (paragrafi 55).

#### **Regjimi**

#### Rekomandimet

- Duhet ndërmarrë hapa për të zgjeruar dukshëm aktivitetet dhe trajnimet në dispozicion të të burgosurve në burgun e Dubravës. Kujdes të veçantë duhet kushtuar caktimit të planeve për trajtim të individualizuar për të burgosurit, si dhe regjimit për ata që vuajnë dënime të gjata (paragrafi 61);
- Autoritetet duhet t'i dërgojnë porosi të qartë personelit të burgut të Dubravës, nëpër poste mbikëqyrëse dhe në nivel më të ulët, se keqpërdorimi i pozitave të tyre duke pranuar ose kërkuar shpërblime nga të burgosurit është i papranueshëm dhe çdo akt i këtij lloji do të dënohet rëndë. Kjo porosi duhet të përsëritet rregullisht dhe në mënyrë të duhur (paragrafi 64);
- Në burgun e Dubravës duhet hartuar rregullat dhe kriteret e qarta dhe transparente, në veçanti, për regjimin e paraburgimit dhe shpërndarjes së të burgosurve. Tutje, të burgosurit duhet të njoftohen për këto rregulla dhe kritere përmes kanaleve përkatëse (paragrafi 65);
- Duhet ndërmarrë hapa për të zhvilluar brenda Bllokut 1 në burgun e Dubravës një program aktivitetesh të frymëzuara nga parimet e përcaktuara nën paragrafët 67 dhe 68 (paragrafi 68);
- Sistemi i klasifikimit të sigurisë në objektet korrektuese në Kosovë duhet të rishikohet, në bazë të vërejtjeve të bëra nën paragrafët 69 dhe 71 (paragrafët 71 dhe 81);

- Autoritetet duhet dhënë fund politikës sistematike të ndërrimit të qelive në burgun e Dubravës dhe në qendrat e vizituara të paraburgimit, në pajtim me vërejtjet e bëra nën paragrafin 73 (paragrafët 73 dhe 81);
- Duhet ndërmarrë hapa për të zgjeruar dukshëm aktivitetet dhe trajnimet në dispozicion për femrat në Qendrën korrektuese në Lipjan dhe të burgosurit e të gjitha qendrave të vizituara të paraburgimit dhe, nëse kërkohet, në qendrat e tjera të paraburgimit në Kosovë. Kujdes të veçantë duhet kushtuar planeve për trajtim të individualizuar dhe regjimit për personat që vuajnë dënime të gjata (paragrafët 75 dhe 80);
- Si hap i parë, autoritetet duhet shqyrtuar mundësinë e mbajtjes hapur të dyerve të qelive gjatë një pjese të ditës në qendrat e vizituara të paraburgimit (paragrafi 80);
- Si prioritet duhet gjetur një zgjidhje të arsyeshme alternative sa i përket aktiviteteve për të burgosurit që vuajnë dënime të gjata në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë (paragrafi 78).

#### Komentet

- ka ardhur koha për drejtorinë e burgut të Dubravës që të bëjë përpjekjet për të ra në pajtueshmëri me parimet e shpërndarjes dhe klasifikimit të të burgosurve, për të cilat vet ka avokuar (paragrafi 62).

#### Kërkesat për informatë

- Komentet e UNMIK-ut për konstatimet e delegacionit që në burgun e Dubravës niveli “E” i sigurisë nuk është rishikuar çdo 28 ditë (që është në kundërshtim me rregulloret në fuqi) dhe se nuk ka adresë në dispozicion të të burgosurve për ankesë kundër vendimeve të tilla (paragrafi 72);
- Komentet e UNMIK-ut për vërejtjet e bëra nga KPT-ja në lidhje me prezencën e policëve ndërkombëtarë në Bllokun 1 të burgut të Dubravës (paragrafi 74);
- Hapat konkretë të ndërmarrë deri më tani nga Qendra korrektuese në Lipjan për të ofruar trajnime të specializuara për personelin që punon me të miturit (paragrafi 76).

#### **Kujdesi shëndetësor**

#### Rekomandimet

- Duhet ndërmarrë hapa të menjëhershëm në qendrat e paraburgimit në Mitrovicë dhe Pejë për të evituar mungesën e karrigeve dentale dhe të pajisjeve të tjera (paragrafi 84);
- Duhet ndërmarrë hapa në burgun e Dubravës për të siguruar dërgimin pa vonesa të panevojshme të kërkesave për konsultime mjekësore, që bëhen nga të burgosurit, të shërbimet për kujdes shëndetësor, dhe të sigurohet organizimi i konsultimeve në të gjitha blloqet gjatë ditëve të punës (e jo vetëm dy herë në javë) (paragrafi 85);
- Prania e psikiatrit në burgun e Dubravës duhet të shtohet në ekuivalent të një pozite me orar të plotë (paragrafi 87);

- Autoritetet relevante duhet shtuar përpjekjet e tyre për të siguruar se në të gjitha qendrat e vizituara të paraburgimit të burgosurit kanë qasje në kujdes adekuat dental (paragrafi 89);
- Duhet ndërmarrë hapa në të gjitha objektet korrektuese në Kosovë për të siguruar zbatimin në praktikë të rregullave të përshkruara nën paragrafin 92 në lidhje me kontrollet mjekësore të të burgosurve të sapoardhur dhe për regjistrimin e lëndimeve (paragrafi 92);
- Procedurat ekzistuese duhet të rishikohen me qëllim të sigurimit se kurdo që regjistrohen lëndime nga mjeku, të cilat janë konsistente me pohimet e të burgosurit për keqtrajtime, regjistri sistematikisht duhet të sillet në vëmendje të prokurorit përkatës (paragrafi 92);
- Duhet ndërmarrë hapa për të siguruar se të burgosurit e sapoardhur të kontrollohen për sëmundje ngjitëse (paragrafi 92);
- Drejtoria e burgut të Dubravës dhe e të gjitha qendrave të paraburgimit në Kosovë duhet të udhëzohet se të gjitha kontrollet mjekësore të të burgosurve (ose në momentin e ardhjes ose më vonë) duhet të kryhen larg zyrtarëve të burgut, përveç nëse mjeku kërkon ndryshe në ndonjë rast të veçantë (paragrafi 95).

#### Komentet

- Personeli jomjekësor nuk duhet të kërkojë kontrollimin e kërkesave për konsultime mjekësore (paragrafi 85);
- Është e dëshirueshme që të krijohet regjistri i veçantë për regjistrim të lëndimeve të vërejtura te të burgosurit gjatë pranimit ose të fituara në burg në të gjitha institucionet korrektuese (paragrafi 93);
- Është e dëshirueshme që të shpërndahen sistematikisht informatat themelore në lidhje me sëmundjet ngjitëse (siç është tuberkulozi, AIDS - SIDA dhe hepatiti) te të dënuarit në formë të shkruar (për shembull fletushka) në gjuhën që ata e kuptojnë (paragrafi 96).

#### Kërkesat për informatë

- Komentet e UNMIK-ut për vështrimet e delegacionit në burgun e Dubravës se në disa raste ka pasur vonesa të konsiderueshme në hospitalizim të të burgosurve, në veçanti për operacion (paragrafi 86);
- Komentet e UNMIK-ut për vështirësitë e raportuara në transferim të të burgosurve në kujdesin e nevojshëm psikiatrik nga qendra e paraburgimit në Mitrovicë në spitalin regional të Mitrovicës së veriut (paragrafi 90).

## **Çështjet e tjera**

### Rekomandimet

- Në të gjitha institucionet korrektuese në Kosovë duhet të zbatohen rregullat që kontaktet me familje kurrë nuk duhet ndaluar plotësisht si dënim dhe se kufizimet në kontakte me botën e jashtme duhet të zbatohen vetëm për kohë sa më të shkurtër – rregull ky që nuk vlen për burgjet e të miturve, (paragrafi 97);
- Duhet ndërmarrë hapa për të siguruar se të gjithë të burgosurit që i nënshtrohen dënimit disiplinor të gëzojnë të drejtën për ankesë (paragrafi 98);
- Duhet ndërmarrë hapa në të gjitha institucionet korrektuese të vizituara për t'u siguruar se të gjithë të burgosurit:
  - Kanë pasur seancë dëgjimore në procedurat disiplinore;
  - Kanë marrë një kopje të vendimit disiplinor, që i njofton lidhur me arsyet për vendimin dhe adresën për ankesë. Të burgosurit duhet të konfirmojnë me shkrim se kanë pranuar një kopje të vendimit (paragrafi 99);
- Duhet rishikuar aranzhimet dhe praktikat ekzistuese ligjore në lidhje me rolin e mjekëve të burgut në lidhje me çështjet disiplinore. Gjatë kësaj pune, duhet marrë parasysh Rregullat e rishikuara evropiane për burgje dhe komentet e dhëna nga KPT-ja në paragrafin 53 të raportit të përgjithshëm numër 15 (KPT/Inf (2005) 17) (paragrafi 100).

### Komentet

- Duke marrë parasysh vetëm madhësinë, qelia disiplinore në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë nuk është e përshtatshme për akomodim për tërë natën. Duhet gjetur një zgjidhje alternative për të dënuarit që duhet vuajtur izolimin në vetmi (paragrafi 101).

## **C. Kapacitetet psikiatrike / të mirëqenies sociale**

### **Vërejtjet preliminare**

### Komentet

- KPT kërkon nga UNMIK-u që të bëjë të gjitha përpjekjet për të lehtësuar zbatimin në praktikë të rekomandimeve dhe komenteve të bëra nën paragrafët 111, 112, 123, 127, 131 to 133, 136, 138 dhe 139 në lidhje me Repartin për psikiatri dhe neurologji në Spitalin regional të Mitrovicës (paragrafi 105).

### **III-Trajtimi**

#### Rekomandimet

- **Personeli në institucionin për persona me paaftësi mendore në Shtime duhet të përkujtohet se të gjitha format e keqtrajtimit të banuesve janë të papranueshme dhe do të sanksionohen (paragrafi 106);**
- **Personeli i Institutit special të Shtimes duhet të përdorë të gjitha mjetet në dispozicion për të parandaluar dhunën dhe frikësimin ndaj pacientëve/banuesve. Me qëllim të prekjës së këtij problemi, personeli duhet të njihet me shenjat e telasheve dhe të jetë i përkushtuar dhe mirë i trajnuar për të ndërhyrë kur të jetë nevoja (paragrafi 107).**

#### **Kushtet e jetesës së pacientëve / banuesve**

#### Rekomandimet

- **Autoritetet duhet bërë përpjekje prioritare për t'u siguruar se të gjithë pacientëve të mbajtur në njësinë e mjekësisë ligjore të klinikës psikiatrike në Prishtinë t'u ofrohet çdo ditë, nëse lejon gjendja e tyre shëndetësore, së paku një orë ushtrime në ambient të hapur (paragrafi 110);**
- **Duhet ndërmarrë hapa nga autoritetet relevante për të siguruar se Spitali regjional në Mitrovicë:**
  - **Ofron disa aktivitete rekreative për pacientët e psikiatrisë;**
  - **Ofron së paku një orë ushtrime në ambient të hapur për çdo ditë të gjithë pacientëve të psikiatrisë, gjendja shëndetësore e së cilëve e mundëson atë (paragrafi 112);**
- **Duhet ndërmarrë hapa prioritarë shtesë për të përmirësuar kushtet e jetesës së pacientëve në qendrat e integruara për shëndetin mendor në Shtime, në bazë të vërejtjeve të bëra nën paragrafët 115 dhe 116 (paragrafi 116).**

#### Komentet

- **Duhet të ndërmerren hapa nga autoritetet relevante për të siguruar dekorime në Repartin për psikiatri dhe neurologji në Spitalin regjional të Mitrovicës (paragrafi 111);**
- **Duhet ndërmarrë hapa për të ofruar një mjedis më të personalizuar për banuesit e institucionit për personat me paaftësi mendore në Shtime (paragrafi 113).**

## **Personeli**

### Rekomandimet

- Duhet ndërmarrë hapa për të siguruar vijim të rregullt të personelit shëndetësor në Repartin e mjekësisë ligjore në Klinikën psikiatrike në Prishtinë (paragrafi 118);
- Duhet ndërmarrë hapa nga autoritetet relevante për të siguruar se në qendrën e integruar për shëndetin mendor në Shtime:
  - Kujdesi psikiatrik shtohet ashtu që të ofrohet së paku një post i psikiatrit me orar të plotë;
  - Të rritet numri i infermierëve dhe pastruesve (paragrafi 120).

## **Trajtimi**

### Rekomandimet

- Duhet ndërmarrë hapa në të gjitha institucionet psikiatrike të vizituara, në veçanti në “Institutin special” në Shtime për të zhvilluar aktivitete trajtimi dhe rehabilitimi për pacientët/banuesit psikiatrikë që gjithashtu do të mundësonte zvogëlimin e përdorimit të barnave psikotrope (paragrafi 123).

## **Kontrolli i pacientëve/banuesve problematikë**

### Rekomandimet

- Në Repartin e mjekësisë ligjore në Klinikën psikiatrike në Prishtinë, duhet t'i jepet fund praktikës së prangimit pacientëve problematik për shtratin e tyre. Nëse kërkohet kontroll mekanik i përkohshëm, duhet përdorur mjete përkatëse alternative (për shembull rripat) (paragrafi 125);
- Infermieret në Qendrën e integruar për shëndetin mendor në Shtime duhet të udhëzohen se administrimi i kontrolluesve kimikë gjithmonë duhet të përdoret pas urdhrit nga mjeku (paragrafi 126);
- Duhet të vendosen regjistrat e veçantë me hollësitë e përdorimit të mjeteve kontrolluese në të gjitha institucionet psikiatrike të vizituara (paragrafi 127).

## **Masat mbrojtëse**

### Rekomandimet

- Pa vonesë duhet ndërmarrë hapa për të siguruar zbatimin efektiv të dispozitave ligjore përkatëse të zbatueshme në Kosovë të cilat rregullojnë vendosjen pa vullnet të pacientëve. Në këtë çështje, gjykatat kompetente duhet të njoftohen lidhur me të gjithë personat të cilët aktualisht mbahen në çdo institucion psikiatrik të vizituar në baza jovullnetare (paragrafi 131);
- Duhet ndërmarrë hapa në Institutin special në Shtime dhe, nëse kërkohet, në institutet e tjera psikiatrike/ të mirëqenies sociale në Kosovë, për t'u siguruar se gjykatat janë të njoftuara për të gjithë banuesit/pacientët, për të cilët supozohet se nuk janë në gjendje që të japin pajtimin në lidhje me vendosjen e tyre (paragrafi 132);
- Duhet ndërmarrë hapa nga autoritetet relevante për të siguruar se, në kontekst të procedurave gjyqësore për të zhveshur banuesin/pacientin nga kapaciteti ligjor i tij dhe për të caktuar një kujdestar, personave në fjalë:
  - T'u jepet e drejta për dëgjim personalisht në gjykatë;
  - T'u jepet një kopje e vendimit të gjykatës;
  - Të njoftohen me shkrim dhe gojarisht për mundësinë dhe modalitetet për ankesë kundër vendimit të gjykatës(paragrafi 133);
- Duhet ndërmarrë hapa për të siguruar rishikimin e rregullt në bazë të vendosjes në institutin psikiatrik/ të mirëqenies sociale të personave nën kujdestari, siç është caktuar nga autoriteti përkatës (paragrafi 133);
- Duhet ndërmarrë hapa nga autoritetet relevante për të siguruar se të gjitha vendosjet për trajtim të detyrueshëm t'i nënshtrohen rishikimit të rregullt, siç është paraparë me ligj (paragrafi 135);
- Duhet ndërmarrë hapa në të gjitha institucionet psikiatrike/ të mirëqenies sociale të vizituara për të siguruar se të gjithë pacientëve/banuesve gjatë pranimit (si dhe familjeve të tyre) t'i jepet një broshurë informuese mbi punën e institutit dhe të drejtat e tyre (paragrafi 136);
- Duhet ndërmarrë hapa në të gjitha institutet psikiatrike/ të mirëqenies sociale të vizituara për të siguruar se të gjithë pacientëve/banuesve, përfshirë ata që janë vendosur atje në baza jovullnetare, t'u jepet mundësia për të refuzuar, ose personalisht ose përmes kujdestarit të tyre, trajtimin ose çfarëdo ndërhyrje tjetër mjekësore, në pajtim me vërejtjet e dhëna nën paragrafët 137 dhe 138 (paragrafi 138);
- Në të gjitha institutet psikiatrike/të mirëqenies sociale të vizituara, pacientët/banuesit duhet të njoftohen me një broshurë/fletushkë informuese, e cila iu shpërndahet atyre gjatë pranimit, mbi të drejtat e tyre, si dhe për modalitetet për t'u ankuar (paragrafi 139);
- Sistemi i këshillit të vizitorëve duhet të riaktivizohet dhe këtyre këshillave duhet siguruar resurset adekuate që mundësojnë kryerjen e punëve të tyre me efikasitet (paragrafi 140).

Komentet

- Autoritetet ftohen për të vendosur një mekanizëm vizite nëpër institucionet e mirëqenies sociale të ngjashëm me këshillat e vizitorëve. (paragrafi 140).

Kërkesat për informatë

- Komentet e UNMIK-ut në lidhje me vështirësitë e përjetuara nga drejtorja e Institutit Special në Shtime në aranzhimin e transferimit të një grupi prej rreth 20 pacientëve/banuesve me origjinë serbe që mbahen në institut nëpër institucione përkatëse të kujdesit në Serbi (paragrafi 134).

**SHTOJCA II**

**LISTA E AUTORITETEVE, ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE DHE OJQ-VE QË U  
TAKUAN NGA DELEGACIONI**

**UNMIK**

z. Joachim RÜCKER	Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (PSSP)
z. Steven P. SCHOOK	Zëvendësi kryesor i PSSP-së
znj. Patricia WARING	Drejtori i Administratës Civile
znj. Emma SHITAKHA	Shefe e personelit
z. Robert L. DEAN	Prokuror ndërkombëtar, Departamenti i Drejtësisë
z. William J. IRVINE	Shef i Divizionit të Drejtorisë së Burgjeve (DDB), Departamenti i Drejtësisë
z. Jeffrey CHESTER	Shef i operacioneve, PMD, Departamenti i Drejtësisë
Dr. Annibale F.G. PETRONE	Shef i shërbimit mjekësor, PMD, Departamenti i Drejtësisë
z. Trygve KALLEBERG	Komisionar policie, kryes detyre, CIVPOL
z. Scott ANDERSON	Zëvendëskomisionar policie për operacione, CIVPOL
z. Lars FINSTAD	Drejtor për operacione, CIVPOL
z. Patrick MORRISON	Drejtor, Divizioni i informimit publik
z. Neithart HOEFER-WISSING	Zyra për çështje politike

**OSBE (Shtylla III – ndërtimi institucional)**

z. Henry W. McGOWEN	Drejtor për të drejtat e njeriut, decentralizim dhe komunitete
z. D. Christopher DECKER	Shef i divizionit për të drejtat e njeriut

**Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë**

z. Jonuz SALIHAI	Ministër i Drejtësisë
z. Blerim KUQI	Ministër i Punëve të Brendshme
z. Sadik IDRIZ	Ministër i Shëndetësisë
z. Ibrahim SELMANAJ	Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale
z. Xhevat MEXHUANI	Komisionar, Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) Ministria e Drejtësisë
z. Milazim GJOCAJ	Shef i shërbimit mjekësor, SHKK, Ministria e Drejtësisë
z. Enver RRUSTEMI	Shef ekzekutiv i Inspektoratit të Policisë së Kosovës (IPK), Ministria e Punëve të Brendshme

**Organet e tjera**

z. Hilmi JASHARI	Ushtrues detyre i Avokatit të Popullit në Kosovë
------------------	--

**Organizatat ndërkombëtare**

ICRC

OHCHR

UNICEF

**OJQ-të**

Këshilli për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut

Qendra rehabilituese e Kosovës për viktimat e torturës

### **SHTOJCA III**

#### **MARRËVESHJA NË MES TË MISIONIT TË ADMINISTRATËS SË PËRKOHSHME TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË DHE KËSHILLIT TË EVROPËS PËR ARANZHIMET TEKNIKE QË LIDHEN ME KONVENTËN EVROPIANE PËR PARANDALIMIN E TORTURËS DHE TRAJTIMIT OSE DËNIMIT ÇNJERËZOR APO DEGRADUES**

Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK”) dhe Këshilli i Evropës, në tekstin e mëtejme “Palët”,

Duke marrë parasysh Konventën evropiane për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor apo degradues (“Konventa”) e datës 26 nëntor 1987,

Duke ditur se Konventa është ratifikuar nga 45 shtete, përfshirë Serbinë dhe Malin e Zi,

Duke marrë parasysh Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999) të datës 10 qershor 1999, e cila duke njohur sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës Federative të Jugosllavisë (tani Serbi e Mali i Zi), vendosë autoritetin e UNMIK-ut, si prezencë civile ndërkombëtare, për të siguruar administratë të përkohshme për Kosovën,

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme në Kosovë, që jep dispozitat për përgjegjësitë e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes,

Duke marrë parasysh vendimin e aprovuar më 30 qershor 2004 nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës,

Duke shprehur se kjo marrëveshje nuk bën UNMIK-un palë në Konventë dhe se nuk paragjykon statusin e ardhshëm të Kosovës që do të përcaktohet në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999),

Me qëllim të promovimit të bashkëpunimit teknik në mes të palëve dhe duke lehtësuar funksionet e Komisionit evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimin ose dënimin çnjerëzor apo degradues (“Komisioni”), përfshirë ofrimin e qasjes në çdo vend brenda Kosovës ku personave u merret liria e tyre nga UNMIK-u,

Kanë rënë në dakord si vijon:

#### **Neni 1**

#### **Vizitat e Komisionit në Kosovë**

1.1 Komisioni, përmes vizitave, analizon trajtimin e personave me heqje lirie në Kosovë me synim të përforcimit, nëse kërkohet, të mbrojtjes së personave të tillë nga tortura dhe nga trajtimi ose dënimi çnjerëzor apo degradues.

1.2 UNMIK-u lejon vizitat, në pajtim me këtë marrëveshje, në çdo vend në Kosovë ku gjenden personat me heqje lirie nga ndonjë autoritet i UNMIK-ut.

1.3 Komisioni nuk viziton vendet të cilat vizitohen nga përfaqësuesit ose delegatët e autoriteteve mbrojtëse ose Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq në baza të rregullta në pajtim me Konventat e Gjenevës së 12 gushtit 1949 dhe protokolleve shtesë të 8 qershorit 1977.

## Neni 2 Bashkëpunimi

Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, Komisioni dhe UNMIK-u do të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

## Neni 3 Organizimi i vizitave të Komisionit

3.1 Komisioni do të organizojë vizitat në vendet e përmendura nën nenin 1.2. Përveç vizitave periodike, Komisioni mund të organizojë vizita të tjera nëse kërkohet sipas rrethanave.

3.2 Si rregull i përgjithshëm, vizitat do të kryhen nga së paku dy anëtarë të Komisionit. Komisioni, nëse konsideron si të domosdoshme, mund të ndihmohet edhe nga ekspertët dhe përkthyesit.

## Neni 4 Njoftimi dhe modalitetet e vizitave

4.1 Komisioni do të njoftojë UNMIK-un për qëllimet e veta për të kryer vizitat dhe dërgon një kopje të këtij njoftimi kryesuesit të Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Pas njoftimit të tillë, Komisioni në çdo kohë mund të vizitojë secilin vend të përmendur nën nenin 1.2.

4.2 UNMIK-u do t'i sigurojë Komisionit këto lehtësira për kryerjen e punës së vet:

- (a) Qasje në Kosovë dhe të drejtën për udhëtim pa kufizime;
- (b) Informatat e plota për vendet kur mbahen personat me heqje lirie nga ndonjë autoritet i UNMIK-ut;
- (c) Qasje të pakufizuar në çdo vend ku personave u është hequr liria nga ndonjë autoritet i UNMIK-ut, përfshirë të drejtën për të lëvizur brenda vendeve të tilla pa ndonjë kufizim;
- (d) Informata të tjera që mbahen nga UNMIK-u që janë të domosdoshme për Komisionin në kryerjen e punës së vet. Në kërkim të informatave të tilla, Komisioni merr parasysh rregullat e aplikueshme të ligjit dhe etikën profesionale.

4.3 Komisioni mund të intervistojë personalisht personat me heqje lirie.

4.4 Komisioni mund të komunikojë lirshëm me çdo person i cili besohet se mund të jap informata përkatëse.

4.5 Nëse është e domosdoshme, Komisioni menjëherë mund të komunikojë vështrimet e tij te autoritetet kompetente të UNMIK-ut.

## Neni 5 Përfaqësimet në vizita

5.1 Në raste të jashtëzakonshme, UNMIK-u mund të bëjë përfaqësimin e Komisionit gjatë një vizite në ndonjë kohë ose vend të caktuar të propozuar nga Komiteti. Përfaqësimet e tilla mund të bëhen vetëm për shkaqe të sigurisë në Kosovë, sigurisë publike, çrregullimet serioze në vendet ku personave u hiqet liria e tyre, kushtet mjekësore të personit ose kur ndonjë marrje në pyetje urgjente për ndonjë krim serioz është në vazhdim e sipër.

5.2 Pas përfaqësimeve të tilla, Komisioni dhe UNMIK-u menjëherë do të futen në konsultime me qëllim të qartësimit të gjendjes dhe të kërkojnë marrëveshje për aranzhimet që ia mundësojnë Komisionit të ushtrijë funksionet e tij në mënyrë ekspeditive. Aranzhimet e tilla mund të përfshijnë transferimin në vende të tjera të personave të propozuar nga Komiteti për vizitë. Gjatë vizitës UNMIK-u do t'i ofrojë Komisionit informatat lidhur me personat në fjalë.

#### Neni 6 Raportet e vizitave

6.1 Pas çdo vizite Komisioni do të hartojë një raport mbi faktet e gjetura gjatë vizitës, duke marrë parasysh çdo vështrim që i është dorëzuar UNMIK-ut. Ai do t'i dërgojë UNMIK-ut raportin e vet që përmban rekomandimet e konsideruara si të domosdoshme dhe do t'i dërgojë një kopje kryesuesit të Komisionit të Ministrave të Këshillit Evropës. Komisioni mund të konsultohet me UNMIK-un me qëllim të sugjerimit, nëse kërkohet, për të bërë përmirësime në mbrojtje të personave me heqje lirie.

6.2 Nëse UNMIK-u dështon në bashkëpunim ose refuzon përmirësimin e gjendjes në pajtim me rekomandimet e Komisionit, Komisioni mund të vendosë, pasi që UNMIK-u të ketë pasur mundësinë për të njoftuar për mendimet e veta, me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të vet të bëjë deklaratë publike për çështjen në fjalë.

#### Neni 7 Fshehtësia

7.1 Informatat e grumbulluara nga Komisioni në lidhje me vizitën, raporti i tij dhe konsultimet me UNMIK-un do të jenë të fshehta.

7.2 Komisioni do të publikojë raportet e veta, së bashku me komentet e UNMIK-ut, kurdoherë që kërkohet nga UNMIK-u.

7.3 Sidoqoftë, nuk do të botohet kurrfarë informate personale pa pajtimin e shprehur të personit në fjalë.

#### Neni 8 Ekspertët dhe personat tjerë që ndihmojnë Komisionin

8.1 Emrat e personave që ndihmojnë Komisionin do të specifikohen në njoftimin nga neni 4.1.

8.2 Ekspertët do të veprojnë sipas udhëzimeve dhe nën autoritetin e Komisionit. Ata kanë njohuri dhe përvojë të veçantë në fushat e mbuluara nga kjo marrëveshje dhe do të kryejnë detyrat e njëjta me pavarësi, paanësi dhe disponueshmëri si anëtarë të Komisionit.

8.3 UNMIK-u në raste të jashtëzakonshme mund të deklarojë se një ekspert ose person tjetër që ndihmon Komitetin nuk do të lejohet që të merr pjesë në ndonjë vizitë të vendeve ku personave u është hequr liria nga ndonjë autoritet i UNMIK-ut.

#### Neni 9

##### Emërimi i pikave të kontaktit

UNMIK-u njofton Komisionin për emrin dhe adresën e autoritetit kompetent për të pranuar njoftimet, dhe zyrtarët ndërlidhës që mund të emërohen.

#### Neni 10

##### Privilegjet dhe imuniteti

Komisioni, anëtarët e tij dhe ekspertët e përmendur nën nenin 3.2 dhe 8, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara në aneks të kësaj marrëveshje.

#### Neni 11

##### Ndryshimet dhe plotësimet

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe plotësohet vetëm me marrëveshje të shkruar në mes të palëve.

#### Neni 12

##### Zgjidhja e kontesteve

Kontestet dhe mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhen në mënyrë miqësore përmes bashkëpunimit në mes të Komisionit dhe UNMIK-ut dhe, nëse kërkohet, përmes negociatave të mirëbesimit në mes të palëve.

#### Neni 13

##### Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve dhe mbetet në fuqi gjatë mandatit të UNMIK-ut si administratë e përkohshme në Kosovë nën autoritetin e Kombeve të Bashkuara, përveç nëse ndërpritet në pajtim me nenin 14.

#### Neni 14

##### Ndërprerja

Secila palë në çdo kohë mund të ndërpres këtë marrëveshje përmes njoftimit të adresuar palës tjetër. Ndërprerja do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasues pas skadimit të periudhës dymbëdhjetë mujore pas datës së pranimit të njoftimit, përveç nëse palët pajtohen ndryshe me shkrim.

Të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar, në emër të palëve nënshkruajnë këtë marrëveshje.

E kryer në Prishtinë, më 23 gusht 2004, në gjuhën angleze dhe frënge, ku anglishtja është teksti autentik, në dy kopje, ashtu që njëra do të deponohet në arkivat e Këshillit të Evropës dhe tjetra do t'i dërgohet UNMIK-ut.

PËR MISIONIN E PËRKOHSHËM TË  
KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË

PËR KËSHILLIN E EVROPËS

---

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

---

Sekretari i Përgjithshëm